

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP
& SHOQATA E HISTORIANËVE SHQIPTARË
NË MAQEDONI

MASAR KODRA (1932–2003)
– FIGURË E SHQUAR E
HISTORIOGRAFISË SHQIPTARE

*(Konferencë shkencore mbajtur më 15.9.2017,
me rastin e 85–vjetorit të lindjes)*

19



Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP &
SHOQATA E HISTORIANËVE SHQIPTARË NË MAQEDONI

Vëllimi 19 – 2018

Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Dr. Nebi Dervishi

Këshilli redaktues:
Dr. Daut Bislini
Dr. Skender Asani
Dr. Naim Halimi
Dr. Sevdail Demiri
Mr. Çlirim Dervishi

ISBN: 978–608–4653–51–6

Copyright©ITSHKSH, 2018
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

www.itsh.edu.mk

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP
& SHOQATA E HISTORIANËVE SHQIPTARË
NË MAQEDONI

MASAR KODRA (1932–2003)
– FIGURË E SHQUAR E
HISTORIOGRAFISË SHQIPTARE

*(Konferencë shkencore mbajtur më 15.9.2017,
me rastin e 85-vjetorit të lindjes)*

19

SCUPI
Shkup, 2018

Ky botim financohet nga:



Republika e Maqedonisë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

TRYEZA E LËNDËS:

PARATHËNIE.....	8
HOMAZHE TE VARRI I PROF.DR. MASAR KODRA	10
EKSPOZITË ME DOKUMENTE DHE FOTOGRAFI.....	11
HAPJA SOLEMNE E PUNIMEVE TË KONFERENCËS SHKENCORE.....	12
SKENDER ASANI, ITSHKSH–Shkup	13
IBRAHIM GASHI, Universiteti i Prishtinës.....	14
FATMIR (MASAR) KODRA, në emër të familjes Kodra	16
 PUNIMET E KONFERENCËS SHKENCORE.....	19
NEBI DERVISHI: PROFESOR MASAR KODRA – JETA DHE VEPRA (1932 – 2003)	20
DAUT BISLIMI: KONTRIBUTI I PROF.DR MASAR KODRËS NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE PËR LUFTËN E DYTË BOTËRORE.....	31
HALIM PURELLKU: VËSHTRIM I SHKURTËR MBI VEPRËN E PROF. DR. MASAR KODRËS “SHQIPTARËT E MAQEDONISË GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE (1939–1944)”	37
IBRAHIM GASHI: KONTRIBUTI I PROF. DR. MASAR KODRËS SI PEDAGOG NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS (1975–1991) 42	
QERIM LITA: PROFESOR MASAR KODRA NË DOKUMENTET ARKIVORE.....	48
JAHJA DRANÇOLLI & QERIM DALIPI: KONTRIBUTI I MASAR KODRËS NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE (SHEK. XV – 1912).....	59

ZEJNULLA QYRA: KONTRIBUTI I PROFESOR MASAR KODRËS NË ORGANIZIMIN E KONFERENCAVE SHKENCORE NË VITET 1991–2001 NË TROJET LINDORE SHQIPTARE	72
NURIDIN AHMETI: NDIHMESA E PROFESOR MASAR KODRËS NË PËRPILIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË HISTORISË NË KOSOVË.....	77
NAIM HALIMI: DR. MASAR KODRA – HISTORIAN, JO VETËM I SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË	86
ZEQIRJA REXHEPI: LUFTA ANTIFASHISTE NACIONAL ÇLIRIMTARE NË SHQIPËRI, NË VEPRËN E MASAR KODRËS: “ÇËSHTJA SHQIPTARE NË ANALET DIPLOMATIKE AMERIKANE – 1918–1945”	90
ABDULLA MEHMETI: KONTRIBUTI I DR. MASAR KODRËS NË AKTIVITETET KULTURORE – SHKENCORE.....	98
ZEQIRJA IDRIZI: SHBA DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE.....	111
MIXHAIT POLLOZHANI: MASAR KODRA, PUBLICIST DHE GAZETAR	121
BANUSH MORINA: KONTRIBUTI I PROF. DR. MASAR KODRA NË PERIODIKUN SHKENCOR TË KOSOVËS	130
HAMDİ MEDIU–DUSHI: PROFESORI I MIQËSISË SË PAFUNDME DHE VEPRAVE TË MËDHA	135
SADRI REXHEPI: PROF.DR. MASAR KODRA DHE KONTRIBUTI I TIJ SHKENCOR DHE KOMBËTAR.....	143
BESNIK EMINI: SHKRIMET E MASAR KODRËS TË BOTUARA NË REVISTËN “JEHONA” – SHKUP	147
ARDIAN LIMANI: VEPRIMTARIA HULUMTUESE – SHKENCORE E MASAR KODRËS NË INSTITUTIN E HISTORISË NACIONALE NË SHKUP.....	156
ÇLIRIM DERVISHI: SHËNIME BIBLIOGRAFIKE TË LIBRAVE, MONOGRAFIKE DHE PUNIMEVE TË PROF.DR.MASAR KODRA	166



PROF. DR. MASAR KODRA (1932 – 2003)

PARATHËNIE

Vëllimi i këtij botimi të veçantë të “Scupi”-t (nr.19) me temë “Prof. dr. Masar Kodra – figurë e shquar e historiografisë shqiptare”, është përmbledhje kumtesash, fjalë rasti e fjalë përshëndetëse të Konferencës shkencore me rastin e 85-vjetorit të lindjes së Tij, që u mbajt në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, me studiues nga Kosova dhe Maqedonia.

Pra, në Shkup në shenjë përkujtimi dhe nderimi të figurës së profesor Masar Kodrës u mbajt Konferenca shkencore me titull “Prof. Dr Masar Kodra (1932–2003) – figurë e shquar e historiografisë shqiptare”, e organizuar nga Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni dhe Departamenti i Historisë pranë Fakultetit Filozofik në Universitetin e Tetovës.

Profesor Masar Kodra i takon plejadës së figurave më të rëndësishme të botës intelektuale kombëtare të gjysmës së dytë të shek. XX. Për këtë dëshmojnë veprat, studimet dhe artikujt e shumtë të botuara e të pabotuara në një periudhë gati 50 vjeçare të punës së tij. Ato paraqesin një trashëgimi jashtëzakonisht të rëndësishme për historinë dhe kulturën kombëtare.

Masar Kodra ishte boshti i elitës intelektuale këtu në Maqedoni dhe më gjerë, si dhe i veprimtarive, organizimeve politike, kulturore e arsimore. Ai ishte nismëtar i mirëfilltë i shkrimeve, studimeve për historinë, për tekstet shkollore, për hapjen e institucioneve arsimore, kulturore e shkencore (në themelimin e Universitetit të Tetovës më 1994), në ngritjen e kuadrit dhe specialistëve, në nxjerrjen e revistave profesionale, monografive e botimeve të shumta, e sidomos në organizimin e konferencave shkencore, tribunave e simpoziumeve ku janë trajtuar ngjarje të rëndësishme nga historia jonë kombëtare. Dhe në tërë veprimtarinë e vetë jetësore, prof.

Masari si rrallëkush vështirësitë dhe pengesat i tejkaloi me guxim, punë profesionale, mençuri dhe gjakftohtësi të pashembullt.

Në konferencën shkencore në 85-vjetorin e lindjes së profesor Masar Kodrës, studiues të fushave dhe periudhave të ndryshme të historisë, u përpoqën që me kuntimet e tyre të paraqesin kontributin e këtij studiuesi poliedrik dhënë shkencës, arsimit, kulturës dhe historiografisë shqiptare. Për përmasat e kësaj veprimtarie jetësore të Masar Kodrës, për shërbëtorin e ndriçimit të vërtetës historike, për themeluesin e historiografisë shqiptare këtu në Maqedoni e më gjerë dëshmojnë edhe punimet e studiuesve shqiptarë që po botohen në këtë vëllim.

Ky botim që keni në duar, është një kontribut i çmuar i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni. Urojmë që të mos mbetet vetëm me kaq, sepse jeta e veprimtaria e profesor Masar Kodrës ngërthen në vete përmasa të tilla që nuk mund të përthekohen e vlerësohen objektivisht me një konferencë shkencore apo me një botim të këtillë. Shpresojmë e besojmë se ITKSHSH-ja do t'i botojë punimet e botuara nëpër revista, punimet e shumta të pabotuara e pse jo edhe një monografi për këtë personalitet të nderuar të dijes, shkencës historiografike e të kulturës në Maqedoni e më gjerë.

Në fund do të shtojmë dhe atë se për mbajtjen e konferencës shkencore një kontribut të veçantë dhanë edhe: z. Ahmet Demishi “Foto – Zrak” nga Struga dhe z. Fatmir Imeri – pronar i Restorant “Bleta” në Çarshinë e Vjetër në Shkup, të cilëve në emër të Redaksisë i falënderojmë.

Redaksia

HOMAZHE TE VARRI I PROF.DR. MASAR KODRA

Daut Bislimi (Prishtinë)

– Fjalë rasti –

I nderuari Profesor Masar Kodra,

Kemi ardhur këtu në vendin e pushimit tënd të përhershëm për të nderuar jetën dhe veprën tënde, të gjithë ne, familjarë, kolegë, ish-studentët tuaj, dashamirës.... Të gjithë bashkë të shprehim falënderimet për gjithçka bërë për historiografinë shqiptare, për ngritjen e kapaciteteve të saja kadrovike, për kontributet studimore me vlerë që ke lënë prapa vetes për ne dhe për brezat e ardhshëm!

Për Ju, profesor i nderuar, nuk duhet thënë fjalë shumë të mëdha, sepse për ju flet vepra juaj, puna juaj, përkushtimi shkencor e kombëtar gjatë gjithë jetës. Neve na mbetet të nderojmë dhe të ndjekim veprën Tuaj si njëra nga shenjat orientuese të dijes sonë në rrugët e së ardhmes. Lavdi jetës dhe veprës së Profesorit tonë të çmuar, njeriut të dashur, atdhetarit të devotshëm, Profesorit Masar Kodra!



EKSPOZITË ME DOKUMENTE DHE FOTOGRAFI

Përgatiti:

Mr. Çlirim Dervishi (Strugë)



HAPJA SOLEMNE E PUNIMEVE TË KONFERENCËS SHKENCORE



SKENDER ASANI, ITSHKSH-SHKUP

—Fjalë përshëndetëse—

E nderuara familje Kodra,

Të nderuar studiues, studiues dhe miq të prof.Kodrës.

Është një nderë e veçantë që Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve dhe Shoqata e Historianëve Shqiptarë të Maqedonisë, sot e përkujton një figurë madhore të historiografisë shqiptare, siç ishte dhe mbetet prof.dr.Masar Kodra.

Ne të gjithë që në forma të ndryshme kemi arritur që ta njohim prof. Kodrën, kemi marrë nga pak frymëzim nga puna dhe shëmbëlltyra e tij e pakrahasueshme. Ai nuk ishte vetëm se një profesor i spikatur dhe me karakter të fortë, por edhe një edukator i çiltër, i cili neve studentëve na e trasonte rrugën e progresit dhe zhvillimit.

Për më tepër, prof.dr.Masar Kodra. dallohej për kontributin e tij madhor në zhvillimin e shkencës historike në gjuhën shqipe gjithandej trojeve shqiptare. Ai ishte një udhërrëfyes për shumë gjenerata studentësh në Universitetin dhe Universitetin e Tetovës, ku e kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij.

Prandaj, ne sot e ndjejmë për obligim që edhe në këtë formë arrijmë ta kujtojmë veprën e prof.Kodrës, e cila do të mbetet e përjetshme.

Ju faleminderit shumë!

IBRAHIM GASHI, UNIVERSITETI I PRISHTINËS

–Fjalë përshëndetëse–

E nderuar familje e prof. dr. Masar Kodrës,

I nderuar Këshill Organizues,

Të nderuar të pranishëm,

Ndjehem i nderuar që në emër të kolegëve mësimdhënës dhe studentë të Universitetit të Prishtinës mund të them disa fjalë për kontributin e prof. dr Masar Kodrës si profesor në Departamentin e Historisë të Universitetit të Prishtinës, në periudhën kohore 1975–1991.

Kontributi i profesorit Masar Kodrës si mësimdhënës dhe studiues i historisë ishte aq i madh sa që secili nga historianët e brezit të tij dhe të tjerët më pas e shohin më admirim të lartë.

Profesor Kodra rridhte nga një familje e arsimuar dhe atdhetare. Me punën e tij të palodhshme ai do ta lartësoj edhe më shumë këtë kulturë dhe këtë fisnikëri familjare. Si gazetar, si shkencëtar, si profesor universiteti, si veprimtar i çështjes kombëtare dhe si dekan i fakultetit, ai dëshmoi vlera të larta krijuese e profesionale dhe njerëzore e kombëtare.

Në Universitetin e Prishtinës, profesor Kodra erdhi në kohën e duhur, kur po hapeshin mundësitë e avancimit të studimeve të historisë nacionale. Me një diplomë doktorate nga Universiteti i Zagrebit, profesor Kodra ishte personi që më kompetencë profesionale, por edhe me guximin intelektual kontribuoi në rritjen e Departamentit të Historisë ku edhe punonte.

Profesor Masar Kodra dhe profesor Ali Hadri janë më meritoret në ngritjen dhe reformimin e studimeve në Departamentin e Historisë. Vendimtar ishte insistimi i tyre që Historia e Popullit shqiptar të ndahej në katër lëndë të veçanta që do të mbulonin periudhat nga Antikiteti deri të Koha më e Re, sipas viteve të studimeve.

Veprimtaria e shkencore dhe kombëtare e prof. Masar Kodrës ishin të pandara deri në frymën e fundit të tij. Universiteti i Prishtinës ka pasur dhe ka njerëz të aftë dhe pedagog të zotë, por profesor Masar Kodra edhe me tej mbetet një nga simbolet e krenarisë sonë institucionale dhe akademike.

I përjetshëm qoftë kujtimi për prof. Masar Kodrën!

Ju faleminderit!

FATMIR (MASAR) KODRA, NË EMËR TË FAMILJES KODRA
–Fjalë përshëndetëse–

Të nderuar profesorë e studiues, përfaqësues të institucioneve kulturore dhe shkencore, përfaqësues të familjeve të dëshmorëve, përfaqësues të mediave të shkruara e elektronike, miq e kolegë të Masar Kodrës,

Të respektuar zonja e zotërinj,

Në emër të familjes Kodra, Ju falënderoj nga zemra për këtë solemnitet e konferencë shkencore të çmuar që keni organizuar sot në ambientet e ITKSHSH-së për më të dashurin tonë, bashkëshortin, prindin e gjyshin tonë, Masar Kodrën.

Të flasësh për një personalitet aq të madh dhe më shumë për paraardhësin tënd, është një punë me plotë emocion dhe me kujtime të paharruara.

Pikërisht mençuria, bujaria dhe guximi i jashtëzakonshëm që Ai kishte edhe në kohët më të vështira për të dhe për popullit tonë, janë udhërrëfyes jetësor për familjen tonë dhe për shumë kolegë, studentë dhe bashkëkohanikë të prof. Masar Kodrës.

Trashëgiminë më të madhe që ne e kemi nga Babai ynë, është krijimtaria e tij shkencore dhe kulturore, me një opus të madh të punimeve e të monografive shkencore. Qëndrimi i tij ishte i palëkundur përbri popullit shqiptar në trevat lindore e verilindore (Maqedoninë perëndimore e Kosovë) në kërkesat për liri. Ishte frymëzues i pavarësisë politike të shqiptarëve në trevat e tyre etnike, i ngritjes së vetëdijes shoqërore nëpërmjet arsimimit e kulturës, si dhe përkushtimit ndaj librit, leximit. Kishte një bibliotekë ndër më të pasurat në rajon për historiografinë, dhe një përcaktim principiel për fëmijët e studentët e tij për lexim, mësim, shkrim dhe përkushtim të madh e përkrahje për institucionet tona kulturore dhe shkencore, për të cilat Ai aq shumë ka kontribuar dhe ka sakrifikuar.

Ideali i prof. dr. Masar Kodrës që e shoqëroi gjatë tërë jetës dhe veprës së tij, për një jetë dhe pozitë meritore, të lirë dhe të drejtë për popullin shqiptar në trevat etnike autoktone, e bënë atë një ndër figurat më unifikuese për tërë spektrin politik e shkencor, e me këtë edhe një trashëgimi detyruese për neve pjesëtarët më të ngushtë të familjes së tij, që përkundër angazhimeve të ndryshme, që të kemi kujdesin dhe të jemi të gjithëpërfshirës dhe unifikues.

Pikërisht ky ideal për liri dhe pavarësi politike për popullin e tij në Maqedoni e Kosovë, e bënte prof. Masar Kodrën të palëkundur në veprimtarinë e tij kulturore, shkencore e arsimore për gati një gjysmë shekulli....

Ju faleminderit!

–MIRËNJOHJA PAS VDEKJES, ME TITULLIN AKADEMIK

Me rastin e 85 vjetorit të lindjes, Akademia Shqiptare Amerikane e Shkencave dhe Arteve, me seli në Shkup, prof. dr. Masar Kodrën, pas vdekjes, e nderoi me titullin Akademik.

Në konferencën shkencore për jetën dhe veprimtarinë e profesorit të nderuar, Masar Kodra, të organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve dhe Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, kryetari i kësaj Akademie, prof. dr. Abdulla Mehmeti, ia dorëzoi këtë mirënjohje të lartë familjes së profesorit Masar Kodra.

Në vazhdim, përmbajtja autentike i Certifikatës dhe motivacioni për dhënien e saj:

AKADEMIA SHQIPTARE AMERIKANE E SHKENCAVE DHE ARTEVE, NJU JORK–SHKUP

I JEP

PROF. DR. MASAR KODRËS (Pas vdekjes)

Titullin AKADEMIK

Për kontributin e shquar në shkencat e historisë, përhapjen dhe përparimin e arsimit shqip, përgatitjen e kuadrit të ri për nevojat e universiteteve shqiptare dhe të institucioneve të tjera kulturore e shkencore, si dhe veprimtarinë atdhetare për zhvillimin dhe afirmimin e çështjes kombëtare.

Shkup, 15.09.2017

KRYETARI

Prof. Dr. Abdulla Mehmeti



PUNIMET E KONFERENCËS SHKENCORE



NEBI DER VISHI*Universiteti i Tetovës***PROFESOR MASAR KODRA – JETA DHE
VEPRA (1932 – 2003)***(Me rastin e 85 vjetorit të lindjes)*

Masar Kodra është një nga figurat e rëndësishme të botës intelektuale kombëtare të gjysmës së dytë të shek. XX. Ai i takon brezit të studiuesve, profesorëve dhe intelektualëve shqiptarë të cilëve iu desh të merrnin mbi vete detyra që dilnin përtej atyre që shtron vokacioni i studiuesit dhe i profesorit universitar në vende dhe rrethana morale, obligime të ndriçimitarit, të organizimit të arsimit të lartë e universitar, në përgjithësi të veprimtarit shoqëror e kulturor, të personalitetit që duhet t'i dalë në mbrojtje së vërtetës. Detyra arsimore, ndriçimtare, përveç të studimit, prof. dr. Masar Kodra dhe brezi i tij u deshën të merrnin mbi vete qysh në periudhat më të rënda për botën shqiptare në Jugosllavinë e viteve '60 të shek. XX. Ndryshimet pas vitit 1966, intelektualët e atyre brezave ditën t'i shfrytëzonin për të liruar energji të pazakonshme pozitive emancipuese, ndërtuese dyfish themelvënëse: të mbledhjes së fijeve që kishin mbetur të shpërndara nga ndjekjet e mëparshme dhe të kalimit në një shkallë më të lartë të organizimit institucional, të veprimit shoqëror dhe zgjerimit të horizonteve të arsimit universitar dhe të studimeve shkencore. Ai brez u desh të luftonte për zgjerimin e të drejtave shoqërore e kombëtare të shqiptarëve me synim barazimin me popujt e tjerë të atij shteti, ndërsa Masar Kodra së bashku me Akademik Ali Hadrin ishin gjithnjë ndër të parët.

Ai brez e dinte dhe e ndeshte në çdo hap të vërtetën se për të arritur një të drejtë, për të hapur një horizont lirie, nuk mjaftonte vetëm të kërkojë, po duhej të krijoheshin kapacitete vetanake për t'i krijuar dhe shfrytëzuar hapësirat e mundshme. Si studiues e historian i formuar dhe si njohës i jashtëzakonshëm i rrethanave në Ballkanin e trazuar, sidomos gjatë shek. XX, i mbrujtur me ndjenjën e drejtësisë dhe të barazisë, ai nuk mundi të mos i shihte se një burim i madh i padrejtësive ishte sundimi i oligarkive të popujve të ndryshëm mbi popujt e tjerë. Personalisht profesor Masar Kodra këto momente padrejtësie i përjetoi në familjen e tij të ngushtë, me vëllain e tij më të madh Xhafer Kodrën, lindur më 1923, komisar politik i Brigadës së IV Shqiptare dhe pas Luftës, ministër, të cilin pas arrestimit e burgosjes në burgun e Goli Otokut, e torturuan në mënyrë çnjerëzore deri në çmenduri, i cili vdes nga pasojat dhe varroset në vendlindje, në Dibër më 1 maj 1994.

Profesor Masar Kodra lindi në Dibër të Madhe, më 1 gusht 1932, në një familje me tradita atdhetare e arsindashëse dibrane, nga prindërit Sulejman bej Kodra dhe nëna Idajet Agolli, të cilët banonin në lagjen “Kodra e Kasapit”.

Shkollimin fillor e kreu në vendlindje. Klasën e parë e kreu në gjuhën serbe, ndërsa vitet e tjera në gjuhën shqipe ku ka pasur mësues Remzi Papranikun, pishtarin e arsimit. Shkollimin e mesëm e mbaroi në Shkollën Normale “Liria” në Shkup e Tetovë, duke qenë në mesin e gjeneratave të para të shkollës së mësuesit në vitin shkollor 1950 / 51. Studimet universitare i mbaroi në vitet 1951–1955, në Fakultetin Filozofik, dega Histori, të cilat i filloi në Shkup, i vazhdoi në Universitetin e Lubjanës dhe i përfundoi po në Shkup, në Universitetin “Shën Kirili e Metodi”.

Pas diplomimit, në vitin shkollor 1955– 1956, prof. Masari filloi me punë në Shkollën Filllore “Liria” në Shkup. Në shtator të vitit 1957, me vendim të Ministrisë së Arsimit caktohet drejtor i Shkollës Filllore “Mosha Pijade”, e cila u formua pas ndarjes së shkollës “Liria”. Me shkollën e porsaformuar, ai drejtoi deri në shtatorin e vitit 1960.

Në periudhën shtator 1960 – funddhjetor 1966, Masar Kodra ishte gazetar dhe redaktor i gazetës “Flaka e Vëllazërimit”. Duke shfletuar gazetën “Flaka”, në këto vite lexojmë nga ai qindra reportazhe, informacione e punime nga të gjitha trevat etnike shqiptare, që nga Ulqini, Mitrovica e Presheva e deri në Manastir e Prespë. Në faqet e kësaj gazete do të ndeshim punime të prof. Masarit edhe në vitet në vijim.

Më 1 janar të vitit 1967, Prof. Masar Kodra zgjidhet asistent në Institutin e Historisë Nacionale të Maqedonisë, në Departamentin e Historisë Bashkëkohore, e nga 01.09.1969, në Sektorin e Historisë Ballkanike.

Në tetor të vitit 1974, Prof. Masari nisi me punë në Fakultetin Filozofik, Departamenti i Historisë, në Universitetin e Prishtinës, ndërsa në dhjetor të po atij viti, në Universitetin e Zagrebit, para komisionit profesional mbrojti tezën e disertacionit “Pjesëmarrja e shqiptarëve në Luftën NÇ (1941 – 1945) dhe mori gradën shkencore Doktor i shkencave historike.

Pas doktorimit, profesor Kodra së bashku me Akademik Ali Hadrin në tetor – nëntor 1974, në Katedrën e Historisë i hapin studimet pasuniversitare në Universitetin e Prishtinës.

Pasi doli në pension, prof. Masar Kodra, në vitin 1994 së bashku me prof. Fadil Sulejmanin me shokë, janë ndër të parët në nismën

për themelimin e Universitetit të Tetovës, dhe dekan i parë i Fakultetit Filozofik në vitet 1994–2000.

Pas një sëmundje të rëndë e të pashërueshme, prof. Masar Kodra në moshën 71 vjeçare ndërroi jetë dhe u varros në varrezat e Butelit në Shkup.

Profesor Masar Kodrën dhe brezin e tij e ndrydhte pabarazia kombëtare. Ndarjet, pushtimet dhe ripushtimet e hapësirave shqiptare dhe imponimet e sundimeve të huaja mbi ta, ai nuk mund të mos i shihte, si një prej burimeve kryesore për tragjeditë, vrasjet dhe shkatërrimet në masë, gjenocidet e ricikluara në Kosovë dhe në viset e tjera të ish–Jugosllavisë.

Si historian i shquar i mbrujtur me sensin për drejtësi e humanizëm e si atdhetar, prof. Masar Kodra i kuptonte mekanizmat e padrejtësive, të pabarazisë dhe te segregacionit etnik dhe vazhdimisht bashkë me brezin e intelektualëve të paktë të kohës së tij, kërkonte rrugë për kapërcimin e asaj gjendjeje. Emancipimi shoqëror dhe zhvillimi ekonomik në vizionet e tij ishin parakushte për daljen nga kjo gjendje.

Intelektual i së majtës, Masar Kodra luftonte për barazi shoqërore të gjithëve dhe kundër shtypjes së kujtdoqoftë. Elani dhe fryma e vitit 1968 nuk mund të kalonin pa vrojtimin e Masar Kodrës në vitet që do të vinin.

Studimet e tij në Shkup, Lubjanë e Zagreb, Masar Kodra i kishte lidhur me pjesëmarrjen e shqiptarëve në Luftën e Dytë Botërore, duke synuar kështu, jo vetëm ndriçimin e rrethanave të asaj kohe dhe të orientimit të shqiptarëve në to, po edhe dëshminë se ata edhe në ato kohëra kishin luftuar për të vënë themelet e mëvetësisë dhe të shtetit që kërkonin të ndërtonin.

Studimet e Masar Kodrës, ndërkaq janë shtrirë në fusha më të gjëra të historiografisë shqiptare, sidomos në pikat që janë shënuar si ndërtuese të identitetit: periudha ilire (punime që janë në dorëshkrim) dhe shteti ilir, periudha e Skënderbeut (punime të botuara e të pabotuara), Rilindja Kombëtare Shqiptare, te historia dhe pozita e rëndë e shqiptarëve në Jugosllavi midis dy luftërave botërore, për të arritur në vitet e Luftës së Dytë Botërore.

Derisa në studimet për ilirët për periudhën e Skënderbeut dhe për epokën e Rilindjes dhe pas shpalljes së Pavarësisë së shtetit Shqiptar 28.XI.1912, prof. Masar Kodra kishte hyrë kryesisht me hulumtime vetanake, në studimet për periudhat më të vona, të pjesës së parë të shek. XX, ai kishte nxitur së bashku me Akademik Ali Hadrin për të formuar grupe të tëra studiuesish të rinj, sidomos për tema si, pozita e shqiptarëve në Jugosllavi e viteve 20–30 të shek. XX, çështja e Reformës agrare dhe kolonizimi në Kosovë, shtypja dhe shpërngulja e shqiptarëve para dhe pas LDB-së dhe për temat e gjëra dhe të zbërthyera gjerësisht lidhur me atë luftë.

Puna shkencore e Masar Kodrës është tepër e frytshme dhe e begatë me punime të larmishme historike. Janë mbi 50 punime shkencore, të shkruara në mbi 2000 faqe dhe të botuara në revista të ndryshme shkencore si në: “Përparimi”, “Jehona”, “Gllasnik”, “Kosova”, “Vjetari i Arkivit të Kosovës”, “Gjurmime Albanologjike”, etj., të cilat janë një thesar diturie për brezat dhe studiuesit e ardhshëm të historisë mbarëkombëtare.

Prof. Masar Kodra hyri në botën e shkencës duke pasur një kulturë historike solide, traditë atdhetare familjare, si dhe duke disponuar një bagazh të gjerë njohurish sa i përket përcjelljes së rezultateve që kishte arritur historiografia këndeje e andej kufirit shqiptaro – shqiptar në lëvrimin e së kaluarës së bujshme të historisë së popullit

shqiptar. E tërë kjo ishte rezultat i kujdesit të jashtëzakonshëm që i kushtonte përvetësimit të gjuhëve, në radhë të parë të shqipes, e pastaj të italishtes, turqishtes, anglishtes, serbokroatishtes, etj. Duke pasur parasysh kërkesat e historiografisë moderne, ai nisi kërkimet sistematike rreth shfrytëzimit të burimeve të dorës së parë, e sidomos të atyre të pabotuara, material këto që ishin mbështetje kryesore në trajtimin e problemeve historike. Duke përdorur metodën analitike dhe atë sintetike, ai i shoshiti një varg çështjesh me interes kombëtar për ndriçimin e problemit të përfshirjes së shqiptarëve nga trevat etnike lindore në Luftën e Dytë Botërore.

Të flasësh e të shkruash për kontributin që i ka dhënë prof. dr. Masar Kodra historiografisë shqiptare, e në këtë kuadër edhe historiografisë së Luftës së Dytë Botërore në përgjithësi dhe Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në veçanti, është një obligim dhe përgjegjësi e madhe nga se sado që studiuesi serioz dhe i vëmendshëm të mundohet me përfshi këtë kontribut ma thotë mendja se më gjithë përkushtimin nuk do të mundemi me një portret disa faqesh t'i dalim borbxh këtij kolosi të historiografisë sonë kombëtare.

Prof. dr. Masar Kodra me opusin e tij krijues sidomos për periudhën e Luftës së Dytë Botërore jo vetëm që ka zënë vend meritëtor në historiografinë shqiptare si shkencëtar e historian i talentuar dhe i shquar e që ka dhënë edhe kontribut të jashtëzakonshëm edhe në avancimin e historiografisë shqiptare duke e ngritë atë në një shkallë konkurruese me atë rajonale të kohës. Ai me kontributin e tij të çmuar jo vetëm që i vuri themele të forta historiografisë sonë që po lindte, e sidomos historisë së Luftës së Dytë Botërore në përgjithësi, por vuri themele të forta edhe historisë së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe kritikës historiografike në veçanti.

Ai si një intelektual e patriot, njohuritë e tij të gjëra në fushën e historisë, aftësitë e talentin e tij si pedagogë i shumë brezave e si studiues i pasionuar, ia kushtoi tërë jetën zhvillimit të arsimit, të kulturës dhe mbi të gjitha të shkencës historike shqiptare në viset shqiptare në ish – Jugosllavi.

Prof. Masar Kodra thonte se: “Historia e shqiptarëve të Maqedonisë është pjesë e pandarë e trashëgimisë së popullit shqiptar, çështja kombëtare e të cilit ka mbetur gjithnjë e hapur, e pazgjidhur dhe si e tillë tepër e dhimbshme. Diplomatët evropianë dhe ballkanikë, përmes forumeve ndërkombëtare, kongreseve dhe konferencave, sa në Berlin (1878), aq më tepër në Londër (1913), e Versajë (1919), e gjymtuan pamëshirë dhe sa mundën tërësinë tokësore të popullit shqiptar, duke e lënë në udhëkryq pjesën e saj më vitale... Prandaj, gjatë tërë shek.XX, sado të copëtuar, shqiptarët luftuan, protestuan, dërguan qindra memorandum për të realizuar aspiratat e bashkimit kombëtar... Shqiptarët e Maqedonisë Perëndimore (lexo Shqipërisë Lindore, se kështu me ëndje e dëgjonte këtë emërtim profesor Masari i nderuar), si mbarë populli shqiptar, dëshmuuan nivel më të lartë politik, duke u shprehur për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare në vitet 1941–1944, me shpresë se kështu do të kontribuonin për bashkimin kombëtar dhe të mos akuzoheshin pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore si mbeturina të reaksionit të cilat duhej asgjësuar”.

Pra, qëllimi i studiuesit dhe historianit Kodra ishte të hidhte poshtë tendencat e historiografisë sllavo – maqedonase rreth pjesëmarrjes së shqiptarëve në Luftën Antifashiste, duke ardhur në fund në përfundime se shqyrtimi i çështjes së shqiptarëve të Maqedonisë gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore (1939–1944), paraqet përpjekjen e parë për zbardhjen e saj, duke u bazuar në të dhënat arkivore të

botuara e të pabotuara, literaturën relevante dhe materialet memorial të cilat plotësojnë një zbrazëturë në suazat e përgjithshme të historiografisë.

Pjesëmarrja e shqiptarëve në Maqedoni në LANÇ, mendonte profesor Kodra, megjithëse nuk realizoi idealin e tyre për bashkim kombëtar, përsëri ka përparësi të padiskutueshme. Shqiptarët në përfundim të luftës nuk mund të akuzoheshin se ishin kundër Lëvizjes Antifashiste, si bashkëpunëtor të okupatorit, dhe kjo të shërbente si pretekst për dëbimin e tyre përmes shpërnguljes masive nga Maqedonia.

Profesor Masar Kodra për gati gjysmëshekulli punoi në mënyrë intensive edhe si hulumtues, shkencëtar e historian, edhe si gazetar e publicist. Ishte studiues i palodhur dhe pedagog me dijetet të lartë. Ai me zell të madh vazhdoi punën e shumë historianëve shqiptarë, duke qëndruar në krye të aktiviteteve në vitet 1991 – 2001, duke organizuar konferenca, tribuna e simpoziume shkencore si në Kondovë në dhjetor të vitit 1991, fryt i së cilës ishte botimi i materialeve të konferencës “Shqiptarët e Maqedonisë”, Shkup, 1994; Simpoziumi në Dibër “Etnokultura e Dibrës”, Konferencat shkencore në Strugë në vitet 1993, 1994, 1995, 1996, 1997, 1998, 1999, 2001, etj. Pastaj, konferenca shkencore kushtuar 90 vjetorit të Kongresit të Manastirit, mbajtur në Gostivar më 21 – 22 nëntor 1998, etj.; tribuna të shumta shkencore të cilat ishin në shërbim të shënimit dhe ndriçimit të ngjarjeve si dhe personaliteteve tona historike, ku kontributi i profesor Masar Kodrës ishte i padiskutueshëm, etj.

Një kontribut të veçantë prof. Masar Kodra dha edhe në përpilimin e librave të historisë për shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë, së paku në 5 libra në bashkautorësi, etj.

Në vitin 1996 profesor Masar Kodra botoi librin monumental “Shqiptarët e Maqedonisë gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore (1939 – 1944)”; Në vitin 1997 boton librin e dytë “Fan Noli në jetën politike të shoqërisë shqiptare (1908 – 1945)”, dhe librin e tretë “Çështja shqiptare në analet diplomatike Amerikane (1918 – 1945)”, botuar në Shkup më 1997, etj.

Dua të theksoj se ndihmesa e prof. Masar Kodrës në studimet historiografike e diplomatike, në veprimtaritë shkencore, në organizimin dhe ngritjen e institucioneve të shkencës dhe të arsimit të lartë (Universiteti i Tetovës, duke qenë njëri ndër të parët së bashku me prof. Fadil Sulejmanin me shokë në vitin 1994, dhe dekani i parë i Fakultetit Filozofik), në formimin e studiuesve dhe historianëve të rinj (shkolla e Masar Kodrës ku bënë pjesë edhe vetë autori i këtij portreti) e në fusha të tjera të rëndësishme për zhvillimet në Kosovë e në Maqedoni, si edhe në tërë botën shqiptare në tërësi nuk mund t’i fshinte asçfarë procesi diferencues, ndëshkues apo harresat e qëllimta.

Gjërat e mëdha bëhen me pasion ka thënë dijetari. Masar Kodra mbahet mend për pasionin me të cilën i bënte punët e tij shkencore, profesionale akademike, shoqërore dhe intelektuale.

Vështrimi objektiv i rrethanave, si edhe ndihmesave dhe arritjeve në atë rrethana të dijetarit dhe intelektualit të shquar dibran, na obligon ashtu siç na obligon borxhi që kemi si breza për të ndriçuar dhe respektuar personalitete të rëndësishme të se kaluarës së afërt e të largët.

Prof. Masar Kodra me intuitën intelektuale, me praktikizmin dhe vlerat e një organizatori e menaxheri me një dhunti të veçantë që me pak mjete dinte të bëjë shumë punë, me përkushtimin total për

t'i shërbyer me shumëçka çështjes kombëtare dhe me shpirtin altruist për t'i ndihmuar kolegët, bashkëpunëtorët, ish-studentët, miqtë të njohur e deri te të panjohurit, ai për çdo çështje sa do të ndërlikuar në rrafshin teorik dhe organizativ në çdo moment ka ofruar zgjidhje optimale, më racionale dhe më vizionare. Si i tillë ishte një model krejt i arrirë i studiuesit e profesorit të klasit të parë, dhe i aftë për të përballuar sidat e organizimit të çdo veprimtare shkencore në nivel kombëtar e mbarëkombëtar.

Portreti që po lexoni kushtuar jetës dhe veprës së Masar Kodrës, me rastin e 85 vjetorit të lindjes (10 gusht 1932) dhe 14 vjetorit pas ndarjes nga jeta (08.07.2003), është jo thjeshtë një homazh kushtuar intelektualit dibran, historianit, studiuesit dhe vizionarit të shquar për zhvillimin e arsimit, kulturës dhe shkencës në trevat lindore e verilindore shqiptare (Maqedoni Perëndimore e Kosovë), veçanërisht disiplinave albanologjike. Evidentimi i veprës së këtij “patriku” të shkencave humane në këto treva etnike shqiptare, i bënë nder albanologjisë e veçanërisht historiografisë shqiptare në përgjithësi, dhe na përcjellë njëherësh mesazhe të vyera në këtë stad të sotëm të zhvillimeve kombëtare e ndërkombëtare vendimtare për të ardhmen e kombit shqiptar, për zhvillimin gjithëdimensional të të gjithë botës shqiptare.

Profesor Masar Kodra kishte natyrë të çelur, ishte bashkëbisedues i këndshëm dhe me disponim për t'u mahnitur, ishte i matur dhe i shoqërueshëm, i fjalës e i veprës, ishte kategorik në bindjet e tij. Në shumë ndeje e takime të rastit, profesori na fliste për subjektin politik shqiptar, për unitetin kombëtar, për ecjaket (vizitat) në Kosovë pas vitit 1989, për simpoziumet e konferencat e shumta me karakter gjithëshqiptar, për rolin e arsimit, emancipimit të femrës dhe për shumë tema të tjera.

Prof. Masar Kodra me jetën e tij modeste dhe me virtytet e tij të larta humane, do të përkujtohet me respekt të plotë nga miqtë, bashkëpunëtorët dhe ish-studentët, sepse personi dhe personaliteti i prof. Kodrës me një stil jetësor dhe me krijimtari të veçantë do të bahet mend për të mirë, e kundër të keqes. Mbahet dhe do të mbahet mend që na e mësoi historinë kombëtare dhe atë ballkanike. Janë nxënësit dhe studentët e tij që i morën mësimet. Nxënësit e nxënësve të tij e bënë historinë!

DAUT BISLIMI

Prishtinë

**KONTRIBUTI I PROF.DR MASAR KODRËS
NË HISTORIOGRAFINË
SHQIPTARE PËR LUFTËN E DYTË
BOTËRORE**

Është konstatim i përgjithshëm se historia e kombit shqiptar ka disa pika e kthesa të rëndësishme. Sigurisht, kulminante është Lufta Çlirimtare Antifashiste e popullit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në histori kemi mësuar, se për shumë kombe, fatalitetet, jo pak herë kanë sunduar epokën e caktuar historike. Dhe kur e kanë bërë kështu, plagat historike janë më të ndjeshme. Gjithashtu, historiografia shkencore ka konstatuar se kur gabohet në histori, në mënyrë të pashmangshme do të pasojë edhe përmbysjat historike, e zhvillimit të ngjarjeve brendakombëtare.

Këtë e thash me arsyen se asnjë luftë e kohës së re për popullin shqiptar, nuk ka qenë aq dinamike në zhvillim dhe aq e nduarduartë në përbërje, sikurse ishte Lufta Çlirimtare Antifashiste. Nga përmasat e zhvillimit të kësaj lufte dallohet edhe territori i gjerë i Shqipërisë Etnike, në të cilën hapësirë ngjarjet u zhvilluan me një dinamikë të shprehur dhe në dukje mjaftë të ashpra dhe të dhembshme për popullin shqiptar.

Eruditi prof. Masar Kodra, duke i pasur parasysh këto të dhëna dhe duke i trajtuar problemet dhe rrjedhat e ngjarjeve historike në kuadër të kësaj lufte, synim kryesor kishte t'i vë në shqyrtim forcat

e armatosura shqiptare të rreshtuara në krahun e Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare nga PKJ—së në një anë, dhe ato të Frontit Kombëtar Shqiptar në anën tjetër, me të gjitha kundërthëniet dhe antagonizmat politike e kombëtare në mes këtyre dy forcave kundërshtuese, në fushën e organizimit shoqëror—politik dhe organizativo—ushtarak për çlirimin kombëtar shqiptar në këtë luftë.

Tashmë të çliruar nga ata që e shkruanin historinë e popullit shqiptar për Luftën e Dytë Botërore, dhe mbështetur në të dhëna faktografike, profesori Masar renditej çdo ditë drejt historisë së vlerave të vërteta të kësaj lufte, vlera të cilat kundërshtojnë me vendosmëri e me fakte të dhënat dokumentare në ato 50 vite të pseudoshkencës për shqiptarët etnik në Luftën e Dytë Botërore.

I këtillë ishte profesori i ynë, dr. Masar Kodra, i brumosur me ndjenjën e atdhedashurisë, i cili qysh në moshë të re iu rrek detyrës së arsimit të shoqërisë shqiptare, së cilës nuk iu nda deri në ditët e fundit të jetës.

Profesor dr. Masar Kodra ka një prodhimtari shkencore që mbulon një periudhë 50—vjeçare, duke filluar si Bashkëpunëtor shkencor në Institutin e Historisë Nationale në Shkup, duke vazhduar si Bashkëpunëtor i jashtëm shkencor në Institutin e Historisë të Prishtinës, në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në Arkivin Shtetëror të Kosovës, dhe në shumë institucione shkencore brenda dhe jashtë vendit, e duke përfunduar si pedagog që nga fillimi në Universitetin e Prishtinës dhe atë të Tetovës.

Shkrimet e para shkencore për Luftën Çlirimtare Antifashiste, profesori Masar, zuri t'i shtjellojë më 1967—68.

Ai në studimet e tij serioze për shqiptarët në Luftën Çlirimtare Antifashiste, nxori konkluzion, se pa marrë parasysh pohimet e men—

dintarëve tjerë, veçanërisht të historiografisë pseudoshkencore pansllave, se faktori vendimtar për çlirimin e popullit shqiptar në këtë luftë, ka qenë lufta heroike e popullit shqiptar për aspiratën e çlirimit kombëtar, detyrë e pazgjidhur deri atëherë, kuptohet me përkrahjen e faktorit ndërkombëtar.

Sot, ne kemi mundësi ta vështrojmë Luftën Antifashiste Nacional-çlirimtare, jo si dikur nën presionin e saj, por si ngjarje që tashmë ka hyrë në histori.

Duke pasur mbështetjen në faktografinë e argumentuar mirë, të paraqitura në punime studimore, në materiale dhe në botime të veçanta monografike dokumentare si edhe ato shkollore për shqiptarët në Luftën Nacionalçlirimtare Antifashiste, si ato angleze, serbe etj., bindshëm e guximshëm iu kundërvu propagande pseudoshkencore serbe dhe asaj të huaj, duke vënë saktë në dijeni se: në organizimin dhe në Luftën Çlirimtare Antifashiste, kanë marrë pjesë personalitete me vlerë e peshë historike dhe me botëkuptime të ndryshme, si ato të nacionalizmës progresive shqiptare dhe atyre të forcave të ideologjisë së kuqe, por motivet e tyre në radhë të parë kanë qenë mbrojtja dhe çlirimi i territoreve të Shqipërisë etnike, të cilat rrezikoheshin seriozisht nga politika ekspansioniste e apetiteve të fqinjëve përreth, që gëzonin përkrahjen e plotë të Rusisë, e cila korrespondonte me jogatishmërinë e fqinjëve serbosllavë, për zgjidhjen e çështjes shqiptare në këtë luftë. Kështu, padrejtësisht nuk u mbështet projekti i krerëve të nacionalizmës shqiptare për një luftë të përbashkët drejt zgjedhjes së çështjes shqiptare. Profesori Masar Kodra, nxori përfundimin se Lufta e Dytë Botërore, përkatësisht Lufta Antifashiste, ishte luftë gjithëkombëtare, e radhitur në krahun e luftërave çlirimtare të botës demokratike, në të gjitha fazat e saja të veprimit, dhe sipas të gjitha përmasave, për

popullin shqiptar paraqet një vlerë shumë të madhe, të çmuar dhe të përjetshme në historinë tonë kombëtare dhe si e tillë, do të mbetet si epilog i një historiani të lavdishëm shqiptar.

Duke pasur për bazë angazhimin shkencor, është konstatim i përgjithshëm i historiografisë shqiptare se prof.dr. Masar Kodra, për ta shprehur bindshëm Luftën Antifashiste gjatë viteve vendimtare 1941–1945 dhe menjëherë pas, në fushën e interesimit të dijes së tij, bëri një angazhim përgatitor e detajues nga shumë burime studimore për të hyrë thellë në zhvillimin e ngjarjeve dhe rrethanave të periudhës së caktuar kohore. Kështu, studimet e prof.dr.Masar Kodrës në themel të çështjeve dhe problemeve që trajtohen, kanë mbështetje të gjerë burimore, arkivore dhe bibliografike. Ato sjellin një kontribut të rëndësishëm për ngjarjet e viteve 1941–1945, duke trajtuar edhe probleme të mprehta politike, sociale, ekonomike, arsimore etj., gjatë periudhës në shqyrtim. Nga sfondi historik, që jepet në pjesën më të madhe të botimeve monografike dhe të studimeve shkencore historike, del qartë se prof.Masar Kodra jo vetëm që i ka ndjekur hap pas hapi këto ngjarje me karakter gjithëkom-bëtar, por edhe i ka parë të ndërlidhura ngushtë me gjendjen e Shqipërisë Etnike.

Tërë jetën profesor Kodra shkroi libra, studime serioze historike, artikuj, ese, dhe dha intervista për çështjet më të debatueshme për shqiptarët në Luftën Antifashiste, duke na zbuluar shumë të panjohura për popullin shqiptar në këtë luftë, pa e vënë re asnjëherë lodhjen.

Punimet, polemikat, fjala e tij në simpoziume dhe në konferencat shkencore, bisedimet e kontaktet më personalitete të huaja nga fusha e dijes historike, janë disa nga fushat kryesore të punës së tij

që i përballonte me përgatitje shkencore dhe kurajë nga pozita patriotike dhe demokratike.

Profesori Masar Kodra bëri një luftë të ashpër me mediokritët dhe pseudoshkencëtarët dhe studiuesit e huaj të historisë, për pjesëmarrjen e shqiptarëve në Luftën Çlirimtare Antifashiste, që, jo rra-llëherë këto pseudoshkencëtarë kalonin përtej kufijve me denigrimin që donin t'i bënin shqiptarëve në atë luftë.

Kontributi i profesor Masar Kodrës, në ndriçimin e historisë së Luftës Çlirimtare Antifashiste dhe shqiptarët, do të jetë një gur i rëndësishëm në rishkrimin e historisë sonë për Luftën e Dytë Botërore. Me pasionin e një njeriu që iu përkushtua kërkimit dhe i udhëhequr nga atdhedashuria, profesor Kodra bëri prognozën e Shqipërisë Etnike, duke u nisur nga kohët e fundit të Luftës së Dytë Botërore. Në kaosin e botimeve dhe të shkencës sonë pas viteve '90, por dhe të një sistemi vlerash historike të censuruara për më shumë se 50 vjet, profesor Kodra u përpoq të dilte, përtej duke marrë në dorë flamurin e së vërtetës.

Profesori Masar punoi me forcën e një të riu, duke manifestuar një vullnet e përkushtim në punën shkencore, mori pjesë në shumë simpoziume, konferenca shkencore dhe fushëveprimtari të tjera shkencore brenda dhe jashtë vendit. Një kontribut të veçantë dhe shumë të çmueshëm e dha për ngritjen e kuadrove shkencore në fushë të historisë. Ai ishte mentor i shumë doktorantëve dhe magistrantëve në Fakultetin Filozofik-Departamenti i Historisë në Universitetin e Prishtinës.

Në Universitetin e Tetovës, filloi një periudhë tjetër pune, zgjimi i energjisë intelektuale si asnjë herë tjetër.

Me fillimin e proceseve demokratike prof.dr. Masar Kodra u radhit ndër intelektualet dhe historianët më të denjë për rishikimin kritik të historiografisë ideologjike–komuniste dhe për studimin me rigozitet dhe objektivitet shkencor të periudhës bashkëkohore të historisë sonë kombëtare.

Me vdekjen e tij studentët, kolegët, miqtë dhe dashamiret e shumë humbën mikun e veteranin e nderuar, shkenca humbi historianin e talentuar. Ai do të kujtohet e do të mbetet gjithnjë i paharruar në kujtesën tonë si njeri i guximit, i vendosmërisë dhe përpjekjeve të mëdha për ngritjen e nivelit shkencor e kulturor të brezit të ri.

HALIM PURELLKU

Universiteti i Tetovës

VËSHTRIM I SHKURTËR MBI VEPRËN E PROF. DR. MASAR KODRËS “SHQIPTARËT E MAQEDONISË GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE (1939–1944)”

Prof. dr. Masar Kodra i takon plejadës së parë të historiografëve që me përkushtimin dhe rezultatet shkencore të arrira, hodhën themelet e historiografisë moderne shkencore shqiptare të këtij krahu, me qendër në Prishtinë. Të theksojmë se kjo plejadë e historiografëve, vepronte në dy fronte, dhe atë: në përgatitjen profesionale të kuadrove të reja për nevojat e institucioneve arsimore të të gjitha niveleve të arsimit shqip, atë të mesëm, të lartë dhe sipërorë në ish RSFJ, si dhe në ngritjen e kuadrove/forcave shkencore të reja në studimet e shkallës së tretë/magjistraturës dhe doktoranturës pranë Universitetit të Prishtinës, që gjithsesi ato këtë mision e realizuan me shumë sukses.

Për gjithë këto të arritura, qoftë në arsimin sipëror apo në fushën e kërkimeve shkencore, edhe prof. dr. Masar Kodra ka dhënë kontribut shumë të çmueshëm si profesor në Universitetin në Prishtinë dhe pastaj në Universitetin në Tetovë. Gjithashtu, prof. dr. Masar Kodra me rezultatet e arritura në veprimtarinë e tij kërkimore shkencore zë vend meritore në historiografinë shqiptare e më gjerë. Ai është autor i shumë punimeve studimore dhe i disa monografive, me objekt trajtimit aspekte të ndryshme të jetës shoqërore politike e kulturore të popullit tonë nga epoka e Skënderbeut e deri në Luftën e Dytë Botërore, që për nga tematika dhe niveli shkencor i shtjelli-

mit të tyre, paraqesin kontribut të çmueshëm në avancimin e mendimit shkencor për çështje konkrete të zhvillimit historik të popullit tonë, në veçanti të shqiptarëve në trevat lindore shqiptare.

Një nga veprat e prof. Masarit është edhe monografia me titull “Shqiptarët e Maqedonisë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939–1944)”, Kumanovë, 1996, 276 faqe. Objekt studimi i autorit në këtë vepër është historia e shqiptarëve të këtij krahu në periudhën midis dy luftërave botërore (1918–1941) dhe në veçanti koha e Luftës së Dytë Botërore (1941–1944) që përbën dhe temën bosht të këtij studimi monografik. Monografia në fjalë është hartuar mbi bazë të të dhënave relevante arkivore të publikuara dhe të pa publikuara të vjela në arkivat e ndryshme në ish Jugosllavi dhe në shtetin shqiptar, si dhe duke iu referuar literaturës relevante historiografike dhe materialit memorial të proveniencave jugosllave, shqiptare, etj. Autori pohon se me qëllim të vlerësimit kritik të zhvillimit të ngjarjeve dhe të proceseve ka bërë sintetizimin e fakteve duke praktikuar metodën përshkruese dhe analitike.

Me këtë monografi besoj se rrumbullakohet puna dhe angazhimi shumëvjeçarë hulumtues dhe studimor i autorit që paraqiste studimin e parë shkencor rreth kësaj problematike nga historia jonë. Në këtë vepër, janë ngritur dhe shtruar konstatime me vlerë, që kontribuuan në avancimin e mendimit shkencorë për çështje nga historia shqiptare në periudhën midis viteve 1918–1944, dhe në veçanti për kohën e Luftës së Dytë Botërore që është dhe objekt kryesor i këtij studimi monografik. Në këtë kuadër, do veçuar disa nga ato konstatime: Pas pushtimit italian të një pjese të Trevave Lindore Shqiptare, që në këtë monografi emërtohen si “Maqedonia Perëndimore”, politika demagogjike italiane këtu nuk u favorizua nga shqiptarët e kësaj ane. Kjo dëshmohet dhe me faktin se inicia-

tiva italiane për formimin e Partisë Fashiste nuk qe mbështetur nga shqiptarët e këtyre trevave. Por, as edhe Partia e Ballit Kombëtar nuk ia doli të organizon këtu struktura (degë e nëndegë) të veta partiake, për dallim prej Organizatës “Lidhja e Dytë e Prizrenit” e cila arriti të shtri aktivitetin e vet politik në këto treva dhe ngriti komitetet/degët e veta në Tetovë dhe në Gostivar, gjë që, sipas autorit, edhe fuqitë (forcat) vullnetare (kreshnike, kufitare) të Xhemë Simnicës (Gostivarit) dhe të Mefail Zajazit (Kërçovës) nuk ishin fuqi (forca) të armatosura të Ballit Kombëtar, por ato ishin të “Lidhjes së Dytë të Prizrenit”.

Mirëpo, dhe sipas vetë autorit, temë bosht e kësaj monografie është veprimtaria politike dhe ajo kryengritëse e të quajturës “Lëvizja Nacional Çlirimtare” e organizuar dhe e drejtuar nga Partia Komuniste e Jugosllavisë dhe vasales së saj, Partisë Komuniste të Shqipërisë. Ne mendojmë, thotë autori, se formimi i organizatave partiake komuniste, si dhe i njërive të armatosura partizane dhe organeve të pushtetit kryengritës komunist në kuadër të luftës antifashiste (LAF) në vitet 1941–1944, të formuara nga shqiptarë të Trevave Lindore Shqiptare, ishte hapi i parë në federalizmin e Maqedonisë. Në mbështetje të kësaj hipoteze, prof. Masari iu referohet fjalëve të Kërste Cërvenkovskit në letrën të cilën ia dërgon Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Maqedonisë, datë 7 korrik të vitit 1943, në të cilën Cërvenkovski thotë se “Maqedonia Perëndimore mund të jetë vetëm autonomi, sikur Kosova, tek e fundit këtë çështje duhet lënë hapur”.

Mirëpo, siç vlerëson dhe autori, Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH) gjatë dhe pas luftës kishte qëndrim nihilist lidhur me statusin autonom politik kushtetues të ardhshëm të “Maqedonisë Perëndimore”. Lidhur me këtë, autori i referohet deklaratës së

PKSH—së se: “Nuk i pranojmë kufijtë të cilët i ka vendosur fashizmi”. Në këtë kuadër, ishte edhe instruksioni i PKSH—së drejtuar celulave/grupeve komuniste shqiptare në “Maqedoninë Perëndimore”, që ata të vepronin “nën ombrellën jugosllave”. Andaj dhe profesori Masar përfundon: “Duket se organet më të larta partiake të Shqipërisë e mbyllën diku në ndërgjegjen e tyre pa përgjegjësi këtë çështje (të kufirit—H.P.) të paktën as që e përmendën më vonë. Politika pansllaviste e kombinuar me komunizmin jugosllav triumfoi edhe njëherë rreth çështjes shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore”. Në mbështetje të këtij përfundimi është dhe e dhëna tjetër faktografike të cilën e hasim në këtë monografi, dhe atë: Në tetor të vitit 1944, një delegacion nga Shteti shqiptar në takimin që pati në Orman të Velesit me përfaqësuesit e Shtabit të Zonës së Dytë operative të Maqedonisë, ofroi një marrëveshje absurde prej gjashtë pikash, me të cilën pranohej një reciprocitet mbi pozitën/statusin politik të shqiptarëve të “Maqedonisë” dhe të sllavëve në zonën e Liqenasit (Pustecit) në Shqipëri, dhe se praktikisht njëhej pa asnjëfarë kushtesh kufiri ndërshtetëror i vitit 1913, përkundër dhe një realiteti tjetër momental.

Pra, politika e “vëllazërim—bashkimit dhe e barazisë”, zgjati për aq kohë sa zgjati Lufta e Dytë Botërore në “Maqedoni”, kurse në Mbledhjen e parë të “Këshillit Antifashist të Çlirimit Popullor të Maqedonisë” që përcaktuar statusi ekskluziv shtet formues i “popullit maqedonas”, kurse populli shqiptar në “Maqedoni” u cilësua si “pakicë kombëtare”, vlerëson autori.

Për fund, do theksuar se krahas vlerave pa dyshim të mëdha, është e natyrshme që edhe këtë vepër/monografi ta përcjellin edhe lëshime dhe mangësi të aspektit material dhe atij metodologjik, por këto nuk ia ulin vlerën e asaj. Për këtë ishte i vetëdijshëm edhe vetë

autori i cili në parathënien e veprës pohon se për shkak të mungesës së të dhënave faktografike të nevojshme nuk ka mundur të zbardhë deri në fund shumë çështje, andaj ai mbetet me shpresë se në të ardhmen do të hidhet dritë e re mbi çështjet e shqyrtuara në këtë monografi, me qëllim të avancimit të gjithanshëm të mendimit shkencor mbi to.

Megjithatë, kujtojmë se kjo monografi e autorit prof. dr. Masar Kodra si e para në historiografinë tonë që drejtpërdrejtë pati për objekt studimi një episod historike mjaftë komplekse në Trevat Lindore Shqiptare, por dhe me vlerat e saj që ka, mbetet një referencë e rëndësishme për opinionin tonë shkencor e kulturor.

IBRAHIM GASHI

Universiteti i Prishtinës

KONTRIBUTI I PROF. DR. MASAR KODRËS SI PEDAGOG NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS (1975–1991)

Ka kaluar një kohë që kur njëri nga mësimdhënësit dhe kolegët tanë më të çmuar, prof. dr. Masar Kodra (Dibër, 1932 – Shkup, 2003) nuk jeton mes nesh. Ai u nda atëherë kur kishte ende për të dhënë për shkencën, për dijen dhe për studentët. Megjithatë krijimtaria e tij e përmbledhur në një opus të pasur të punimeve shkencore dhe monografive historike, është vlerësuar dhe po vlerësohet lartë nga kritika historiografike.

Padyshim se në këtë përvjetor të lindjes së Tij kontribuuesit e kësaj konference do ta trajtojnë gjerësisht krijimtarinë shkencore dhe krijuese të prof. Kodrës, ndaj dhe nuk dua të ndalem më gjatë, i bindur se trajtimi i kontributit pedagogjik të prof. Masarit si mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës, që është tema e kumesës sime, paraqet një dimension të rëndësishëm të personalitetit mbresëlënës dhe të shquar të profesorit Kodra.

Prof. Masar Kodra i takon plejadës së historianëve shqiptarë që e themeluan dhe e rritën Departamentin e Historisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Natyrisht kur flasim për Departamentin e Historisë, kemi parasysh natyrën e studimeve që lidhej me të kaluarën dhe identitetin kombëtar të shqiptarëve në raport me popujt tjerë të Evropës Juglindore dhe më gjerësisht. Etja e të rinjve për të studiuar historinë atëbotë ishte e madhe.

Përgjegjësia e pedagogëve të këtij departamenti ishte shumë e veçantë. Ata duhej të thonin të vërtetën historike për shqiptarët dhe fqinjët e tyre në periudha të ndryshme të historisë, por edhe të evitonin konfrontimin me pushtetin. Pothuaj secili nga këta pedagogë u provua profesionalisht si mjaft i përgatitur dhe kombëtarisht mjaftë i dëshmuar. Të gjithë ne qe i njohëm qoftë si studentë, qoftë si kolegë, ruajmë respektin më të madh për këtë plejadë të historianëve tanë.

Profesor Masar Kodra, personaliteti i të cilit besoj nga ky simpozium të do të ndriçohet në gjithë dimensionin e saj, ishte personi-fikim i vlerave të përmendura akademike dhe kombëtare.

I lindur në një familje bujare dhe patriotike, ai u rrit në vitet shpërsave dhe pritjeve të mëdha pas Luftës së Dytë Botërore, por edhe të zhgënjimit dhe vuajtjeve të mëdha të shqiptarëve gjithandej në Jugosllavi. U deshën disa dekada deri tek ndryshimet kushtetuese të viteve '70 të shek. XX, kur ndodhi një korrigjim shumë i pjesshëm i padrejtësive ndaj shqiptarëve. Kosova tashmë kishte fituar një autonomi kulturore dhe pjesërisht politike.

Pikërisht në këtë periudhë kuadrot e para të shkolluara nga radhët e popullsisë shqiptare të Maqedonisë filluan ta shihnin Kosovën si dritaren e vetme të shpërësës për vazhdimin e shkollimit, dhe eventualisht punësimin e tyre. Kjo periudhë përkon edhe me mbarimin studimeve të doktoratës në Universitetin e Zagrebit, ku profesor Masar Kodra për tezë të disertacionit zgjodhi temën: “Kombësia shqiptare e Maqedonisë në LNÇ” (1972).¹ Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është punësuar në Departamentin e Historisë të FF të UP-së (1972), duke u caktuar në titullin docent për lëndet, Historia

¹ Arkivi i Fakultetit Filozofik, Dosja: Prof. Masar Kodrës;

e Popullit Shqiptar – Koha e Re, si dhe për studentët më mësim në gjuhën serbokroate, lëndën: Historia e Popullit Shqiptar – Koha e Mesme.²

Profesor Masar Kodra duke ndjekur rrugën e trasuar nga akademik Ali Hadri shquhet për kampion në ngritjen dhe reformimin e studimeve në Departamentin e Historisë. Vendimtar ishte insistimi i tyre që Historia e Popullit Shqiptar të ndahej në katër lëndë të veçanta, që do të mbulonin periudhat nga antikiteti deri të koha më e re, sipas viteve të studimeve.

Profesorët Masar Kodra dhe Ali Hadri të mbështetur edhe nga koleget tjerë më të rinj janë hartues të programit të studimeve pasuniversitare (1974), respektivisht për magistraturë dhe doktoratë në Degën e Historisë. Janë mbi 153 punime të doktoratës dhe të magistraturës ku profesor Kodra ose ishte caktuar për mentor ose për kryetar e anëtar të komisionit. Vlen të theksohet se përmbajtja dhe temat e trajtuara në këto punime ishin ngjarje a personalitete nga historia nacionale e shqiptarëve.

Profesori i nderuar Masar Kodra ka dhënë një kontribut të çmuar si pjesë e komisioneve për hartimin e statutit dhe akteve tjera normative në Universitetin e Prishtinës.

Ne që e njohëm si profesor dhe që patëm fatin të jemi edhe kolegë të tij e kujtojmë me pietizëm të thellë personalitetin e tij tepër dashamirës dhe human si njeri dhe profilin e tij profesional si një pedagog dhe studiues shumë i vyer dhe serioz.

Thënia e shkencëtarit të madh Albert Ajnshtajn se: “Arti suprem i mësuesit është që të zgjojë gëzimin, shprehinë krijuese dhe dituri

² Idem;

rinë”,³ mendoj do të ishte një krahasim i qëlluar për personalitetin e Masar Kodres si profesor i historisë në Universitetin e Prishtinës. Ai që në takimin e parë me ne si studentë me zërin e tij të ngjirur po shumë të dashur, me ligjërimin e tij edukativ dhe shumë përmbajtjesor arrinte metë krijonte tek ne edhe gëzim, edhe shprehi krijese, por edhe ditori. Një studiues britanik (Sidney Hook) ka thënë “Çdokush që kujton edukimin e vet i kujton mësuesit, jo metodat dhe teknikat. Mësuesi është zemra e sistemit edukativ-arsimor”.⁴ Kur po flasim sot këtu për profesorin tonë të madh dr. Masar Kodra, po e besojmë plotësisht këtë thënie. Lënda Historia e Popullit Shqiptar – Koha e Re, personifikohet tani në kujtesën tonë me emrat e dy profesorëve të mëdhenj: akademik Ali Hadri dhe prof. Masar Kodra.

Derisa profesor Kodra ishte akoma profesor në Universitetin e Prishtinës, situata politike në Kosovë filloi të rëndohej. Presioni i pushtetit mbi institucionet e arsimit dhe kulturës shqiptare po rritej. Universiteti i Prishtinës ishte epiqendra ku shkarkohej graviteti i masave ndëshkuese të pushtetit, por në të njëjtën kohë UP ishte edhe vatër prej nga dolën të gjitha projektet kombëtare dhe politike që po përgatiteshin në prag të furtunës së madhe që pritej nga Serbia për suprimimin e autonomisë dhe ripushtimin e Kosovës. Profesor Masar Kodra ishte pjesë e këtyre rrjedhave dhe aktiviteteve politike. Ai ishte në bashkëpunim të ngushtë me prof. Fehmi Aganin, por dhe me akademikë tjerë shqiptar. Profesor Kodra së bashku me profesor Selim Dacin dhe veprimtarin e intelektualin e dalluar

³ <https://www.quotesaga.com/quote/2055> (access: 1 tetor 2017);

⁴ <http://www.doublequotes.net/education-quotes/from-sidney-hook> (access: 1 tetor 2017);

Halil Alidema e hartuan programin e partisë së UNIKOMB-it në shtëpinë e këtij të fundit.⁵

Duke i përjetuar shumë rëndë ndërhyrjet që ndodhën në Universitetin e Prishtinës që nga viti 1981 e deri në fillim të viteve '90, veçmas në Departamentin e Historisë, ku u larguan tashmë nga procesi mësimor akademik Ali Hadri, prof. Muhamet Tërnavë, prof. Skender Rizaj, profesor Kodra, i bindur se e priste fati i njëjtë, shfrytëzoi një mundësi ligjore që të bënte një kërkesë për pensionim të parakohshëm. Në dosjen e tij që ndodhet në Arkivin e Fakultetit Filozofik ndodhet edhe kërkesa e tij, por edhe vendimi për pensionimin e tij të parakohshëm, që mban datën 18 shtator 1991.⁶

Pas kësaj periudhe prof. Masar Kodra do t'u përkushtohet publikimeve shkencore, por më tepër do të vihet në shërbim të lëvizjes kombëtare për afirmimin e të drejtave gjuhësore dhe arsimore të shqiptarëve në Maqedoni. Ai është njëri nga veprimtarët më të përkushtuar, së bashku me profesor Fadil Sulejmanin dhe të tjerë për hapjen e Universitetit të Tetovës.⁷ Atëbotë, është shquar për ideator të simpoziumit "Shqiptarët e Maqedonisë" (Shkup 1991), ku morën pjesë studiues nga gjithë bota shqiptare. Nga rezultatet e simpoziumit në fjalë që botuar përmbledhja me titull: "Shqiptarët e Maqedonisë" (Shkup, 1994). Rezultate të ngjashme kishte arritur në simpoziume të mbajtura në Dibër, Strugë, Gostivar, si dhe në tribuna të shumta shkencore, që ishin në shërbim të shënimit dhe ndriçimit të ngjarjeve dhe personaliteteve historike shqiptare.

⁵ Intervistë me Prof. dr. Selim Daci realizuar në Prishtinë, dt. 14. 9.2017, ora 13:00;

⁶ Arkivi i Fakultetit Filozofik, Dosja: Prof. Masar Kodrës;

⁷ Intervistë me Prof. dr. Selim Daci, realizuar në Prishtinë, dt. 13. 9.2017, ora 10:00;

Në përmbyllje të kësaj kumtese dua të them se, profesor Masar Kodra do të mbetet njëri nga pedagogët më të nderuar të Universitetit të Prishtinës. Ai më punën, me sjelljen, me ligjërimin dhe me qëndrimin kishte krijuar profilin prej profesorit të admiruar nga të gjithë. Veprimtaria e tij shkencore dhe kombëtare ishin të pandara deri në frymën e fundit të tij. Universiteti i Prishtinës ka pasur dhe ka njerëz të aftë dhe pedagog të zotë, por profesor Masar Kodra edhe me tej mbetet një nga simbolet e krenarisë sonë institucionale dhe akademike.

QERIM LITA*Shkup*

PROFESOR MASAR KODRA NË DOKUMENTET ARKIVORE

Masat që u ndërmorën kundër shkollës shqipe gjatë viteve 1949–1950, zbuluan maskën e planeve të fshehta antishqiptare të regjimit komunist të Federatës Jugosllave. Pushteti “popullor” maqedonas në krye me Lllazar Kolishevskin e Kërste Cërvenkovskin, nën pretekstin e “zbatimit me konsekuencë” të njohjes së plotë të të drejtave kombëtare për çdo “pakicë”, zhvilloi një fushatë të gjerë për hapjen e shkollave turke në krahinat e pastra shqiptare⁸. Krejt kjo fushatë, e cila u zhvillua asaj kohe, pati për qëllim tjetërsimin e popullsisë shqiptare myslimane, përkatësisht, nga ajo popullsi në mënyrë artificiale të krijohet elementi “turk”, si parakusht për dëbimin e asaj popullsie nga trojet e veta etnike për në Republikën e Turqisë.

Një akt të tillë, intelijenca shqiptare e konsideronte si një masë e marrë nga qeveria komuniste që të “lirohet njëherë e mirë nga shqiptarët”. Ajo, në kushtet e atëhershme, kur organet e sigurimit përcillnin çdo lloj veprimtarie të saj, mori guximin që t’i kundërvihet kësaj fushate, përmes formave më të ndryshme. Gjëja themelore për ta ishte “të punohet për njohuritë nacionale të masave që t’u thuhet atyre se janë shqiptarë” prandaj “ata nuk duhet të deklaro-

⁸ Qerim Lita, Shpërngulja e shqiptarëve nga Maqedonia në Turqi (1953-1959), Studime albanologjike, nr. 1, Shkup, 2009, fq. 75-105.

hen si turq”⁹. Në mesin e atyre intelektualëve, të cilët ndërmorën një hap të tillë, ishte edhe vëllai i profesor Masar Kodrës, Xhafer Kodra, i cili asaj kohe mbante postin e ministrit të Drejtësisë në Qeverinë e Republikës Popullore të Maqedonisë¹⁰.

Shërbimi sekret maqedonas (UDB–ja), në hap e ndiqte jo vetëm aktivitetin e inteligjencës, por edhe të atyre strukturave të pakta udhëheqëse shqiptare, ndaj të cilëve shprehej një mosbesim i skajshëm si nga UDB–ja po ashtu edhe nga udhëheqja politike maqedonase. Në mbledhjen e zgjeruar të Byrosë Politike të PKM–së, të mbajtur më 29 shkurt të vitit 1952, i besuari i UDB–së për rrethin e Tetovës, Arizon Nestorovski–Marçe, në mënyrë të hapur shprehi mosbesimin ndaj anëtarëve shqiptar në organet partiake e të pushtetit, duke pohuar se: “Asnjëri nga ata nuk është element i shëndosh, nuk është besnik i partisë, i cili nuk do ta tradhtonte revolucionin tonë dhe ndërtimin e socializmit të ne”¹¹. Me një tonë edhe më të vrazhdë foli edhe përfaqësuesi tjetër i UDB–së, Elisie Popovski, i cili inteligjencën shqiptare e kualifikoi si “irredentiste”, duke u shprehur se: “Ata irredentistë shqiptarë i durojmë nga viti 1943” dhe për tërë atë veprimtari të tyre ‘armiqësore’, organet e pushtetit nuk ndërmarrin masa”¹². Në mbledhje u fol edhe për aktivitetin e “dyshimtë” të ministrit të Drejtësisë, Xhafer Kodra, i cili siç theksoi njëri ndër përfaqësuesit e UDB–së, kohë të fundit së bashku me Bajram Golën, zhvillon një aktivitet të dendur në Tetovë, dhe se i njëjti “nuk e sheh të arsyeshme të kthej në komi–

⁹ Државен архив на Република Македонија (më tej ДАРМ), 1. 427. 84. 88/493-508.

¹⁰ ДАРМ. 1. 427. 27. 56/268-269.

¹¹ ДАРМ. 1. 427. 27. 55/257-267, fjalimi i Arizon Nestorovski–Marçe.

¹² По аty, nga fjalimi i Elisie Popovski.

ter”¹³. Nuk vonoi shumë, pas kësaj mbledhje, UDB-ja maqedonase arrestoi Xhefar Kodrën, dhe nën akuzën se ka zhvilluar veprimtari “armiqësore kundër shtetit e popullit” dënohet me burg të rëndë, të cilin e vuajti në burgun e famshëm komunist jugosllav Goli Otok.

Padyshim se burgosja e Xhaferit, preku rëndë këtë familje arsimdashëse, në radhë të parë vëllain e tij më të vogël, Masar Kodrën, i cili asaj kohe ishte student në Fakultetin Filozofik në Shkup. Masar Kodra, pasi i kreu studimet u punësua si arsimtar në një shkollë fillore në Shkup, ndërsa në vitin 1960, punoi si gazetar në gazetën e atëhershme dyjavore në gjuhën shqipe “Flaka e Vëllazërimit”, ku punoi deri në vitin 1966, që më pas të inkadrohet në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup – Departamenti i Historisë së Kombësive.

Mbledhja e IV e KQ të LKJ-së, punimet e së cilës u zhvilluan më 1 korrik 1966 në Brione, konsiderohet si një kthesë shumë domethënëse për Federatën e atëhershme komuniste jugosllave, sepse në të mori një grusht të rëndë krahu centralist e unitarist i Aleksandër Rankoviqit dhe klika e tij. Tito dhe bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, menjëherë pas kësaj mbledhjeje shpallën reforma të përgjithshme si brenda Lidhjes Komuniste, po ashtu edhe te organizatat dhe bashkësitë tjera shoqërore-politike, në organet shtetërore, veçmas në shërbimin për sigurimin shtetëror, i cili deri atëherë kontrollohej nga dueti Rankoviq-Stefanoviq. Me reformat parashikohej edhe përmirësimi i menjëhershëm i pozitës të kombësive, veçmas të shqiptarëve si në Kosovë po ashtu edhe në RS të Maqedonisë dhe në RS të Malit të Zi.

¹³ Po aty, nga fjalimi i D. Anastasovski.

Menjëherë pas këtyre vendimeve, udhëheqja e atëhershme politike e Kosovës ndërmori një aktivitet të gjerë e të gjithanshëm, në zbardhjen e të gjitha dukurive negative të kryera nga ana e shërbimit sekret ndaj popullsisë shqiptare. Kryesia e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, mbështetur nga faktet dhe dëshmitë e grumbulluara nga tereni, vlerësonte se: “deformimi më i rëndë” në Kosovë “paraqitet në orientimin e Shërbimit Sekret në mosbesimin ndaj shqiptarëve, si element i dyshuar, si i rrezikshëm për shoqërinë socialiste...”. Një marrëdhënie të veçantë, shërbimi në fjalë kishte vendos ndaj intelligjencës shqiptare, ku vetëm gjatë periudhës 1960 e deri në Plenumin e IV, ndaj 900 intelektualëve shqiptarë kishte hapë dosje sekrete, duke ua veshë atyre etiketa të ndryshme, si: “nacionalistë të rrezikshëm”, “agjentë të shërbimit sekret shqiptar apo të shërbimeve tjera”, “mbrojtës të ideve nacionaliste”, etj..¹⁴.

Ndërkohë, përderisa në Kosovë e në republikat tjera jugosllave pati një aktivitet të dendur, në RS të Maqedonisë mbisundoi një heshtje totale. Udhëheqja politike e kësaj republike në krye me Kërste Cërvenkovskin, doli me një qëndrim krejtësisht të kundërt, përkatësisht, se situata politike në Maqedoni, nuk mund të krahasohet me atë të Kosovës, se në Maqedoni nuk ka pasur “asçfarë deformimesh nga ana e shërbimit sekret”, se këtu “nuk janë zhvilluar procese të montuara politike”, se ndaj popullsisë shqiptare “nuk

¹⁴ Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës (më tej ASHAK), fondi KK i LK të Kosovës: OCENA DEFORMACIJA U SUP-u I DB-i, njihovi uzroci, idejni korëni i posledice i predlog mera za njihove razreshavanje na Kosovo i Metohije, Prishtinë, shtator 1966: “....Numri më i madh i gazetarëve, letrarëve dhe publicistëve të kombësisë shqiptare është dyshuar si element jolojal, ndërsa është përcjellë veprimtaria e tyre. Gazetat dhe revistat, veçmas “Rilindja” deri në detaje janë përcjellë /”Rilindja” në tërësi është përcjellë nëpërmjet telefonit/ dhe nëpërmjet kësaj janë gjuajtur gabimet të cilat jo gjithmonë kanë pasë prapavijë armiqësore; disa punimeve letrare dhe komenteve të ndryshme ju është dhënë karakteri i përmbytjes armiqësore.. etj.”.

është zbatuar një politikë diskriminuese si në Kosovë” etj., e prandaj sipas Cërvenkoskit dhe klikës së tij “çështja shqiptare në Maqedoni duhet shikuar më ndryshe nga ajo e Kosovës”¹⁵.

Kundër këtyre vlerësimeve dhe qëndrimeve, doli intelijenca e atëhershme shqiptare, e cila në mënyrë të argumentuar i demantonte të gjitha ato parulla dhe gënjeshtër që i plasonte kreu më i lartë i KQ LK-së. Ajo vlerësonte, se të arriturat e deriatëhershme, sa i përket avancimit e të drejtave nacionale, politike, si dhe zhvillimit kulturo-arsimor të shqiptarëve në Maqedoni, ishin tejet minimale, dhe nëse diçka është arritur në këtë drejtim, kjo më shumë ishte si rrjedhojë e angazhimit nga ana e vetë shqiptarëve se sa të pushtetarëve. Gjithashtu, ajo vinte në dukje: “se në disa vise realizimi i barazisë ishte demagogji”, dhe se “ekzistonte një numër i madh i të burgosurve politik, se UDB-a deri në plenumin e IV i përndiqte vetëm shqiptarët, se gjuha shqipe ishte e nënçmuar, se punësinë e shqiptarëve nëpër institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore ishte shumë i vogël... etj”¹⁶. Për ta, zgjidhja e problemit shqiptar ishte në krijimin e një “Qendre të vetme politike e kulturore” mbarëshqiptare, ngjashëm si kombet tjera jugosllave. Ndër intelektualët e atëhershëm shqiptar të cilët mbronin këtë qëndrim duhet veçuar punëtorët e arsimit në përgjithësi, e veçmas profesorët e Normales “Zef Lush Marku” të Shkupit, e të gjimnazit të plotë në Tetovë, si dhe të punësuarit e gazetës së atëhershme shqiptare “Flaka e Vëllazërimit” si Lutfi Rusi, Memedali Hoxha, Ali Aliu,

¹⁵ ДАРМ.1.427.138.21/474-516, Претседателство и Извршен Комитет на ЦК СКМ, Актуелни прашања во остварувањето на политиката на рамноправност на народностите во СРМ и идејно-политичката активност на СКМ, Скопје, фебруари 1968 година.

¹⁶ ДАРМ.1.427.138.21/474-516, Актуелни прашања во остварувањето на политиката на народностите во СРМ и идејно-политичката активност на СКМ, Скопје, фебруари 1968 година.

Rexhep Zillatku etj., në mesin e tyre edhe profesor Masar Kodra, i cili më vonë u kyç në Institutin e Historisë Nacionale – Shkup, si punonjës shkencor.

Në cilësinë e punëtorit shkencor, Masar Kodra së bashku me intelektualët tjerë shqiptar si Ali Aliu, Lutfi Rusi, Shukri Rahimi, Me-medali Hoxha, Petro Janura, etj., shtruan kërkesën që në vitin 1968, ngjashëm si në Kosovë e Shqipëri, edhe në Maqedoni të kremtohen dy data të rëndësishme kombëtare: 500 vjetori i vdekjes së heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastrioti – Skënderbeu dhe 60 vjetori i Kongresit të Manastirit¹⁷. Lidhur me këtë, drejtuesit e Konferencës Republikane të LSPPM-së, gjatë vitit 1967 zhvilluan disa takime me drejtuesit Konferencës Krahinore të LSPPK-së, ku siç njoftohemi nga Informata e Këshillit Ekzekutiv të LSPPM-së, lënda kryesore e bisedimeve kishte qenë festat e ardhshme kombëtare shqiptare, njohja me iniciativat e deriatëhershme, dhe përgatitjet dhe konsultimet për aktivitet e mëtutjeshme të Lidhjes Socialiste në RS të Maqedonisë, Malit të Zi dhe KA të Kosovës e Metohisë. Duke u ndalë në rëndësinë e dy festave kombëtare shqiptare, në informatë shprehimisht thuhej: “Vitin e ardhshëm 1968 mbushen 500 vjet nga vdekja e Gjergj Kastriot Skënderbeut, heroit kombëtar shqiptar i cili plot 25 vjet me sukses i përballoi sulmet e ushtrisë osmane. Bëhet fjalë për figurë historike, i njohur për aftësitë e tij strategjike, të cilat mundësuan të krijoj dhe të ruaj teritorë të lira në Ballkan për shumë vite pas vdekjes së tij /pjesë nga Shqipëria veriore e sotme/. Ai njëkohësisht paraqitet edhe theme-lues i parë të shtetit shqiptar, duke udhëhequr luftime të suksesshme edhe kundër anarkisë feudale të vendit të shpërndarë.

¹⁷ ДАРМ. 1. 426. к. 40, Информација за соработката на поделни институции и организации од СР Македонија и АП Космет во решавањето на заедничките проблеми од животот на шиптарската и турската народност.

Krahas iniciativës për kremtimin e kësaj feste kombëtare shqiptare, shtrohen kërkesa për shënimin e një ngjarje tjetër të rëndësishme në historinë kulturore të kombit shqiptar, – krijimi i Alfabetit të parë shqiptar. Ky jubile meriton vëmendje të veçantë për faktin se alfabeti u shtyp në Manastir nga grup intelektualësh, patriotë nga Shqipëria, të cilët mbanin lidhje të ngushta me lëvizjen nacionale maqedonase”¹⁸.

Në vazhdim të informatës thuhej se “Iniciativat për shënimin dhe manifestimin e dy jubileve të mësipërme, gjithsesi se duhet të pranohej”, dhe se në Prishtinë vetëm se ishte formuar Këshilli për manifestim i cili kishte hartuar programin e vetë, ndërsa grupi për kombësi pranë Këshillit Kryesor të LSPPM-së gjithashtu i ka shqyrtuar iniciativat dhe propozimet e deritanishme për shënimin e këtyre dy jubileve në territorin e RS të Maqedonisë, ku ka konstatuar:

- ato të shënohen në mënyrë që do t’i kënaqte nevojat e kombësisë së shumtë shqiptare në RS të Maqedonisë, Kosovës e Metohisë dhe Malit të Zi, por njëkohësisht edhe nevojën për përfshirjen në manifestim edhe të qytetarëve tjerë nga të dy republikat dhe krahina;

- jubiletë të shënohen në shenjë të përpjekjeve për afirmimin dhe zbardhjen e atyre ideve të cilat nëpërmjet së kaluarës historike e kanë afruar kombin tonë (maqedonas –Q.L.) dhe kombësitë dhe kanë kontribuar për lidhjen e forcave progresive;

- për nevojat e shkollave dhe të institucioneve tjera kulturor-arsimore, është e domosdoshme të sigurohet një publikim i popu-

¹⁸ Po aty.

llarizuar, nëpërmjet të cilit do të mundësohej njohja me jetën e Skënderbeut dhe me kohën kur ai ka jetuar e luftuar;

– duhet që edhe nëpërmjet manifestimeve përkatëse – akademi, të shënohen dy jubiletë për të cilat këshilli për manifestim do të propozoj program më konkret;

– kremtimi lidhur me Alfabetin shqiptar mund të shënohet edhe me zbulimin e pllakës përkujtimore në Manastir, në shtëpinë ku është shtypur Abetarja.

– si figurë e rëndësishme historike në Ballkan, me meritat e Skënderbeut duhet të njoftohen edhe kombet e kombësitë tjera në RSFJ-së. Për këtë qëllim duhet të publikohen shkrime nëpër shtëpi të ndryshme botuese të republikave dhe në përgjithësi në RSFJ ...etj.¹⁹.

Gjatë bisedimeve të zhvilluara në Prishtinë e Shkup, midis dy udhëheqjeve përkatëse, është vendos të themelohet Këshilli koordinues i këtyre dy jubileve, me pjesëmarrjen e punonjësve shkencor nga Kosova, Maqedonia e Mali i Zi. Përveç kësaj, u themelua edhe Këshilli Republikan për kremtimin e këtyre dy jubileve i cili përbëhej nga punëtorë shoqëror-politik, kulturor e publik: Hysen Ramadani, Lutfi Rusi, Memedali Hoxha, Vllado Maleski, Xhevat Gega, Dr. Petro Janura, Mateja Mateski, Murat Isaku, Ali Aliu, Masar Kodra, Shukri Rahimi, etj.²⁰.

¹⁹ Po aty; ASHAK, F. Sekretariati Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme (fondi i pa rregulluar), Priština, 17.VI.1967. godine.

²⁰ ДАРМ.Ф.Републичка Конференција на ССРНМ, к. 40, ИНФОРМАЦИЈА за водени разговори во Покраинската конференција на ССРН за Косово и Метохија, по прашањето на престојните албански национални празници, 12.VII.1967 год., Скопје.

Profesor Masar Kodra haset edhe në dokumentet tjera arkivore, që me këtë rast duhet të veçohet pjesëmarrja e tij aktive në debatin publik i cili në fillim të viteve shtatëdhjeta të shekullit të kaluar në RS të Maqedonisë u zhvillua rreth zgjidhjes së problemit të përdorimit zyrtar të flamurit kombëtar shqiptar. Një debat të tillë, Komisioni për marrëdhëniet midis republikave kombeve e kombësive pranë KQ të LKM-së, e organizoi më 6 prill 1973 ku krahas anëtarëve të Komisionit morën pjesë edhe punonjësit shkencor prani Institutit të Historisë Nacionale – Shkup. Gjatë debatit, u shtruan shumë dilema, sidomos nga historianët maqedonas, si Vllado Ivanovski e të tjerë, se a thua flamuri simbolizon shtetin apo kombin, se shqiptarët në RS të Maqedonisë a duhet ta përdorin të njëjtin flamur i cili në RPS të Shqipërisë, përdoret si flamur shtetëror etj.²¹. Ndaj këtyre dilemave, reagoi profesor Masar Kodra, i cili në fillim të fjalës së tij shprehet: “Secili shtet e përdor flamurin për shkak rëndësisë nacionale, mirëpo flamuri është simbol i kombit, përkatësisht kombësisë. Me evolucionin e shoqërisë ndryshime ka pësuar edhe flamuri kështu që sot flamujt e mbarë kombeve në botë kanë pësuar ndryshime. Sa i përket pyetjes së shokut Vllado Ivanovski, duhet të shihet se sipas të drejtës ndërkombëtare a parasihien të kryhen ndryshime dhe nën cilat kushte. Përndryshe, është fakt se flamuri përbën shprehjen e kombit, e jo të shtetit...”. Më pas Kodra, ndalet në tezat e ofruara nga ana e Sekretariatit Republikan të Drejtësisë, për hartimin e Ligjit për përdorimin e flamujve, ku theksoi: “Tezat i lexova me një vëmendje, ndërsa rreth tyre u zhvillua edhe debat. Pikërisht, se si do të përcaktohen zonat e përziera, a do të përcaktohen nga lartë ose do t’i përcaktoj vetë komuna? Ligjet tona kanë qëndrime të qarta në lidhje me arsimin,

²¹ ДАРМ. 1. 427. 231. 56/652-707.

kulturën, përdorimin e gjuhëve, etj. Pra nuk është rëndë të përcaktohet e të merret qëndrim për këtë çështje. Vështirësi ka nga ana tjetër, me miratimin e një ligji të tillë që të mos vijmë në një situatë që në zonat e përziera të krijojmë një kolorit me përdorimin e flamujve të ndryshëm. Aty ligji do të jetë më rigoroz edhe në rastin kur lejohet përdorimi i flamujve të përdoren edhe flamuri i kombësisë edhe i shtetësisë...”. Në përmbyllja të fjalimit, profesor Masar Kodra shtroi pyetjen se në cilin rast mund të përdoret flamuri kombëtar, përkatësisht, siç do të shprehet: “Nëse flamuri është simbol i kombit, nëse e pranojmë atë tezë, parashtrohet pyetja tjetër në lidhje me festat kombëtare të kombësive që lidhen me shtetin amë /për shembull Shpallja e Pavarësisë/ ajo kombësi a do të ketë të drejtë edhe në atë moment ta përdor flamurin. Në teza nuk është marrë qëndrim në lidhje me këtë çështje përkundër asaj se për të është diskutuar”²². Pjesa e fundit e fjalimit të Masar Kodrës, nxiti debat e reagime të shumta jo vetëm nga pjesëmarrësit maqedonas por edhe ato shqiptar, në radhë të parë nga komunistët siç ishin Femi Muça, Meti Kërliu, e tjerë.

Ky i fundit duke iu kundërvu fjalimit të Kodrës, tha: “Lidhur me atë që e shtroi shoku Masar, është fakt se kombet përbëjnë shtetin dhe këtu përputhen festat kombëtare e shtetërore, mirëpo duhet të dallohet, të kihet parasysh veçmas se ekzistojnë dallime të mëdha midis kombësisë së këtushme dhe shtetin amë. Konkretisht kur bëhet fjalë për kombësinë shqiptare, kremtimi i Shpalljes së Shtetit Shqiptar më 28 nëntor, kur kombi përfitoi shtetësinë, por vetëm në një regjion. Përmes lejimit të përdorimit të flamurit, sigurimin dhe shfrytëzimin e simbolit si pjesëtar të një kombësie, mirëpo, në konstelacionin tjetër të jetës e të zhvillimit të një kombësie, mund

²² Po aty, nga fjalimi i Masar Kodrës.

të jetë krejtësisht divergjente sot apo nesër ajo kombësi nga kombi i cili është vendosur në një shtet të veçantë”. Me një konstatim të tillë, nuk pajtohet Masar Kodra, i cili sërish e mori fjalën ku vuri në dukje se “përdorimi i flamurit gjatë festave kombëtare nuk nënkupton se flamuri ngritët për shkak të festës së shtetit amë, se e mbështet rregullimin e shtetit të tij amë, ndjenjat nacionale – po, por jo edhe rregullimin shoqëror–politik...”²³.

Duke e përmbyllur këtë paraqitje time, dëshiroj të theksoj se profesor Masar Kodra, krahas profesor Shukri Rahimit dhe Ali Vishkut, njihet si themelues i historiografisë shqiptare në këto treva shqiptare, i cili përmes punimeve studimore të botuara në revistat shkencore të asaj kohe në gjuhën shqipe e maqedonase, por edhe përmes fejtoneve të botuara në gazetën “Flaka e Vëllazërimit”, nxori në pah shumë ngjarje me peshë historike të këtyre trevave shqiptare, sidomos pas luftërave ballkanike dhe pushtimin e tyre nga pushtuesit serb e bullgar, si dhe të periudhës së Luftës së Dytë Botërore.

²³ Po aty, nga fjalimi i Meti Kërliut.

KONTRIBUTI I MASAR KODRËS NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE (SHEK. XV – 1912)

Prof. dr. Masar Kodra, gjatë karrierës së tij shumëvjeçare, si pedagog dhe studiues i shkencave të historisë, me një përkushtim të jashtëzakonshëm, të mbështetur në metodologjinë e avancuar kërkimore–shkencore, ka arritur të japë kontribut të rëndësishëm jo vetëm për historiografinë shqiptare, por edhe më gjerësisht. Rrjedhimisht, ai që autor i një sërë punimesh studimore, në të cilat janë trajtuar edhe çështje të caktuara për periudhën nga shek. XV deri më 1912. Si të tilla, ato u botuan në vëllime të përmbledhjeve nga konferenca shkencore, si dhe në revista të njohura shkencore.²⁴

Opusi i prof. dr. Masar Kodrës, që i referohet problematikës, të cilën e kemi në shqyrtim, ka nisur sidomos nga viti 1968, vit ky kur mori pjesë në “Simpoziumin për Skënderbeun” që u organizua në Prishtinë, me kumtesën “*Rezistenca e dibranëve kundër turqve gjatë aksioneve luftarake të Skënderbeut*”, e cila u botua në përmbledhjen përkatëse.²⁵ Në të autori fillimisht jep një vështrim të shkurtër për pozitën gjeostrategjike të Dibrës dhe të zotërimeve të

²⁴ Falënderojmë prof. dr. Nebi Dervishin, i cili, në cilësinë e organizatorit të konferencës shkencore “Masar Kodra – Figurë e shquar e historiografisë shqiptare (1932-2003)”, na vuri në dispozicion pjesën më të madhe të punimeve shkencore të studiuesit Masar Kodra.

²⁵ Masar Kodra, *Rezistenca e dibranëve kundër turqve, gjatë aksioneve luftarake të Skënderbeut*, in: “Simpozium për Skënderbeun – Simpozijum o Skenderbegu”, 9-12 maj, 1968, (Prishtinë – Priština: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1969), 135-144.

Gjon Kastriotit, i cili shtiu në dorë edhe rrethin e Dibrës. Më pas trajton kthimin e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut në atdhe (1443), i cili fillimisht u ndal në Dibër, ku popullsia e priti si prijës. Aty, pasi u këshillua me bujarët e kësaj treve dhe pasi mblodhi një numër ushtarësh dibranë, iu drejtua Krujës, të cilën e mori me lehtësi. Duke ndërthurur informacione të tjera mbi çlirimin e rrethit të Dibrës, autori hedhë dritë për fitoren e ushtrisë së Skënderbeut ndaj ushtrisë osmane (1444), ku u dalluan dibranët me në krye prijësin e tyre Moisi Golemi. Këta të fundit, bashkë me prijësin e tyre, sipas autorit, treguan trimëri edhe në fitoren ndaj venedikasve (1447). Mbi bazën e ballafaqimit të fakteve, autori analizon mënyrën e rënies së Sfetigradit në duart e osmanëve (1448). Mjaft me interes janë informacionet mbi kontributin e dibranëve në fitoret e ushtrisë së Skënderbeut ndaj forcave osmane në betejat e Oranikut (1448), të Modriçit (1452) dhe të Pollogut (1453). Autori, midis tjerash, e vë theksin edhe në kalimin e Moisi Golemit në anën e osmanëve dhe kthimin e tij sërish pranë Skënderbeut. Megjithatë, siç thekson autori Kodra, kjo nuk e përmirësoi pozitën e Skënderbeut, pasi osmanët arritën të pushtonin kështjellën e Modriçit (1456), që u pasua me rënien e krahinës së Dibrës nën pushtetin osman.²⁶

Punimi studimor “*Revolucioni i Turqve të Rinj dhe Lëvizja Çlirimtare Shqiptare*” u botua në revistën shkencore “*Glasnik*” të Institutit të Historisë Kombëtare në Shkup (1968).²⁷ Në këtë studim voluminoz prej 30 faqesh, autori vë në pah se në vitet e para të shek. XX lufta e popullit shqiptar kishte hyrë në një fazë të re më të zhvilluar për çlirim kombëtar dhe social nga robëria osmane. Sipas

²⁶ *Idem*.

²⁷ Масар Кодра, *Младотурската револуција и Албанското Ослободително Движење*, in: “Гласник” на Институтот за национална историја, год. XII, бр. 1, (Скопје: 1968), 117-146.

tij, Lëvizja Kombëtare Shqiptare karakterizohej nga dy momente: në njërën anë ajo merrte një vend të rëndësishëm në politikën e përgjithshme të Perandorisë Osmane; dhe nga ana tjetër, shumë qarqe të caktuara të shteteve fqinje dhe të atyre europiane orvateshin që synimet e kësaj Lëvizjeje t'i shfrytëzonin për interesa të veta. Vend të rëndësishëm autori i ka kushtuar aktivitetit të Lëvizjes Xhonturke dhe kontributit që dhanë në kuadër të saj personalitete të shquara shqiptare. Më tej ai hedh dritë në shpërthimin e Revolucionit të Turqve të Rinj, përkrahjen që i dha atij popullsia vendase e Strugës, e Kërçovës, e Dibrës, e Elbasanit, e Pogradecit etj., si dhe ngadhënjimin e tij. Me këtë rast, në trevat shqiptare u formuan një sërë klubesh, të cilat angazhoheshin për emancipim kulturor dhe autonomi politike të Shqipërisë. Megjithatë, Turqit e Rinj, shpejt ndërmorën masa për kufizimin e aktivitetit të tyre. Përkundër këtij kundërveprimi, siç argumenton autori, në Shqipëri u hapën një numër i madh shkollash, ku mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe me alfabetë të ndryshme, që financoheshin nga klubet shqiptare. Kjo përshpejtoi nevojën e organizimit të Kongresit të Manastirit (1908), në të cilin u miratuan alfabeti arab dhe ai latin. Siç vë në pah autori, alfabeti latin gjeti zbatim më të madh, sepse pjesa më e madhe e literaturës shqiptare ishte shkruar me këtë alfabet. Nga ana tjetër, studiuesi i përmendur ka trajtuar zgjedhjet parlamentare në Turqi dhe pjesëmarrjen e shqiptarëve në to. Në këtë kuadër, ai nxjerrë në shesh se fushata parazgjedhore në Shqipëri që përcjellë me konflikte të vazhdueshme midis popullsisë shqiptare dhe Turqve të Rinj. Në rrethana manipulimi u zgjodhën 25 deputetë shqiptarë, një pjesë e të cilëve u angazhua në parlamentin turk për të drejtat kombëtare të popullit shqiptar. Prof. dr. Kodra, më pas, trajton Kundërrevolucionin e Stambollit të vitit 1909 dhe rolin e qarqeve shqiptare në ato zhvillime, përfshirë edhe shtypjen e tij.

Megjithatë, Turqit e Rinj, përkundër premtimeve se do të siguronin më shumë të drejta për shqiptarët, ata ndërmorën masa ndëshkuese ndaj udhëheqësve të “Lëvizjes Çlirimtare Shqiptare”, si dhe ndaj kryengritësve shqiptarë në Kosovë dhe në Shqipërinë Veriore. Studiuesi vë në pah se Turqit e Rinj për ta përmbyllur konfliktin e armatosur me shqiptarët inskenuan mbajtjen e Kongresit të Dibrës. Nga ana tjetër, “Lëvizja Çlirimtare Shqiptare” organizoi Kongresin e Elbasanit, në të cilin, sipas profesorit Kodra, u morën vendime kulturore–arsimore dhe politike. Me këtë rast, autori, me siguri nën tryshninë e qarqeve politike komuniste, duke iu referuar një autor i sllav, vë në dukje se Kongresi i Elbasanit, për arritjen e autonomisë së Shqipërisë, kishte rekomanduar që të bashkëpunohet me kryengritësit maqedonas. Se këtë detaj ai kishte qenë i detyruar ta përfshinte në punimin tij, autori në mënyrë indirekte e dëshmon kur thotë se rekomandimin në fjalë nuk kishte mundur ta gjente në materialet burimore. Në vazhdim, veprimet e xhonturqve kundër shkollës shqipe autori i ndërthurë me aktivitetin e deputetëve shqiptarë në parlamentin turk që angazhoheshin për reformimin e Turqisë, autonominë e nacionaliteteve etj.²⁸

Po në vitin 1968, në revistën kulturore dhe shkencore “*Përparimi*” që dilte në Prishtinë, u botua punimi studimor i Masar Kodrës me titull: “*Lidhjet dhe bashkëpunimi i lëvizjeve kombëtare të popullit shqiptar dhe maqedonas gjatë periodës së Kryengritjes së Ilindenit*”.²⁹ Mbi bazën e materialit të hulumtuar, autori ka arritur të

²⁸ *Idem.*

²⁹ Masar Kodra, *Lidhjet dhe bashkëpunimi i lëvizjeve Kombëtare të popullit shqiptar dhe maqedonas gjatë periodës së Kryengritjes së Ilindenit*, in: “Përparimi”, Revistë kulturore dhe shkencore, nr. 3-4, (Prishtinë: 1968), 387-400. I njëjti punim është botuar në gjuhën maqedonase: “*Врските и соработката на ослободителните движења на албанскиот и македонскиот народ во периодот на Илинденското востание*”, in: “Илинден 1903”, ku janë përfshi materialet e

nxjerrë në sipërfaqe kontaktet e realizuara në gjysmën e dytë të shek. XIX, midis disa personash të caktuar maqedonas dhe shqiptarë, për organizimin e një kryengritjeje antiosmane, përpjekje të cilat nuk dhanë ndonjë rezultat. Më tej studiuesi trajton edhe qëndrimin e shteteve ballkanike dhe të atyre evropiane ndaj lëvizjeve kombëtare të popullit shqiptar dhe maqedonas. Me këtë rast ai vë në pah politikën ekspansioniste të shteteve fqinje ndaj Maqedonisë dhe Shqipërisë dhe interesimin e Fuqive të Mëdha për të tërhequr përfitime nga rrethanat e krijuara. Nga ana tjetër, autori ka arritur të përshkruaj disa raste të izoluara të kontakteve dhe të bashkëpunimit midis “patriotëve shqiptarë dhe maqedonas” në prag të Kryengritjes së Ilindenit, si dhe furnizimin e kryengritësve maqedonas me armë nga Shqipëria. Lidhur me Kryengritjen e Ilindenit (1903), ai konsideron se shqiptarët kanë marrë pjesë në të, por jo në mënyrë masive. Sipas tij, Lëvizja Kombëtare Shqiptare nuk ka treguar një përkushtim të plotë në favor të “Lëvizjes Çlirimtare Maqedonase”, respektivisht nuk mund të flitet për një pjesëmarrje të përgjithshme. Me këtë qasje, me sa duket, profesor Masar Kodra në mënyrë të tërthortë, aq sa ka mundur të shprehej në atë kohë, dëshironte të tregonte se Lëvizja Kombëtare Shqiptare kishte programin e saj për arritjen e pavarësisë, ndërsa persona të caktuar shqiptarë që kishin bashkëpunuar me “Lëvizjen Çlirimtare Maqedonase” nuk kishin përfaqësuar lëvizjen e përmendur të popullit të tyre. Tërheqin vëmendjen këtu edhe pikëpamjet e studiuesit lidhur me bashkëpunimin e çetave shqiptare me ato maqedonase pas kryengritjes së Ilindenit.³⁰

simpoziumit shkencor, kushtuar 65 vjetorit të Kryengritjes së Ilindenit, mbajtur në Ohër më 27-28 maj 1968, ndërsa përmbledhja me punime është botuar më 1970, 255-267. Ne i referohemi punimit të botuar në shqip.

³⁰ *Idem.*

Në vitin 1969, në revistën shkencore “*Glasnik*” të Institutit të Historisë Kombëtare në Shkup, u botua punimi i radhës i studiuesit Masar Kodra, me titull “*Kongreset në Dibër, Elbasan dhe Manastir të Lëvizjes Çlirimtare Shqiptare*”.³¹ Autori në këtë punim studimor fillimisht përshkruan masat e Turqve të Rinj ndaj “Lëvizjes Çlirimtare Shqiptare”, e cila vazhdoi të këmbëngulte në kërkesat e saj për emancipim kulturor dhe autonomi politike. Konfliktin e armatosur me shqiptarët, siç thotë studiuesi në fjalë, xhonturqit u përpoqën ta likuidonin me organizimin e Kongresit të Dibrës (1909). Në të morën pjesë, përveç delegatëve shqiptarë, edhe përfaqësues të xhonturqve dhe delegatë serbë, bullgarë dhe grekë. Autori vë në dukje se para fillimit të punimeve të tij, xhonturqit u shpërndanë delegatëve programin përkatës, i cili nuk e njohte ekzistencën e popullit shqiptar. Megjithatë, gjatë punimeve të Kongresit, delegatët shqiptarë arritën të minojnë programin xhonturk dhe u vendos që populli shqiptar të deklarohej për atë se cilin alfabet do ta përdorte, etj. Rrjedhimisht, vendimet e marra në këtë Kongres, konstaton autori, shkonin në favor të “Lëvizjes Çlirimtare Shqiptare”. Vend të rëndësishëm autori i kushton edhe Kongresit të Elbasanit, në të cilin u diskutuan çështjet kulturore dhe arsimore. Në këtë kuadër u miratua rezoluta prej 15 pikash, midis të cilave ishte edhe ajo për hapjen e Normales së Elbasanit. Në Kongres u diskutuan edhe çështje me karakter shoqëror dhe politik. Pas kongreseve të sipërpërmendura, thekson autori, “Lëvizja Çlirimtare Shqiptare” mori hov edhe më të madh. Për rrjedhojë, sipas një burimi që i referohet ai, u hapën mbi 150 shkolla shqipe, ndërsa autoritetet xhonturke urdhëruan që të mos përdorej alfabeti latin dhe hapën

³¹ Масар Кодра, *Конгресите во Дебар, Елбасан и Битола на Албанското ослободително Движење*, in: “Гласник” на Институтот за национална историја, год. XIII, бр. 1-2, (Скопје: 1969), 105-117.

një sërë shkollash në gjuhën turke. “Lëvizja Çlirimtare Shqiptare” u kundërpërgjigj me organizimin e Kongresit të Dytë të Manastirit (1910), në të cilin u morën vendime të rëndësishme kulturore–arsimore, si përdorimi i alfabetit latin, çelja e shkollave shqipe etj.³²

Një studim tjetër i rëndësishëm nga opusi i pasur i profesor Kodrës është: “*Bashkëpunimi shqiptaro–maqedon në gjysmën e dytë të shek. XIX – kontribut i afërmimit kombëtar*”, Studimi në fjalë është botuar në revistën shkencore “*Jugoslovenski istorijski časopis*”, në vitin 1970.³³ Në këtë punim studimor, studiuesi së pari e vë theksin në përpjekjet e Greqisë dhe të Serbisë për t’u zgjeruar në dëm të zotërimeve osmane të Ballkanit Perëndimor, respektivisht të trevave maqedone dhe shqiptare. Për arritjen e këtij qëllimi, diplomacia serbe angazhohej të tërhiqte në luftë kundër Perandorisë Osmane qoftë shqiptarët ashtu dhe maqedonasit. Në këtë kontekst, vë në dukje studiuesi, se diplomacia serbe përmes kanalesh diplomatike kishte nxitur përfaqësuesin e shquar të “Lëvizjes Çlirimtare Maqedone”, Stojan Vezenkov, të vinte kontakte me përfaqësuesit e “Lëvizjes Çlirimtare Shqiptare” dhe të asaj “maqedone”, që në vitin 1867 të organizonin kryengritje kundër Perandorisë Osmane. Së këtejmi, veprimtari në fjalë maqedonas kishte kontaktuar krerë të caktuar shqiptarë, si në Dibër, Mat, Shkodër e në Lezhë, por pa ndonjë rezultat. Autori më tej sjellë momente të tjera, ku diplomacia serbe vuri kontakte me krerë të caktuar shqiptarë për të provokuar shpërthimin e një kryengritjeje shqiptare antiosmane, por edhe këto tentativa qenë shterpe. Të njëjtin fat pati edhe përpjekja e përfaqësuesit të “Lëvizjes Çlirimtare Maqedone” Isa Mazhovski, i

³² *Idem*.

³³ Masar Kodra, *Albansko-makedonska saradnja u drugoj polovini XIX veka – doprinos nacionalnoj afirmaciji*, in: “*Jugoslovenski istorijski časopis*”, br. 3-4, (Beograd: 1970), 43-50.

cili kishte vënë kontakte në Tiranë me disa shqiptarë me prestigji (1874), për organizimin e kryengritjes shqiptaro-maqedonase. Këto informacione autori i plotëson edhe me të dhëna të tjera, si bie fjala: përpjekjet e diplomacisë ruse për të tërhequr në luftë kundër Perandorisë Osmane “lëvizjet çlirimtare të Shqipërisë dhe të Maqedonisë”, apo përpjekjet e këtyre lëvizjeve për të bashkëpunuar midis tyre. Në mbështetje të këtyre përpjekjeve, autori sjellë si ilustrim proklamatin e “Lidhjes Revolucionare Maqedonase-Shqiptare” (e formuar në Bullgari), përmes së cilës u bëhej thirrje popullit maqedonas dhe atij shqiptar të ngriheshin në kryengritje. Njëherësh, kërkohej krijimi i Shqipërisë Autonome dhe i Maqedonisë Autonome, si dhe të dënohej politika ekspansioniste e Bullgarisë, Greqisë dhe Serbisë ndaj Maqedonisë dhe Shqipërisë. Pavarësisht kësaj, kjo lëvizje nuk arriti të bënte më shumë.³⁴

Punimi studimor “*Gjurmëve të një dokumenti të panjohur*” të autorëve Ismet Dërmaku dhe Masar Kodra u botua në revistën shkencore “*Jehona*” të Shkupit, në vitin 1972.³⁵ Autorët theksojnë se ky dokument, i shkruar me dorë nga një autor anonim me alfabetin e Stambollit, respektivisht me alfabetin shqip të kombinuar me disa germa të greqishtes, nuk e kishte të evidentuar as vendin dhe as vitin e hartimit. Për nga pikëpanja gjuhësore, dokumenti ishte shkruar me dialektin toskë të Korçës. Autorët më tej shprehin bindjen se dokumenti ishte hartuar nga Komiteti Shqiptar i Manastirit, në vitin 1906 ose 1907, atëherë kur qenë formuar çetat e para të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Në vazhdim, autorët japin në përshkrim tekstin e originalit, natyrisht me alfabetin e gjuhës

³⁴ *Idem.*

³⁵ Ismet Dërmaku – Masar Kodra, *Gjurmëve të një dokumenti të panjohur*, in: “*Jehona*”, Revistë për çështje shkencore, artistike, letrare e kulture, viti XI, (Shkup: 1972), 107-113.

shqipe. Përndryshe, dokumenti është hartuar në emër të Komitetit të Shqipërisë. Ai përmban 18 pika, të cilat në fakt përfaqësojnë një rregullore mbi mënyrën e organizimit dhe të veprimit të çetave të armatosura. Si i tillë ky dokument i botuar është i rëndësishëm për çdo studiues të historisë.³⁶

Në vitin 1974, në revistën shkencore “Kosova”, në Prishtinë, u botua punimi studimor “*Lidhja e Prizrenit shikuar nga aspekti i disa dokumenteve britanike më 1879–1881*”.³⁷ Në këtë punim vullminoze prej 25 faqesh, autori fillimisht e vë theksin në krijimin e Lidhjes së Prizrenit, që, sipas tij, paraqiste një pikë kulmore në kuadër të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe kthesë të rëndësishme në ngjarjet politike dhe kulturore–arsimore. Lidhja e Prizrenit për nga forma dhe përmbajtja, si dhe për nga kërkesat që parashtroi ishte e lidhur ngushtë me zgjimin e përgjithshëm kombëtar, duke parashtruar kërkesën për formimin e një shteti kombëtar. Rrjedhimisht, autori trajton raportet e shumta të konsullit anglez Blant, në Selanik, i cili, duke filluar nga janari i vitit 1879 e deri në fund vitit 1881, informonte Ministrinë e Punëve të Jashtme të Anglisë lidhur me çështjen shqiptare, në kuadër të së cilës zhvillonte veprimtarinë e saj Lidhja e Prizrenit. Nga raportet e hulumtuara, autori ka arritur të nxjerrë në sipërfaqe informacione të rëndësishme për aktivitetin e Lidhjes, si: armatosjen e rreth 120.000 shqiptarëve të moshës 15–55 vjeç; konfliktin e armatosur të kryengritësve shqiptarë me ushtrinë malazeze; qëndrimin negativ të elementit grek në Shqipërinë Jugore ndaj aktivitetit të Lidhjes; kërkesat për autonomi të aprovuara në Dibër; vendosjen e pushtetit të Lidhjes; aktivitetin e Abdyl

³⁶ *Idem.*

³⁷ Masar Kodra, *Lidhja e Prizrenit shikuar nga aspekti i disa dokumenteve britanike më 1879–1881*, në: “Kosova – Kosovo”, 3, (Prishtinë: Instituti i Historisë së Kosovës, 1974), 45–70.

Frashërit; luftimet midis kryengritësve shqiptarë dhe ushtrisë osmane; shpërndarjen e Lidhjes së Prizrenit; arrestimin e prijësve shqiptarë; rivendosjen e pushtetit osman etj. Është karakteristike se autori mban qëndrim kritik ndaj disa njoftimeve të Blantit, duke theksuar se ai nuk e kuptonte sa duhet politikën që e ushtronte Lidhja e Prizrenit. Në fund studiuesi konkludon se po të kishte disponuar edhe raportet e ambasadorit Goshen në Stamboll, si dhe dokumente të kabinetit britanik që ruheshin në Londër, Lidhja e Prizrenit do të mund të trajtohej në mënyrë më komplekse.³⁸

Masar Kodra, në vitin 1978, mori pjesë në Konferencën shkencore të 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që u organizua në Prishtinë. Kumtesa e tij me titull “*Veprimtaria e Lidhjes së Prizrenit në territorin e sotëm të Maqedonisë*” u botua në përmbledhjen përkatëse për seksionin e historisë.³⁹ Në këtë punim, autori, duke përdorur një material të pasur burimor nga provenienca të ndryshme, nxjerrë në pah aktivitetin e Lidhjes së Prizrenit në Dibër, në Tetovë, në Shkup etj. Posaçërisht janë të rëndësishme të dhënat nga vendimet e aprovuara nga dega e Lidhjes në Dibër (1878), përmes të cilave kërkohej krijimi i Shqipërisë autonome. Në Dibër, po në vitin 1878, u organizua një kuvend, ku mori pjesë paria e dibrane dhe ajo e Toskërisë. Në të, siç argumenton autori, u diskutua rreth formave të bashkëpunimit dhe kërkesave që duhej aprovuar në lidhje me çështjen shqiptare. Njëherësh autori sjell informacione edhe për qëndrimin e autoriteteve osmane ndaj kërkesave të shqiptarëve për autonomi. Këto njoftime plotësohen edhe me të

³⁸ *Idem.*

³⁹ Masar Kodra, *Veprimtaria e Lidhjes së Prizrenit në territorin e sotëm të Maqedonisë*, in: “Konferenca shkencore e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, Prishtinë, 6-9 qershor 1978, (Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, 1981), 157-170.

dhëna të tjera të proveniencës osmane dhe të konsullit të Anglisë në Selanik. Duke u mbështetur në to, studiuesi ka arritur të ndriçojnë aktivitetin e Lidhjes së Prizrenit në viset e sotme të Maqedonisë, si dhe masat ndëshkuese që ndërmorën autoritetet osmane për shtypjen e saj në këto anë. Autori e përmbyllë punimin me konstatimin se pas kalimit të Shkupit në duart e forcave osmane në fillim të vitit 1881, ky qytet u shndërrua në poligon të vërtetë ushtarak prej nga forcat në fjalë do t'i drejtoheshin Kosovës, ndërsa aktiviteti i Lidhjes së Prizrenit në territorin e sotëm ta Maqedonisë pushoi së vepruari, me përjashtim të degës në Dibër.⁴⁰

Masar Kodra, në vitin 1993, qe njëri ndër organizatorët e mbajtjes së simpoziumit shkencor “Dibra dhe etnokultura e saj”, në të cilin morën pjesë studiues të fushave albanologjike nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Ajo që tërheqë vëmendjen më tepër lidhur me problematikën që kemi në shqyrtim është se Prof. dr. Masar Kodra, në Fjalën e Hapjes së simpoziumit, bëri kërkesë publike që rajoni i Dibrës mos të neglizhohet nga politika e ditës siç është vepruar deri në atë kohë. Gjithashtu, ka theksuar për nevojën imediate lidhur me shkruarjen e monografisë për Dibrën që prej parahistorisë deri në ditët e sotme. Sipas profesor Kodrës, kjo duhej të realizohej sa më parë kur dihet se, autorët e deridjeshëm sipas pikëpamjeve të tyre nihiliste kishin shtrembëruar realitetin shqiptar jo vetëm në Dibër, por edhe në territore të tjera shqiptare të Maqedonisë.

Në këtë simpozium, Masar Kodra u paraqit me kumtesën “*Dibra me rrethinë në kohën e Lidhjes së Prizrenit*”, e cila në version të

⁴⁰ *Idem.*

plotë u botua në përmbledhjen përkatëse të këtij simpoziumi.⁴¹ Në të studiuesi Kodra i jep rëndësi aktivitetit të gjerë të zhvilluar në rajonin e Dibrës gjatë kohës së Lidhjes së Prizrenit, rajon ky që së shpejti do të themelonte një degë të rëndësishme të Lidhjes së Prizrenit (14 tetor–1 nëntor 1878). Në këtë kontekst gjatë viteve 1879, 1880, dega e Lidhjes së Prizrenit në Dibër ishte angazhuar në shumë aktivitete kombëtare, si në organizimin e mbrojtjes së Shkodrës, Ulqinit Tivarit, e ndonjë tjetër. Brenda këtij kuadri tërheqë vëmendjen mbajtja e Kuvendit të Lidhjes së Prizrenit në Dibër më 20 tetor 1880. Për këtë ngjarje janë ruajtur njoftime të shumta, siç janë raportet e konsullit britanik nga Selaniku, si dhe konsullit austro–hungarez nga Shkodra. Më pastaj, profesor Kodra njofton se gjatë vitit 1881 Qeveria e Lidhjes Shqiptare u kishte dhënë mundësi themeluesve të Lidhjes sidomos Iljaz Pashë Dibrës dhe Abdyl Frashërit, që të jenë të lirë dhe të sigurt në vazhdimin e aktiviteteve të tyre atdhetare. Mirëpo, në prill të vitit 1881, Dervish Pasha, udhëheqës i 24 batalioneve kishte arritur për ta shpërnda Lidhjen. Përkundër përpjekjeve të Dervish Pashës, Dibra dhe rajoni saj gjatë kohës së Lidhjes së Prizrenit kishte dhënë një kontribut të çmueshëm.⁴²

Masar Kodra ka qenë edhe autor i punimit studimor me titull: “*Çështja e alfabetit të shqipes në gazetat ‘Vest’, ‘Vardar’ dhe ‘Rodina’*”.⁴³ Në këtë studim, autori, në mënyrë komparative dhe sipas metodologjisë së kritikës së burimeve, i qaset njoftimeve që dalin

⁴¹ Masar Kodra, *Dibra me rrethinë në kohën e Lidhjes së Prizrenit*, in: “Dibra dhe etnokultura e saj”, Simpozium shkencor, Dibra e Madhe e Maqedonisë (19–21 nëntor 1993), vëll. I, (Tetovë: 1995), 187–198.

⁴² *Idem*.

⁴³ Masar Kodra, *Çështja e alfabetit të shqipes në gazetat “‘Vest’, ‘Vardar’ dhe ‘Rodina’”*, in: “Gjurmime albanologjike”, seria e shkencave historike, nr. 17, (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1987), 231–248.

nga një pjesë e shtypit të kohës të botuar në gjuhë sllave, që trajton problematikën e alfabetit të gjuhës shqipe, para, gjatë dhe pas Kongresit të Manastirit. Në këtë kontekst, studiuesi Kodra ka vjelë një sërë njoftimesh të rëndësishme nga gazeta bullgare “Vesti”, e cila është botuar në Stamboll gjatë viteve 1909–1910. Çështja e alfabetit të gjuhës shqipe ka qenë edhe në objektivin e gazetës serbe “Vardar”, e cila është botuar në Shkup gjatë viteve 1910–1911. Gjithashtu me problematikën e alfabetit të gjuhës shqipe është marrë edhe gazeta “Rodina”, e cila është botuar në Selanik gjatë vitit 1910. Gazeta në fjalë, sikurse edhe dy të parat edhe pse ofrojnë njoftime të rëndësishme, autori Kodra sugjeron që të lexohen në mënyrë kritike, ndërsa historianëve u sugjeron që t’i komplementojnë njoftimet e tyre me burime relevante të kohës.⁴⁴

Një studim me i interes shkencor paraqet edhe punimi me titull: *“Bashkëpunimi i popullit shqiptar dhe popullit maqedon në vitet e para të shekullit XX”*.⁴⁵ Njëherësh, profesor Kodra ka lënë në dorëshkrim edhe një sërë punimesh studimore, si: *“Manastiri i Shën Gjon Bigurit”*, *“Mendimi politik shqiptar në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në vitet e para të shek. XX, si dhe kontributi i tij në aspektin kombëtar dhe atë fetar”*, *“Aspekte shtetërore–diplomatike të shtetit mesjetar të Skënderbeut”*, *“Historia e diplomacisë shqiptare”*.

⁴⁴ *Idem.*

⁴⁵ Масар Кодра, *Соработката на македонскиот и албанскиот народ во првите години на XX век*, in: “Зборник за Москва”, (Скопје: 1970), 103-113, cituar sipas: Çlirim Dervishi, *Shënime bibliografike të librave, monografive dhe punimeve të prof. dr. Masar Kodrës*, material në dorëshkrim, prezantuar në konferencën shkencore “Masar Kodra – Figurë e shquar e historiografisë shqiptare (1932-2003)”, mbajtur në Shkup më 15.9.2017.

ZEJNULLA QYRA

Profesor i historisë, Strugë

KONTRIBUTI I PROFESOR MASAR KODRËS NË ORGANIZIMIN E KONFERENCAVE SHKENCORE NË VITET 1991–2001 NË TROJET LINDORE SHQIPTARE

Me hapjen e kufijve me shtetin shqiptar, forcohet bashkëpunimi shkencor me studiues, intelektualë, akademikë të fushave të ndryshme midis intelektualëve dhe studiuesve shqiptarë nga Maqedonia dhe atyre nga Shqipëria dhe Kosova, bashkëpunim i cili ekzistonte që më herët, por jo në nivelin e duhur. Bartës dhe organizator i këtyre kontakteve ishte i ndjeri profesor Masar Kodra, i cili edhe para kësaj periudhe i kishte kontaktet dhe bashkëpunonte me studiues dhe institucionet shkencore nga Kosova dhe Shqipëria. Këto kontakte na ndihmuan që të organizohemi edhe ne në takime shkencore, gjë e cila do të na ndihmojë të kyçemi në fushën e krijimtarisë.

Ne struganët madje jo vetëm ne, i jemi mirënjohës profesorit, i cili u bë nismëtar dhe organizator i të gjitha kontakteve dhe simpoziumeve shkencore, që do të organizohen në këto hapësira. Nën udhëheqjen e Tij u organizuan me dhjetëra konferenca, tribuna, akademi shkencore në Strugë, dhe më gjerë, për çka do të bëhet fjalë në vazhdim. Në këto aktivitete morën pjesë studiues të fushave të ndryshme nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Bullgaria, Mali i Zi, Turqia e më gjerë. Ato patën karakter kombëtar dhe ndër-kombëtar dhe u mundësuan studiuesve të rinj shqiptarë nga Maqedonia të dalin nga anonimiteti në fushën e krijimtarisë me publi-

kime të ndryshme. Kjo do të jetë një nismë e paraqitjes së një brezi studiuesish dhe krijuesish në fushën e historisë.

Në vazhdim po ju paraqes diçka nga këto takime shkencore.

Nën organizimin dhe udhëhiqen e profesor Masarit, në nëntor 1991 në fshatin Kondovë të Shkupit, mbahet Konferenca shkencore “Shqiptarët e Maqedonisë”, ku morën pjesë studiues nga Turqia, Mali i Zi, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. U trajtuan tema nga historia e shqiptarëve në trevat lindore nga antikiteti deri në ditët e sotme. Referati dhe kumtesat u botuan në përmbledhjen “Shqiptarët e Maqedonisë”, botuar në Shkup –1994.

– Në nëntor 1994, në Dibër mbahet Simpoziumi shkencor me titull “Etnokultura e Dibrës”, ku u trajtuan tema nga historia dhe etnokultura për Dibrën me rrethinë. Materialet e paraqitura në të botohen në një përmbledhje në dy vëllime “Etnokultura e Dibrës”, botuar në Dibër më 1995.

–Në tetor 1993, në Strugë mbahet Simpoziumi shkencor me rastin e 80-vjetorit të Kryengritjes së Shtatorit (1913–1993). Aty morën pjesë studiues nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Disa punime të saj u botuan në revistën ”Jehona” nr.6 në Shkup më 1994.

–Me rastin e 60-vjetorit të formimit të Brigadës IV–(VII) Sulmuese Shqiptare, në shtator të 1994 në Strugë mbahet konferencë shkencore, e cila u përcoll edhe me një akademi shkencore.

–Në tetor të 1994 për herë të parë organizohet dhe mbahet konferencë shkencore me rastin e 50-vjetorit të masakrës së fshatin Ladorishtë të Strugës. Konferenca u mbajt në Ladorishtë, ku morën pjesë me punimet e tyre studiues nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia, në të cilën u trajtuan shumë tema nga kjo periudhë e luftës, shkaqet e masakrës në të cilën u vranë 84 gra burra e fëmijë të pa-

fajshëm. Për herë të parë publikohet lista e saktë e viktimave, me të cilët ishte manipuluar për plot 50 vite. Kjo konferencë bëri nxitje edhe te banorët e fshatit për rregullimin dhe mirëmbajtjen e këtij kompleksi, i cili ishte lënë në harresë. Si rezultat i gjurmimeve disavjeçare u zbuluan emrat dhe mbiemrat e viktimave, material i cili edhe u publikua. U prezantua lista në dorëshkrimin, origjinali, i cili gjendet në arkivat tona, të cilën e publikoi si studim të vetin pjesëmarrësi në konferencë, profesori nga Tirana, Qazim Xhelili, në librin “Rruga e Brigadës...” të Hasan Cipurit...

—Në shtator të 1996 në Strugë për herë të parë në trojet lindore shqiptare organizohet konferenca shkencore me rastin e 55 vjetorit të shkollave të para shqipe. Morën pjesë studiues nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia, ku u paraqitën kumtesa nga më të ndryshmet për këtë periudhë (1941–1944). Një pjesë e kumtesave u publikuan në shtypin e përditshëm, të cilat ngjallin interes të madh jo vetëm te lexuesi i thjeshtë, por edhe te intelektualët sidomos ata të arsimit. Kjo konferencë ishte edhe një nxitje në gjurmimin e arkivave në Tiranë e më gjerë, për mësuesit e parë të cilët hapen shkollat shqipe në trojet lindore shqiptare. Këto gjurmime u kurorëzohen me botimin e një sërë monografish për arsimin shqip në këto treva.

—Në gusht të 1995 në Strugë u mbajt tribunë shkencore me rastin e dy përvjetorëve të rilindësit strugan dr.Ibrahim Temo. Në këtë tribunë bëhet edhe promovimi i librit të akademik Kristaq Priftit për jetën dhe veprimtarinë e këtij rilindësi, i cili gjithë jetën ia kushtoi çështjes kombëtare. Në këtë tribunë me profesorin patëm një kumtesë të përbashkët: “Korrespondenca e trashëgimtarëve të Ibrahim Temos me familjarët në Strugë, Elbasan dhe Tiranë”.

Origjinalet e kësaj korrespondence ua dorëzova pinjollëve të tij familjes Përnaska në Tiranë.

—Në shtator 1998 po në Strugë u mbajt konferenca shkencore me rastin e 85 vjetorit të Kryengritjes së Shtatorit (1913–1998). Kësaj konference i printe profesori bashkë me akademikun nga Tirana, Kristaq Prifti. Një pjesë e kumtesave u botuan në gazetat shqiptare të kohës. Profesori Kodra ishte i vendosur që këto kumtesa të botohen në një përmbledhje shkencore, por për shkaqe objektive nuk u botuan. Kjo dëshirë e tij u realizua vite më vonë me rastin e 100 vjetorit me titullin “Kryengritja e Shtatorit dhe Lufta e Petrinjës” në Strugë më 2015.

—Më 21–22 nëntor 1998 në Gostivar u mbajt konferenca shkencore me rastin e 90 vjetorit të Kongresit të Manastirit. Ishte ky një manifestim, të cilin do ta përshkruaj pak më shumë dhe më ndryshe. Miku i nderuar, bashkëpunëtori dhe bashkëmendimtari në shumë manifestime, po edhe publikime, profesor Masari, vjen në Strugë, si zakonisht, ulemi pranë brigjeve të Drinit të Zi dhe na thotë: ”Ti dhe prof.Nebiu do të më ndihmoni në organizimin e këtij manifestimi. Vite me radhë po na pengojnë të bëjmë një organizim siç i ka hije këtij përvjetori. Nisemi për në Manastir. Atje është vlera e manifestimit. U takuam me intelektualë të Manastirit, historianë dhe gazetarë. Biseduam por nuk pranuan që të bëhet organizimi. Në Manastir mungonte guximi, por kishin edhe të drejtë, sepse ishin të kërcënuar. Kthehemi në Strugë. Profesori na thotë se do të gjejmë mbështetës. Dhe ashtu ndodhi. Pas disa ditësh na lajmëron se manifestimi do të mbahet në Gostivar. U bë një manifestim i suksesshëm me të ftuar nga të gjithë trojet shqiptare, figurat më emblematike në fushat e krijimtarisë, historianë e gjuhësisë. Veç akademisë dhe konferencës shkencore u organizuam

dhe me disa vetura vizituam shtëpinë e Alfabetit në Manastir, ku në një lokal u mbajt një tribunë e improvizuar në krye me studiue—sin Jup Kastrati.

—Në 1997 në Livadhi të Strugës shënohet 535 vjetori i betejës së Skënderbeut. Në mes të fshatit vendoset edhe obelisku.

—Në tetor 1999 po në Strugë shënohet 55 vjetori i Masakrës së Ladorishtit.

—Në gusht 2000, po në Strugë shënohet 55 vjetori i vdekjes së rilindësit shqiptar dr.Ibrahim Temo, me një tribunë shkencore.

—Në shtator 2001 po në Strugë mbahet konferenca shkencore me rastin e 60 vjetorit të shkollave të para shqipe në Prefekturën e Dibrës. Morën pjesë një numër i madh studiuesish nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Kumtesat janë në dorëshkrim dhe presin të botohen.

Nuk pretendoj se gjithçka kam përfshirë për aktivitetin e mikut dhe bashkëmendimtarit tim, profesorit të nderuar Masar Kodra, mbase diçka e tillë është e pamundur, por një gjë jam i sigurt, se kontributi i tij në ngritjen e kuadrove shqiptare është i pakontestueshëm. Ai shumë herë ishte edhe i pakënaqur me nivelin e kuadrove të cilat i formonte dhe i titullonte. Gjithmonë e thoshte: “Na duhen kuadro, siç dua unë. Në të kundërtën ata do të turpërohen para studentëve të tyre”.

Ishim shumë të afërt, na përputheshin karakteret. Strugën e donte shumë, sidomos vitet e fundit të jetës.

Familjarë krenohuni me figurën dhe veprën e profesor Masar Kodrës, ai jeton me ne! Ndihemi të privilegjuar për aq sa bashkë—punuam dhe jetuam me Të!

NURIDIN AHMETI

Instituti Albanologjik–Prishtinë

NDIHMESA E PROFESOR MASAR KODRËS NË PËRPILIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË HISTORISË NË KOSOVË

Merita të veçanta në themelimin dhe ngritjen e institucioneve shkencore dhe edukative arsimore në Kosovë nga pas Lufta e Dytë Botërore e këndej, kanë edhe shqiptarët me origjinë nga Maqedonia e sotme. Kjo gjë tanimë, lehtë është e dokumentueshme. Enrat e tyre mund t'i hasësh në historikun e çdo institucioni në Kosovë, që nga Instituti Albanologjik, Universiteti i Prishtinës, Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, etj.

Si pjesë të institucioneve, sigurisht që enrat të cilët punonin në këto ambiente, u përballën edhe më përgjegjësi të ndryshme, nga ato menaxheriale e deri tek intrigat e ndryshme politike kundër tyre, që vinin si rezultat i gjendjes që mbizotëronte në Kosovë.

Ndër punët të cilat iu besuan kolegëve nga këto hapësira, ishte edhe përpilimi i teksteve shkollore, punë kjo me mjaftë përgjegjësi, sepse flas posaçërisht për shkencat shoqërore, është dashur të përballësh me dy fronte. Një njërën anë, ishte ruajtja e etikës profesionale, që nënkuptonte thënia e së vërtetës ashtu siç ti e mendoje, pavarësisht rrethanave politike, dhe në anën tjetër, ishte përballja me pushtetin dhe sistemet politike të kohës.

Pavarësisht këtyre fakteve por edhe fakteve të tjera të cilat ne nuk po i përmendim, në Kosovën e pasluftës së dytë botërore, u nxorën

libra edhe në gjuhën shqipe në disa lëmi, me të cilat u shërbyen studentët, arsimtarët, nxënësit e të interesuarit e tjerë.

Në këtë hovë botimesh, zënë vend edhe librat shkollorë të të gjitha fushave dhe niveleve nga klasa e parë fillore e deri te shkolla e mesme.

Në mesin e librave shkollorë të botuar në gjuhën shqipe pas viteve të 60-ta nga autorë shqiptarë, bëjnë pjesë edhe librat shkollorë të historisë dhe në mesin e autorëve që i hartuan këto tekste në Kosovë, si autor e bashkautor, krahas Ali Hadrit, Fehmi Pushkollit, Skënder Rizës, Izber Hotit etj., spikat edhe emri i Profesorit Masar Kodra.

–Profesor Masar Kodra, si bashkautor në tekstet e historisë

Teksti i parë shkollorë në gjuhën shqipe pas Luftës së Dytë Botërore dhe me autorë shqiptarë në Kosovë u botua më 1960, me autor Ali Hadri e Milan Perkaj.⁴⁶ Pas këtij botimi tekstet shkollorë të historisë në Kosovë kanë autorë e bashkautorë të ndryshëm.

Në mesin e autorëve të cilët përpiluan tekste të historisë në vitet e 70-ta si bashkautor e hasim edhe emrin e Profesor Masar Kodrës.⁴⁷

Në vitin 1977, botohet “*Historia për klasën e V të shkollës fillore*” me autor Fehmi Pushkolli e Masar Kodra.⁴⁸ Ky tekst shkollor ka pasur mbi dhjetë ribotime dhe ka qenë në përdorim deri në vitet

⁴⁶ Ali Hadri-Milan Perkaj, *Pasqyrë e historisë nacionale shqiptare*, Rilindja, Prishtinë, 1960.

⁴⁷ Për jetën dhe veprën e Profesor Masar Kodrës shih: Nuridin Ahmeti, “Kontributi i historianëve nga Maqedonia në historiografinë shqiptare”, *Albanologjia*, nr. 5-6, Vëll. 3, UT, Tetovë, 2016, f. 316-316.

⁴⁸ Fehmi Pushkolli-Masar Kodra, *Historia për klasën e V të shkollës fillore*, ETMMKSAK, Prishtinë, 1977.

90-ta. Disa nga titujt e këtij teksti shkollor ishin: “Ç’është historia dhe çka na mëson”, “Bashkësitë me të hershme njerëzore”, “Shoqëria klanore”, “Formimi i klasave dhe shteteve skllavopronare”, “Kultura e popujve të Lindjes së lashtë ...”, “Greqia”, “Maqedonia”, “Roma”, “Krishterimi”, “Ilirët”, “Mbretërit Ilir”, “Luftërat Iliro-Romake”, “Dyndjet e popujve e popujve dhe formimi i shteteve barbare”, “Bizanti dhe vendosja e sllaveve në Siujdhesën Ballkanike”, Shqiptarët në kohën e feudalizmit të hershëm”, “Kryqëzatat”, “Shqiptarët në kohën e feudalizmit të zhvilluar”, “Kultura dhe arti të shqiptarët dhe sllavet e jugut në kohën e feudalizmit të zhvilluar”, “Rëndësia dhe mbrojtja e përmendoreve kulturo-historike” etj. Teksti ka 160 faqe dhe madhësinë 14X20 cm.




Dr FEHMI PUSHKOLLI — Dr MASAR KODRA

HISTORIA

PER KLASEN V TE SHKOLLES FILLORE

Në vitin 1983, emrin e profesor Masar Kodres e hasim si bashkau–torë me Mr. Jetullah Krasniqin dhe zyrtarisht, ky tekst, titullohej: “*Historia për klasën e I të edukimit dhe arsimit të mesëm të orien–tuar*”.⁴⁹

Ky tekst ka titujt e nëntitujt, disa nga titujt kryesor në këtë tekst janë: “Hyrje në histori”, “Periudha parahistorike”, “Koha e Vjetër–shoqëria skllavopronare”, “Rendi shoqëror te grekët, romakët dhe ilirët e vjetër”, “Koha e Mesme”, “Koha e Re”. Në kuadër të këtyre titujve janë edhe shumë nëntituj të tjerë. Me një fjalë, ky tekst trajtojnë historinë botërore nga parahistoria e deri në shekullin XIX. Teksti ka gjithsej 160 faqe dhe ka format 17X24 cm.



⁴⁹ Masar Kodra – Jetullah Krasniqi, *Historia për klasën e I të edukimit dhe arsimit të mesëm të orientuar*, ETMMKSAK, Prishtinë, 1983.


Në vitin 1988, profesor Masar Kodra së bashku me Dr. Jetullah Krasniqin botojnë tekstin shkollor të historisë për klasën e parë të shkollave të mesme.

Zyrtarisht ky tekst titullohej “*Historia për klasën e I të edukimit dhe arsimit të mesëm për të gjitha degët, përveç kulturologjike–gjuhësore, juridike–byroteknike, arsimore dhe të dramës*”.⁵⁰ Ky tekst ka titujt e nëntitujt, disa nga titujt kryesor në këtë tekst janë: “Hyrije në histori”, “Periudha parahistorike”, “Koha e Vjetër–shoqëria skllavopronare”, “Rendi shoqëror te grekët, romakët dhe ilirët e vjetër”, “Koha e Mesme”, “Koha e Re”. Në kuadër të këtyre titujve janë edhe shumë nëntitujt tjerë.

Me një fjalë, ky tekst trajton historinë botërore nga parahistoria e deri në shekullin XIX. Në këtë trajtim futet edhe historia e popullit shqiptarë, e cila fillon së trajtuari nga Ilirët e deri te Rilindja Kombëtare Shqiptare, por gjithnjë e parë në kuadër të sllavëve të Jugut, siç ishte e preferuar të trajtoheshin në atë kohë. Teksti ka gjithsej 180 faqe dhe me një format 17X24 cm.


Edhe teksti i botuar në vitin 1983 edhe ky i vitit 1988, po thuajse nuk ndryshojnë në aspektin e përmbajtjes.

⁵⁰ Masar Kodra - Jetullah Krasniqi, *Historia për klasën e I të edukimit dhe arsimit të mesëm për të gjitha degët, përveç kulturologjike–gjuhësore, juridike–byroteknike, arsimore dhe të dramës*, ETMMKSAK, Prishtinë, 1988.



Një vit më vonë, pra në vitin 1989, profesorin e gjejmë përsëri si bashkautorë me profesorin e kolegun e tij, profesor Qamil Gexhën. Në këtë tekst, prof. Kodra, është bashkautorë në tekstin "*Historia për klasën e VI të shkollës fillore*".⁵¹

⁵¹ Masar Kodra - Qamil Gexha, *Historia për klasën e VI të shkollës fillore*, ETMMKSAK, Prishtinë, 1989.



Ky tekst shkollor, për dallim nga teksti i një viti më parë, është i pajisur me hyrje, është i ndarë më qartësisht në krerë, tituj e nëntituj, ilustrimet dhe titujt e krerëve janë me ngjyra. Teksti trajton historinë e popujve nga mesjeta e hershme dhe vazhdon me disa popuj deri në shekullin XVIII. Për ta qartësuar edhe më shumë, ky tekst duket kështu. Kreu i Parë “Koha e mesme— mesjeta”, titujt kryesor “Evropa në kohën e feudalizmit të hershëm”, “Shqiptarët, sllavët e Jugut dhe fqinjët e tyre në periudhën e feudalizmit”, Evropa në kohën e feudalizmit të zhvilluar (shekulli XII–XV)”, “Shqiptarët–sllavët e Jugut–osmanët dhe fqinjët e tyre në periudhën e feudalizmit të zhvilluar”. Kreu i Dytë titullohet “Koha e re”, me titujt kryesor “Fillet e ekonomisë kapitaliste dhe kultura në

shoqërinë kapitaliste”, “Populli shqiptarë, sllavët e Jugut dhe fqinjët e tyre nën sundimin e të huajve prej shekullit XVI deri në fund të shekullit XVIII”. Teksti ka 114 faqe dhe me format 17 X 24 cm.

Më lartë u potencua kontributi i profesor Masar Kodrës në tekstet shkollore të historisë si bashkautorë. Mirëpo, për sa i përket teksteve shkollore të historisë, emrin e Profesor Kodrës e hasim edhe si recensentë në librat shkollorë të autorëve të tjerë. Kjo është e nënkuptueshme, sepse përvoja e një njeriu siç ishte profesor Masar Kodra i cili kishte punuar për disa vite në arsimin fillor dhe të mesëm, do të shërbente mjaftë mirë edhe si konsulentë në tekstet shkollore të historisë. Andaj, në vitin 1975 emrin e profesor Masar Kodres, si recensentë dhe me gradën shkencore docent i Universitetit të Prishtinës e hasim në tekstin shkollor “*Historia për klasën e VII të shkollës fillore*” me autor Skënder Rizajn dhe Muhamet Pirrakun⁵² dhe në vitin 1977, po si recensentë dhe me të njëjtën gradë shkencore emrin e Profesorit hasim në tekstin shkollor “*Historia për klasën e VII të shkollës fillore*” me autor Skënder Rizajn.⁵³

Nga librat e teksteve shkollorë të historisë të shfletuara, duke filluar nga teksti i parë, për të cilin bëmë fjalë më lartë e deri të vitet e 90-ta, emrin e Profesor Masar Kodrës në tekste shkollore të historisë e hasim në dy fusha.

1. Si bashkautorë në përpilimin e teksteve të historisë, dhe
2. Si recensentë, që nënkupton se ka dhënë këshilla e vërejtje profesionale për kolegët të cilët kishin përpiluar një tekst shkollor të historisë për një klasë të caktuar.

⁵² Skender Rizaj-Muhamet Pirraku, *Historia për klasën e VII të shkollës fillore*, ETMMKSAK, Prishtinë, 1975.

⁵³ Skender Rizaj, *Historia për klasën e VII të shkollës fillore*, ETMMKSAK, Prishtinë, 1977.

Tekstet e përpiluara, megjithëse kanë terminologjinë e kohës, shpjegimin e censuruar për ngjarjet e caktuara, ato tekste kryen funksionin e tyre në të mirë të atyre që u ishin dedikuar për një periudhë të caktuar kohore.

Emri i profesor Masar Kodrës në këto tekste si bashkautorë, mbase është edhe një tregues se Profesori ishte ithtarë i bashkëpunimit të frytshëm ndërkolegial. Në katër tekste shkollore kemi pothuajse emra të ndryshëm të profesorëve më të cilit bashkëpunoi profesori. Sigurisht që një angazhim i tij në përpilimin e teksteve të historisë edhe krahas punës së ligjëruesit në Universitetin e Prishtinës, nuk ishte e rastësishme, sepse ai para se të ishte ligjërues në universitet, në vitet e 50-ta ishte edhe mësimdhënës, kështu që dija prej një profesori universitar dhe përvoja prej një mësuesi disavjeçar, tanimë ishin derdhur dhe në tekstet e historisë në Kosovë.

Dhe krejt në fund, më lejoni të them se profesor Masar Kodra si autor i disa teksteve shkollore të historisë në Kosovë, nuk do të kujtohet vetëm nga ish-studentët e tij të cilët morën dije nga ai, por edhe nga shumë gjenerata në Kosovë, të cilët u pajisen me dije historike nga librat e tij.

NAIM HALIMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

**DR. MASAR KODRA – HISTORIAN,
JO VETËM I SHQIPTARËVE
TË MAQEDONISË**

Treva shqiptare, e cila sot shtrihet në Republikën e Maqedonisë, ka dhënë shumë burra të dijes e mençurisë. I tillë qe edhe prof. dr. Masar Kodra.

Masar Kodra, lindi në Dibër (1932), në një familje qytetare, arsimdashëse dhe atdhetare, që dallohej me rezistencën ndaj pushtuesve të huaj dhe shfrytëzuesve të vendit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Shkup. Në Shkup e Lubjanë, mbaroi studimet, ndërsa doktoratën, titullin e Doktorit të shkencave të historisë, e arriti në Zagreb, pas punësimit në Institutin e Historisë Nacionale të Maqedonisë, ku u furnizua me një sasi të madhe dokumentesh me vlerë, për historinë e popullit shqiptar, sidomos për shqiptarët e Maqedonisë.

Përndjekja dhe torturat që i bëri pushteti i atëhershëm ndaj familjes së tij dhe ndaj tij, e sidomos ndaj vëllait të tij, Xhaferit— luftërat atdhetar, patriotit shqiptar, i cili në vitin '49, qe ministër i Punëve Sociale në Qeverinë e Maqedonisë, e një vit më pas edhe ministër i Drejtësisë, i dënuar politikisht dhe i sëmure nga torturat në burgun e Goli Otokut, pa dyshim u reflektua edhe në punën shkencore të pof. Masar Kodrës.

Megjithatë, puna shkencore e dr. Masar Kodrës, nuk u ndal. Me përkushtim u mundua t'i mësoj gjuhët, së pari shqipen, pastaj maqedonishten, serbo-kroatishten, turqishten, frëngjishten e anglishten. Një kohë punoi si gazetar në „Flakën e Vëllazërimit”, në Shkup, pastaj në Institutin e Historisë Nacionale, mandej në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin Filozofik, në degën e Historisë, ku ligjëroi disa lëndë në studimet universitare, e pas tyre, në shqip e serbo-kroatisht. Udhëhoqi disa studentë, diplomantë, magjistrantë e doktorantë dhe mori pjesë në diplomimin e tyre. Si pedagog me dinjitet të lartë, ai, jo vetëm studentët që i ndihmoi, por kontribuoi edhe në institucionet ku punoi. Profesor Masari, punoi edhe në Tetovë. Qe njëri nga themeluesit e Universitetit Shqip të Tetovës (1994), anëtar Senati, dekan i Fakultetit Filozofik dhe shef i studimeve pasdiplomike, në Katedrën e Historisë.

Me zell të madh e pa lodhje, vazhdoi punën e shumë historianëve shqiptar, duke qëndruar në krye të aktiviteteve, simpoziumeve, konferencave shkencore, tribunave të shumta në shërbim të shënimt dhe të ndriçimit të ngjarjeve dhe personaliteteve tona kombëtare, sidomos të shqiptarëve në Maqedoni.

Puna e profesor Masarit, si shkencëtar dhe profesor universitar, u publikua në më shumë se 50 artikuj shkencor, me mbi 2.000 faqe, në disa revista si „Jehona”, e “Përparimi”, në monografi si „Shqiptarët e Maqedonisë gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore 1939–1944”, “Fan Noli në jetën politike të shoqërisë shqiptare”, “Çështja shqiptare në analet e diplomatike të Amerikës”, etj., shkrime të cilat vlerësohen në shkencat historike si studime mjaftë komplekse për historinë tonë mbarëkombëtare. Organizoi simpoziumin „Etnokultura e Dibrës”, në Dibër (1992), „Shqiptarët e Maqedonisë, në Shkup” (1994), konferencat shkencore në vitin '93,

94, 95, 96, 2001 etj., disa tribuna shkencore, që ishin në shërbim të shënimit dhe ndriçimit të ngjarjeve dhe personaliteteve, tona historike, jo vetëm të shqiptarëve të trevës prej nga ishte ai, Maqedonisë.

Përveç këtyre që thamë, në këtë rast, për profesor Masarin, ka mbetur edhe shumëçka për t'u thënë. S'bën pa thënë se Ai, ishte i urtë për nga natyra, modest, i çelur, i këndshëm në bisedë e i sinkertë në këshillime, i matur në fjalime, i fjalës, i veprës dhe shqiptar i besës. Gjatë gjithë jetës, si të parët e tij, që në shërbim të popullit. Ishte i pa ndryshueshëm në bindjet e tij. Si mësues i yni, me të cilin një kohë punuam, në shumë ndeja të rastit e takime të organizuara, na fliste për ngjarje të ndryshme historike, për popullin tonë që e donte, për të bërat e tij, për partitë politike, për unitetin kombëtar dhe për detyrën që duhej të kishim ne si historian. Shpesh na thoshte „Merrni pjesë në krijimin e historisë tonë, madje shkruane vetë, mos prisni prej të tjerëve, mos rrini, mos flini, prini, etj.etj., sepse e kemi historinë e pasur e të lavdishme”. Këto dhe shumë mësimë tjera, prej këshilltari, dijetari dhe shkencëtari, na bënë që të ecim drejt në jetë, me dinjitet, duke përkujtuar me respekt historianin, studiuesin, misionarin, humanistin, vizionarin dhe kryetarin e parë të Shoqatës së Historianëve Shqiptarë të Maqedonisë, profesor doktor Masar Kodrën.

Një përkujtim të merituar profesorit të çmuar Masar Kodra po i bënë sot, edhe Shoqata e Historianëve Shqiptarë të Maqedonisë dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve në Shkup, duke përkujtuar dhe shpreh mirënjohje për punën e palodhshme, në ndriçimin e fakteve historike dhe në shkrimin e historisë tonë kombëtare, jo vetëm në trevat shqiptare, por edhe më larg ku jetojnë përherë e përkohësisht shqiptarët.

Shkurt, profesor Masar Kodra, qe një veprimtar i shkëlqyeshëm, jo vetëm në fushën e historisë. Po të jetonte më gjatë, me siguri se do të kontribuonte më shumë, por ja që vdekja e mori para kohe, duke dëmtuar shumë edhe historiografinë tonë shqiptare, prej të cilës, të gjithë ne, së paku mësuam nga diçka. Ai, ishte dhe mbeti, simbol i punës, historian shembullor, studiues i mirëfilltë, pedagog universitar, paqedashës e humanitar, me ndërgjegje të pastër, etikë e moral të shëndoshë, atdhetar i devotshëm dhe kolos i historisë, jo vetëm i trevave shqiptare që përfshihen sot në Republikën e Maqedonisë.

ZEQIRJA REXHEPI

Universiteti i Tetovës

**LUFTA ANTIFASHISTE NACIONAL
ÇLIRIMTARE NË SHQIPËRI, NË VEPRËN E
MASAR KODRËS: “ÇËSHTJA SHQIPTARE NË
ANALET DIPLOMATIKE AMERIKANE –
1918–1945”**

Masar Kodra me veprën dhe kontributin e tij, padyshim se la gjurmë tepër të rëndësishme për shkencën e historisë, me çka i siguroi vetes vend të sigurt në historiografinë shqiptare. Në fokus të veprës së tij mbeti çështja shqiptare.

Kam pasur rastin ta njohë Masar Kodrën, me ç’rast me një pasion të veçantë fliste rreth veprës për të cilën kishte dhënë shumë mund: “*Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane 1918–1945*”. Kjo dhe ishte arsyeja që zgjodha temën, e cila është e lidhur pikërisht me këtë vepër. Në të vërtetë, unë kam zgjedhur vetëm një segment të veprës në fjalë që është e lidhur me Luftën Antifashiste – periudha e gjermanëve në Shqipëri (8 shtator 1943– fundi i luftës), periudhë kjo që është tejet sfiduese për historianët dhe për shkencën e historisë në tërësi, që për epilog vazhdojnë të mbeten interpretimet kundërtëhenëse brenda historiografisë shqiptare.

Masar Kodra në veprën e përmendur bazohet kryesisht në dokumentet e diplomacisë amerikane, ato të cilat i kishte pasur në disponim, sikurse dhe në publikimet e ndryshme. Me këtë rast ai hedh dritë mbi informacionet që i ishin përcjellë Departamentit të Shtetit

dhe qëndrimin e qeverisë së SHBA—së rreth zhvillimeve të Luftës Antifashiste në Shqipëri.

Siç dihet, në gjysmën e dytë të vitit 1943, Lufta e Dytë Botërore zhvillohej në favor të aleatëve antifashistë. Në këtë kohë, në Shqipëri, Lufta Nacionalçlirimtare ishte shndërruar në faktor të rëndësishëm. Mirëpo, shqiptarët ishin të ndarë në tri grupime politike: Partia Komuniste, Balli Kombëtar dhe zogistët e Abas Kupit. Përpjekjet për të unifikuar formacionet politike dhe ushtarake në Konferencën e Mukjes dështuan.

Nga ana tjetër, mërgata shqiptare, edhe përkundër faktit se ishte e përçarë, përpigjej të prezantohet si e unifikuar me qëllim të formimit të qeverisë në mërgim, e cila do të njihej nga SHBA. Në këtë kontekst Masar Kodra e përmend Pjetër Kolonjën (ihtarë i Zogut), i cili i dërgon një letër sekretarit të Jashtëm të SHBA—së, Kordeli Hills, me të cilën e informon se dy organizatat politike të mërgatës në Amerikë, “Vatra” dhe “Shqipëria e Lirë”, janë marrë vesh të formojnë Qeverinë e përkohshme shqiptare në krye me mbretin Zog, qeveri që do të përfaqësojë Shqipërinë në Kombet e Bashkuara.⁵⁴

Mirëpo, amerikanët kishin informacionet e tyre për zhvillimet në Shqipëri. Menjëherë pas kapitullimit të Italisë dhe vendosjes së pushtetit gjerman në Shqipëri, në tetor 1943, shërbimet e diplomacisë amerikane kishin marrë informata se në Shqipëri është formuar Komiteti Ekzekutiv (Qeveria kuislinge) me ndihmën e komandës ushtarake gjermane, në të cilën merrnin pjesë eksponentë të Ballit Kombëtar dhe elemente zogiste.⁵⁵

⁵⁴ Masar Kodra, *Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane – 1918-1945*, f. 130.

⁵⁵ Masar Kodra, *Çështja shqiptare...*, f. 131.

Vlen të theksohet se, në periudhën e vendosjes së pushtetit gjer-man, Shqipëria ishte vënë në fokus të diplomacisë amerikane. Nga të dhënat që na sjell Masar Kodra kuptojmë se, në këtë periudhë SHBA-të ishin shumë të interesuara për zhvillimet politike dhe ushtarake në këtë vend, që krahas Greqisë kishte një rëndësi gjeo-strategjike për planet e ardhshme amerikane dhe angleze. Andaj, Qeveria amerikane u kishte urdhëruar përfaqësuesve diplomatikë në Evropë, të përcjellin siç thuhet “*me maturi të madhe çështjen shqiptare*”. Për vëmendjen dhe interesimin amerikan dëshmon edhe letra që Sekretari i Shtetit të SHBA, Kordell Hilli, i drejton Çarls Hartit,⁵⁶ në të cilën mes tjerash thuhet: “*Shteti dhe populli i SHBA-së informohen në mënyrë të vazhdueshme për përpjekjet që bën popull shqiptar për të mbrojtur integritetin dhe independencën e vet shtetërore...*”.⁵⁷

Masar Kodra në veprën e tij shpalos faktin se, njëri nga ekspertët e Sektorit të shërbimeve strategjike amerikane Filip Adamsi, përçarjen në Mukje, e vlerëson si “fatkeqe”, e cila do të vështirësojë aksionet rreth çlirimit përfundimtar të Shqipërisë, duke theksuar “*veçanërisht në luftë kundër armikut të përbashkët*” dhe duke paralajmëruar se, “*kështu nuk do të mund të evitohet as lufta civile*”.⁵⁸ Zgjidhja fatlume, sipas Adamsit ishte formimi i Komitetit Kombëtar Shqiptar, apo Qeveria Shqiptare në mërgim, ku do të mund të përfaqësohen të dy elementet: Lëvizja Nacionalçlirimtare dhe Balli Kombëtar.

Edhe ambasadori amerikan në Londër, Uinanti e informonte Departamentin e Shtetit se në Shqipëri veprojnë dy grupe guerile, ato

⁵⁶ Letër e Edit Durhamit që i dërgon Fan Nolit, më 7 nëntor 1943 (Çarls Harti kishte qenë përcjellësi i Legatës amerikane në Shqipëri).

⁵⁷ Masar Kodra, *Çështja shqiptare...*, f. 139.

⁵⁸ Po aty, f. 135.

të Ballit Kombëtar dhe të LNÇ, të njohura si forca partizane. Uinanti theksonte se, “*ekzistojnë dëshmi se anëtarët e Ballit Kombëtar ngandonjëherë bashkëpunojnë me okupatorin gjerman në Shqipëri*”.⁵⁹

Masar Kodra në veprën e tij na ofron edhe të dhëna të tjera, të cilat dëshmojnë për interesimin e jashtëzakonshëm të amerikanëve ndaj zhvillimeve në Shqipëri. Kështu, diplomati amerikan, B. Beri, konsull i Konsullatës së përgjithshme amerikane në Stamboll, i ngarkuar të përcillte çështjen shqiptare, nga informatat që kishte mbledhur (me këtë rast përmendet emri i Hasime Jakovës, gruaja e një shqiptari të shquar, që në këtë kohë jetonte në Stamboll, dhe që kishte pasur lidhje me një zyrtar të lartë të Qeverisë kuislinge shqiptare). Sipas veprës në fjalë, mbi bazë të informatave që kishte diplomati amerikan Beri, përmes një Raporti njoftohet Departamenti i Shtetit të SHBA-së⁶⁰ (më 24 dhjetor 1943).

Nga Raporti i Berit kuptojmë se, “*Balli Kombëtar*” ka hequr dorë nga lufta kundër okupatorit gjerman dhe se konfrontimi i tij me PKSH ka marrë përpjesëtime të mëdha”... për të vazhduar se, “*shumë ithtarë të kësaj organizate duke dashur të largohen nga rruga e tradhtisë, në të cilën i çonte udhëheqja e Ballit Kombëtar, u larguan nga ajo dhe u bashkuan me LNÇ-në, duke u inkuadruar në radhët e njësisë partizane*”.⁶¹

Nga raportet e diplomatëve amerikanë, të cilat i ofron autori Masar Kodra, fitojmë një pasqyrë të qartë për zhvillimet politike dhe ushtarake në Shqipëri, në muajt e fundit të vitit 1943. Kjo është përiudha kur rezistenca aktive – lufta antifashiste (të cilën e kërkonin

⁵⁹ Po aty, f. 138.

⁶⁰ Po aty, *Raporti i B. Berit* (NA – USA, 875.00/575), f. 143.

⁶¹ Po aty, f. 146.

me ngulm aleatët), zhvillohet me intensitet gjithnjë e më të madh, por që udhëhiqej nga Fronti Nacionalçlirimtar (komunistët), përderisa forcat nacionaliste (Balli Kombëtar) gjithnjë e më tepër e humbnin terrenin (përkrahjen e popullit).

Nga të dhënat që i shfrytëzon Masar Kodra del se në fillim të vitit 1944 LNÇ (PK) ishte e vetmja forcë në Shqipëri që luftonte për çlirimin e vendit.⁶²

Në kontekst të zhvillimeve në Shqipëri, diplomati Beri nga Stambolli, për Departamentin e Shtetit ofron edhe një analizë të hollësishme për sa i takon konfliktit ideologjik dhe politik në Shqipëri, midis Partisë Komuniste dhe Ballit Kombëtar. Sipas tij, “Ballistët e shihnin Partinë Komuniste si një organizatë e cila vepron me urdhra nga jashtë (nga PKJ), ndërsa komunistët nuk mund të mbështeteshin në Ballin Kombëtar, pasi politika e tyre është për aksion të furishëm kundër okupatorit, pa marrë parasysh viktimat e vendit.”⁶³

#

Në gjysmën e dytë të vitit 1944, diplomati amerikan Markhami në Raportin e muajit korrik, me titull “Gjendja në Shqipëri”, mes tjerash shkruan: “*Partizanët janë grupi më dinamik në Shqipëri, i cili më tepër se çdo grup tjetër në Shqipëri i ka ofruar rinisë së zjarrtë shqiptare shpresë për një ardhmëri më të mirë*”.⁶⁴ Për të vazhduar se është koha që Qeveria e Uashingtonit të përcaktojë qëndrimin e vet midis partizanëve dhe mbretit Zog.⁶⁵

⁶² Po aty, f. 158.

⁶³ Masar Kodra, *Çështja shqiptare...*, f. 160.

⁶⁴ Po aty, f. 172.

⁶⁵ Raporti: NA-USA, 875.00/7-1344 (13 korrik 1944).

Nga informatat e shumta me të cilat dispononte diplomacia amerikane, Sekretari për marrëdhënie me Evropën pranë Departamentit amerikan, në fillim të shtatorit 1944 harton një Raport në të cilin e analizon gjerë e gjatë çështjen shqiptare. Sipas Masar Kodrës, në këtë kohë politika e jashtme amerikane ishte vënë përballë dy alternativave: *të njohë zyrtarisht Luftën Nacional Çlirimtare në Shqipëri apo të njohë ndonjë qeveri në mërgim.*

Raporti në fjalë përfshinë 16 pika. Nga të dhënat e këtij Raporti kuptojmë se, politika zyrtare e SHBA-së e kundërshton njohjen zyrtare të Qeverisë provizore shqiptare (Përmet), pra e kundërshton Frontin Nacionalçlirimtar, duke përmendur një varg arsyes, midis të cilave, se:

–FNÇ në thelb është organizatë komuniste (pika 3),

–Njohja e FNÇ nga na e SHBA-së do ti hapte rrugën shpifjeve ndërkombëtare dhe do të ishte shkas për përzierje në punët e brendshme të Shqipërisë... (pika 11).⁶⁶

Mirëpo, vlen të theksohet se në shtojcën e Raportit, fitohet përtpjja se politika e jashtme amerikane e pranon realitetin e “hidhur” për ta, duke theksuar se: “FNÇ e ka fituar të drejtën e disa formave të njohjes përmes rezistencës së vet të suksesshme kundër gjermanëve. Lufta ka qenë prova përfundimtare e patriotizmit dhe e besimit të fituar të popullit në mbarë vendin”. Për të vazhduar, se “Forcat mosrezistuese (Balli dhe Legaliteti) nuk kanë të drejtë të kërkojnë barazim (me FNÇ) dhe besimin e aleatëve në çështjet politike që i përkasin Shqipërisë”.⁶⁷

⁶⁶ Po aty, f. 190-192.

⁶⁷ Po aty, f. 192.

Si rezultat i studimit të çështjes shqiptare nga diplomatë më të spikatur, Sekretari për marrëdhënie me Evropën i propozon Departamentit të Shtetit tri mundësi:

1. FNÇ të njihet si Qeveri e përkohshme në territoret e çliruara shqiptare;
2. FNÇ të njihet si autoritet i përkohshëm në zonat që janë nën ndikimin dhe nën kontrollin e tij dhe
3. FNÇ të njihet si Qeveri e përkohshme për tërë Shqipërinë.⁶⁸

Epilogu

Është i njohur fakti se, aleatët anglo-amerikanë synonin të zbar-kojnë me trupat ushtarake edhe në Shqipëri. Ndërkohë, më 20–23 tetor 1944 mbahet mbledhja e dytë e KANÇ në Berat, në të cilën vendoset që Komiteti Antifashist NÇ të shndërrohet në Qeveri Demokratike të përkohshme në Shqipëri në krye me Enver Hoxhën. Sipas Masar Kodrës, krijimi i qeverisë, e cila doli nga zjarri i luftës antifashiste i eliminoi të gjitha planet anglo-amerikane për Shqipërinë. Me vendosjen e pushtetit komunist, marrëdhëniet diplomatike mes Shqipërisë dhe SHBA-së e Britanisë së Madhe ndërpritën, për t'u rivendosur në vitin 1991, pas rënies së sistemit komunist në Shqipëri.

Përfundim

Duke u bazuar në dokumente të diplomacisë amerikane, Masar Kodra në veprën e tij “Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane 1918–1945”, kur është fjala për rezistencën antifashiste

⁶⁸ Po aty, f. 194 (NA-USA. 875.01/2814), 5 tetor 1944.

gjatë Luftës së Dytë Botërore, na prezanton realitetin shqiptar, i cili duhet pranuar se është paksa i hidhur: shqiptarët mbetën të copëtuar – brenda sferës së interesit komunist.

Lufta e Dytë Botërore ishte një konflikt me përmasa planetare, ku Bota ishte e ndarë në dy grupime shtetesh dhe kombesh: grupimi nazifashist dhe ai antifashist. Mirëpo, midis aleatëve antifashistë me sisteme të ndryshme politike, ekzistonte mosbesim i madh, i cili erdhi në shprehje kah fundi i luftës.

Në rrethana kundërtë në marrëdhëniet midis aleatëve, zhvillohej edhe rezistenca antifashiste në Shqipëri. Faktorët politik, pra – pa të cilëve qëndronin formacione ushtarake, në mënyrë egoiste e zhvillonin veprimtarinë e tyre. Në Mukje ato përfundimisht u ndanë.

Në gjysmën e dytë të vitit 1943 dhe vitin 1944 Lëvizja Antifashiste në Shqipëri ishte vënë nën kontrollin e FNÇ, ose më saktë nga PKSH. Forcat nacionaliste, Balli Kombëtar dhe Legaliteti, me politikën e tyre pasive të mosrezistencës apo kolaboracioniste me gjermanët, dalëngadalë e kishin humbur mbështetjen tek populli, fakt që është vërejtur nga përfaqësuesit amerikanë. Nga pikëpamja ideologjike, FNÇ (komunistët) ishte në kundërshtim me aleatët perëndimor, mirëpo nga pikëpamja ushtarake, FNÇ e zhvillonte veprimtarinë në përputhshmëri të plotë me politikën amerikane.

Përmes dokumenteve të shumta, Masar Kodra shpalos dëshmi të mjaftueshme për faktin se, cilët nga forcat politike dhe ushtarake në Shqipëri iu përmbajtën me konsekuencë angazhimit ndërkombëtar për ta luftuar fashizmin. Padyshim se ky ishte FNÇ dhe partizanët, ndërsa të tjerët gjatë kësaj kohe më shumë bënë sehir (zogistët), apo dhe bashkëpunuan me gjermanët (ballistët).

ABDULLA MEHMETI

Universiteti i Tetovës

KONTRIBUTI I DR. MASAR KODRËS NË AKTIVITETET KULTURORE – SHKENCORE

Po aq sa është nder dhe krenari, njëkohësisht është dhe përgjegjësi të flasësh për jetën dhe veprimtarinë e një personaliteti të shquar, sidomos në një përvjetor të rëndësishëm siç është ky i sotmi, kur profesori Masar Kodra ka vite që nuk është mes nesh.

Ne që kemi pasur fatin të jemi pjesë e këtij rrugëtimi të mundimshëm, sidomos në dekadën e fundit të shekullit të kaluar, që kemi bashkëpunuar dhe bashkëvepruar me profesor Masarin, kemi detyrime të dyfishta, sepse veprimtaria e gjerë e këtij intelektual, në fushën shkencore, arsimore dhe shoqërore, nuk mund të përmbledhet me pak fjalë, me disa radhë në një kumtesë ose fjalë rasti siç është kjo me të cilën ju drejtohem sot.

Fillimi i proceseve demokratike në vendin tonë, në fund të viteve të tetëdhjeta dhe fillim të atyre të nëntëdhjeta, nuk i gjeti të gatshëm të gjithë njerëzit, sidomos shtresën intelektuale, për ndryshimet e reja që e prisnin popullin shqiptar në të ardhmen. Ishin të paktë individët që menjëherë ju rrekën punës, sapo u krijuan kushte të reja pune dhe veprimtaria të lirë. Njëri ndër këta ishte edhe profesori Masar, i cili krahas veprimtarisë së tij të rregullt arsimore dhe shkencore të mëparshme, do të tubojë rreth vetes me dhjetëra intelektualë, bashkëveprimtarë të mëhershëm dhe më të ri, bashkë me të cilët do të vihen në ballë të këtyre proceseve të reja, me shpresë se ka ardhur dita kur shqiptarët duhet t'i fitojnë të drejtat e tyre të mohuara e nëpërkëmbura nga regjimi komunist. Kjo ishte kjo kohë

e ndryshimeve dhe transformimeve të mëdha në jetën politike dhe shoqërore të shqiptarëve edhe në Maqedoni, kur përveç domosdoshmërisë së organizimit në rrafshin politik, ndjehej nevoja edhe e organizimit në sferat tjera të jetës, sidomos në ato profesionale, si në fushën e kulturës, arsimit, shkencës etj.

Kjo ka qenë edhe arsyeja dhe nevoja e bashkërendimit të punëve dhe aktiviteteve tona që në agimin e dekadës së fundit të shekullit të kaluar, nga viti 1990, kur filloi edhe bashkëpunimi im më i afërt me profesorin Masar Kodra. Në atë kohë, profesori udhëhiqte Shoqatën e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, ndërsa unë drejtoja Bashkësinë Kulturore Shqiptare në Maqedoni. Si dy kryetarë të asociacioneve me fushëveprime të përafërta, kemi ndarë fatin dhe kemi përjetuar mundimet e njëjta në organizimin e shumë aktiviteteve, manifestimeve dhe veprimtarive, të cilat për fatin tonë të mirë sollën më vonë edhe frytet e tyre, me të cilat duhet të krenohemi ne sot, do të krenohen edhe gjeneratat pas nesh, duke mos harruar për asnjë çast mundin dhe sakrificat e personaliteteve si profesor Kodra, i cili dha gjithçka nga vetja për arritjen e këtyre qëllimeve madhore për historinë, gjuhën, kulturën, identitetin dhe të ardhmen e shqiptarëve në Maqedoni dhe jo vetëm.

Në pamundësi që me këtë rast të përfshihen të gjitha këto veprimtari dhe aktivitete, por edhe me qëllim të përmbledhjes së tyre rreth temës bosht të kësaj kumtese, në vazhdim në formë kronologjike do t'i përmendim vetëm disa aktivitete më të rëndësishme, të cilat i kanë parapri projektit më madhor kombëtar të shqiptarëve në Maqedoni, me theks të veçantë kontributin e profesor Masar Kodrës për themelimin dhe ngritjen e Universitetit të Tetovës.

I. Kontributi në organizimin e Simpoziumit shkencor „Shqiptarët e Maqedonisë”

Me iniciativë të Bashkësisë Kulturore Shqiptare në Maqedoni, me seli në Tetovë, më 30 qershor të vitit 1991 u vendos të mbahet një simpozium shkencor deri në fund të atij viti, me qëllim që lëvizjes politike të shqiptarëve t'u hap shtigje të reja, t'u krijojë vizion dhe jep kafen e nevojshme, duke vënë në shërbim të saj kontributin shkencor të gjithmbarshëm që kishte arritur ta jep shkenca shqiptare deri në atë kohë për shqiptarët në Maqedoni, sidomos për aspiratat historike kombëtare në drejtim të së cilave duhet të orientohet lëvizja e re politike, për çka edhe në vetë strategjinë e organizimit u parapa përfshirja e drejtpërdrejtë edhe e përfaqësuesve të këtyre subjekteve, krahas punonjësve shkencorë e arsimorë kompetentë për organizimin e një tubimi kaq të rëndësishëm shkencor.

Atëkohë, duke e çmuar punën e tij shkencore e arsimore, nivelin e lartë profesional, moral dhe atdhetar, profesorit Masar Kodra iu besua detyra e kryetarit të Këshillit organizues të këtij Simpoziumi shkencor.)⁶⁹ Ky simpozium i tuboi pjesën më të madhe të studiuesve shqiptarë, përfaqësuesit e institucioneve më të rëndësishme shkencore, arsimor edhe kulturore të shqiptarëve në nivel kombëtar, nga Tirana, Prishtina, Shkupi dhe viset tjera shqiptare, deri në nivel të Akademive të shkencave.

⁶⁹ Procesverballi origjinal nga mbledhja e Kryesisë së Bashkësisë Kulturore Shqiptare, e mbajtur në Tetovë, më 30 qershor 1991, (material nga Arkivi i BKS-së

Simpoziumi „Shqiptarët e Maqedonisë” i zhvilloi punimet gjatë tri ditëve në Shkup, në hapësirat e Medresesë „Isa Beu” në Kondovë të Shkupit, më 20, 21 dhe 22 dhjetor të vitit 1991)⁷⁰

Në cilësi të kryetarit të Këshillit organizues të këtij simpoziumi, profesor Masar Kodra e mbajti fjalën e hapjes për fillimin e punimeve të këtij tubimi të rëndësishëm shkencor, niveli i të cilit nuk ishte përjetuar asnjëherë më parë në historinë e popullit shqiptar në Maqedoni, duke marrë parasysh numrin e pjesëmarrësve, bagazhin e krijimtarisë dhe kompetencën shkencore të pjesëmarrësve me kumtesa shkencore në këtë simpozium. Përveç kësaj, profesor Masar Kodra e mbajti edhe një kumtesë me shumë interes, në ditën e tretë të punimeve të simpoziumit, me titull: „Shqiptarët e Maqedonisë në fillim të Luftës së Dytë Botërore”).⁷¹

II. Kontributi për shënimin e 85 vjetorit të Kongresit të Manastirit

Me qëllim të zgjimit të vetëdijes së qytetarëve shqiptarë në Maqedoni, sidomos tek gjeneratat e reja, por edhe si detyrim për shënimin e ngjarjeve më të rëndësishme nga e kaluara, tradita jonë kulturore dhe historike, më 17 nëntor 1993, u shënua 85 vjetori i Kongresit të Manastirit, me disa manifestime kulturore dhe shkencore të mbajtura në Shkup dhe Tetovë, të cilat u vlerësuan shumë lartë nga shtypi i kohës.)⁷²

⁷⁰ Programi i Simpoziumit shkencor „Shqiptarët e Maqedonisë”, f. 5 (material nga Arkivi i BKSH-së)

⁷¹ Abdulla Mehmeti „Simpoziumi shkencor që e krijoi platformën kombëtare për të ardhmen e shqiptarëve” (pjesa e parë), shih: <http://pashtriku.org/?kat=60&shkrimi=3090>

⁷² „Njësimi i alfabetit - ngjarje më e rëndësishme në historinë tonë kombëtare”, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 19 nëntor 1993, f. 3.

Edhe përkundër përpjekjeve dhe kërkesave zyrtare drejtuar institucioneve më të larta të pushtetit të atëhershëm për shënimin e këtij përvjetori edhe në qytetin e lindjes së alfabetit të gjuhës shqipe, në Manastir, kjo përpjekje e organizatorëve u refuzua nga pushteti, kryesisht duke pasur parasysh frymën shoviniste që kishte përfshirë në atë qytet pas pavarësimit të Maqedonisë nga ithtarët e partisë OBRM–PDUKM.

Kështu, manifestimi qendror me një akademi solemne u mbajt në Teatrin e dramës shqipe në Shkup, në të cilën morën pjesë përfaqësues të lartë politikë, nga kori diplomatik dhe intelektualë të shumtë të ardhur nga e gjithë hapësira shqiptare. Fjalën e rastit në këtë akademi e mbajti prof. dr. Kristaq Prifti, i cili i përshëndeti të pranishmit edhe në emër të kryetarit të atëhershëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Shaban Demiraj.)⁷³

Në sesionin shkencor të mbajtur po atë ditë në Qendrën për kulturë në Tetovë, kushtuar Kongresit për njësimin e Alfabetit të gjuhës shqipe, kësaj date të ndritshme të kombit shqiptar, u paraqitën mbi dhjetë kumtesa shkencore, nga studiues eminentë nga Tirana, Prishtina, Shkupi, Tetova dhe viset tjera shqiptare. Shënimi i 85 vjetorit të Kongresit të Manastirit u organizua, sipas programit të manifestimit, në mënyrë zyrtare, në organizim të Bashkësisë Kulturore Shqiptare në bashkëpunim me Shoqatën e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, të udhëhequr nga profesor Masar Kodra dhe Lidhjen e Historianëve të Shqipërisë, të udhëhequr atëkohë nga prof. dr. Petrika Thëngjilli.)⁷⁴

⁷³ Telegrami përshëndetës nga prof. dr. Shaban Demiraj, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (Arkivi i BKSH-së)

⁷⁴ Burimi i cituar, sipas gazetës „Flaka e vëllazërimit”, 19 nëntor 1993, f. 3.

III. Kontributi në iniciativën për hapjen e Fakultetit Pedagogjik me mësim në gjuhën shqipe në Shkup

Mungesa e kuadrit arsimor, parashkollor, fillor e të mesëm dhe shterja e burimeve për kualifikim permanent të këtij kuadri të domosdoshëm në Republikën e Maqedonisë, e nxiti Unionin e Intelligjencies Shqiptare në Maqedoni, të gjitha asociacionet dhe subjektet legjitime politike shqiptare, për zgjidhjen e këtij problemi përmes themelimit të një fakulteti, i cili do të ishte vazhdimësi e natyrshme e Akademisë së dikurshme Pedagogjike me mësim në gjuhën shqipe në Maqedoni.

Më 08.10.1987, Këshilli Arsimor i Akademisë, me Dekret të nënshkruar nga ministri i Arsimit i asaj kohe, u morr vendim që të jetësohet neni 11-të famëkeq i Ligjit për Arsim të Orientuar të Maqedonisë, i cili parashihte që mësimi në institucionet e universitetit të zhvillohet në gjuhën maqedonase, kuptohet që më parë strategji e përgatitur e më pastaj të lansohet në rastin e volitshëm.)⁷⁵

Kësaj iniciative, për t'i dhënë edhe peshë të merituar profesionale e shkencore, u angazhua një grup pune (Avni Zlatku, Murat Isaku, Hysen Ramadani, Ramë Haskaj, dr. Xhevat Gega, dr. Remzi Nesimi, dr. Tahir Zajazi, dr. Murat Murati dhe mr. Nexhat Abazi), me detyrë që të hartojnë elaborat për themelimin e Fakultetit Pedagogjik në gjuhën shqipe në Maqedoni. Krahas elaboratit, drejtuar organeve kompetente të Republikës, përmes një grupi koordinues u realizuan edhe negociata të shumta me Presidentin e Republikës, Kryetarin e Parlamentit, të Qeverisë, me Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës Fizike, si dhe me Rektorin e Universitetit të Shkupit. Megjithatë, përveç premtimeve verbale, me asgjë materiale nuk u

⁷⁵ Prof. dr. Tahir Zajazi, revista „Jehona”, nr. 1-2/1999, f. 81.

konkretizua kjo kërkesë e justifikuar shoqërore e popullatës shqiptare në Maqedoni.

Të bindur për peshën e kësaj kërkesë të arsyeshme e fisnike, Unioni, asociacionet, subjektet politike dhe intelektualët e pavarur shqiptarë të Maqedonisë, më 20 gusht 1993 e formuan Komisionin Amë (dr. Masar Kodra, dr. Remzi Nesimi, dr. Tahir Zajazi, dr. Murat Murati, dr. Mutezan Ismaili, dr. Abdurauf Pruthi dhe mr. Sejfedin Haruni), me detyrë të kërkojnë zgjidhje të mundshme për të vënë Fakultetin Pedagogjik në veprim me fillimin e vitit akademik 1994/95. Me themelimin e Komisionit Amë u bë kthesë cilësore në rrjedhën e procesit për themelimin e fakultetit. Kështu, kërkesa gjithëpopullore u koncentrua në këtë organ me kompetencë legjitime shkencore. Ky komision i analizoi të gjitha alternativat e mundshme, koordinoi punët dhe duke pasur në konsideratë domosdoshmërinë e pakontestueshme për përgatitjen e kuadrit arsimor shqiptar, angazhoi një grup punues (Avni Zlatku, dr. Tahir Zajazi, dr. Murat Murati), për hartimin e Projektit për hapjen e këtij fakulteti.

Në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 1994, në të cilën morën pjesë përfaqësues të shumicës së asociacioneve, subjekteve politike dhe intelektualë të pavarur, Komisioni Amë e ka prezantuar Projektin për themelimin e Fakultetit Pedagogjik, të cilin ky tubim e ka aprovuar njëzëri.⁷⁶

Në anën tjetër, kryesia e Bashkësisë Kulturore Shqiptare, gjatë gjysmës së dytë të vitit 1993, pas një analize të hollësishme të gjendjes së arsimit në gjuhën shqipe në Maqedoni, sidomos mun-

⁷⁶ Publikimi „Fakulteti Pedagogjik me mësim në gjuhën shqipe” (përmbledhje dokumentesh), Shtëpia botuese „Luma”, Tetovë, 1994.

gesën e arsimit universitar në gjuhën amtare, përgatiti një plan operativ dhe ndërmori disa aktivitete, mes tyre realizoi edhe dy takime me Komisionin Amë për hapjen e Fakultetit Pedagogjik me mësim në gjuhën shqipe, në Shkup, me qëllim të njohjes për së afërmi me situatën e përgjithshme, sidomos me qëndrimin e pushtetit aktual në lidhje me këtë çështje, dhe sidomos për përbashkimin e faktorit shqiptar rreth qëllimeve me interes të përgjithshëm kombëtar.

Për këtë qëllim dhe në këtë frymë u realizuan dy takime me Komisionin Amë për hapjen e Fakultetit Pedagogjik në Shkup, edhe atë:

a) Takimi i parë u mbajt në Shkup, më 9.11.1993. Këtë takim e organizoi Komisioni Amë për hapjen e këtij Fakulteti në kuadër të Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup. Ky ishte takimi ynë i parë me bartësit e kësaj iniciative dhe u realizua me kërkesë të tyre, me ndërmjetësimin e dr. Murtezan Ismailit, i cili atë kohë ishte anëtar i këtij Komisioni, në përpjekje për të gjetur zgjidhje për jetësimin e kësaj ideje që kishin ngritur në kuadër të Unionit të Inteligjencies Shqiptare në Maqedoni, të cilin atëkohë e udhëhiqte dr. Xhevat Gega.

Në fillim të këtij takimi, u njoftuam në lidhje me bisedimet e zhvilluara me organet më të larta të pushtetit të atëhershëm: me kryetarin e Maqedonisë, Kiro Gligorov; kryetarin e Parlamentit, Stojan Andov; kryetarin e Qeverisë, Nikolla Klusev; Ministrin e Arsimit dhe Kulturës Fizike, Dimitar Bajallxhiev; si dhe me organet drejtuese të Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi” të Shkupit.

Në vazhdim të këtij takimi, fjalën e mori dr. Masar Kodra, i cili shprehu mendimin se, duhet të mblidhen të gjitha subjektet shqiptare në Maqedoni për pleqimin e kësaj çështje. Në vazhdim të

këtij takim, nga organizatori u soll përfundim që të mbliidhen sërish për ta diskutuar çështjen e hapjes së Fakultetit Pedagogjik në gjuhën shqipe, por në përbërje më të zgjeruar dhe me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të subjekteve politike dhe jopolitike të shqiptarëve në Maqedoni, ndërsa takimi i radhës u caktua të mbahet në Gjinnazin „Zef Lush Marku, më 18.11.1993, me fillim në orën 16:00. Në këtë takim u propozua që të ftohen nga tre përfaqësues prej të gjitha asociacioneve ekzistuese të shqiptarëve në Maqedoni.

Në këtë takim tonë të parë me Komisionin Amë, morën pjesë: dr. Renzi Nsini, dr. Masar Kodra, dr. Xhevat Gega, dr. Tahir Zajazi, dr. Murat Murati, dr. Abdurauf Pruthi, dr. Murtezan Ismaili, ndërsa nga BKSH, në cilësi të mysafirëve morrëm pjesë, unë Abdulla Mehmeti, në cilësi të kryetarit të Bashkësisë Kulturore Shqiptare në Maqedoni dhe Mr. Ramadan Sinani, anëtar i Kryesisë.

b) Takimi i dytë me karakter informativ, me Komisionin Amë për hapjen e Fakultetit Pedagogjik, u mbajt gjithashtu në Shkup, më 21.01.1994 (dita e premte). Ky ishte takimi i 8-të (i tetë i radhës) i Komisionit, siç u informuam nga organizatori.

I pari në këtë takim e morri fjalën dr. Masar Kodra, i cili tha se duhet t'i heqim shpresat se me pushtetin mund të arrijmë marrëveshje për themelimin e Fakultetit Pedagogjik në gjuhën shqipe. „Jam i mendimit që ta fillojmë iniciativën në mënyrë të pavarur, me krijimin e kushteve elementare dhe të bazës financiare. Mund të mbështetemi financiarisht nga shtetet e jashtme, me kusht që të jenë krijuar këto kushte – siç përmendi ai: leje nga Qeveria, Program zhvillimor, zgjedhja e Këshillit të dekanatit, dhe Plani financiar. Për çështjen e lokalit duhet të kërkojmë zgjidhje, me blerje të ndonjë objekti privat, marrjen me qira, ose të kërkohet

ndonjë zgjidhje tjetër. Jam i mendimit të shpallim hua popullore, që i përgjigjet natyrës së organizimit”, tha në fund të diskutimit të tij prof. dr. Masar Kodra.

Ky ishte takimi ynë i dytë dhe i fundit me Komisionin Amë për hapjen Fakultetit Pedagogjik në Shkup. Për të qenë më të qartë në lidhje me pikëpamjet tona, të përgatitura në formë të shkruar Komisionit Amë ia dorëzuam dokumentin me Përfundime, për qëndrimin e Kryesisë së Bashkësisë Kulturore Shqiptare në lidhje me çështjen e arsimit universitar në gjuhën shqipe, ndërsa Komisioni Amë vazhdoi edhe më tej me aktivitetet për zgjidhjen e kësaj çështje, të cilën përmes komunikatës së kryesisë të BKSH-së, të botuar më 2 mars 1994 në gazetën „Rilindja” në Tiranë, si dhe gazetën „Flaka” në Shkup, e kemi vlerësuar si më poshtë:

„E çmojmë angazhimin e singertë të deritashëm të disa intelektualëve shqiptarë në Komisionin Amë, i cili vepron në kuadër të Unionit të Inteligjencies Shqiptare në Maqedoni, që më shumë se dy vjet është angazhuar për hapjen e Fakultetit Pedagogjik në gjuhën shqipe, në kuadër të Universitetit „Shën Kirili dhe Matodi” të Shkupit. Konstatojmë se angazhimi i Komisionit të lartpërmendur mund të kuptohet si formë e mendimit të lirë dhe veprimit në jetën pluraliste. Mendojmë se angazhimi për krijimin e filialeve në gjuhën shqipe, në kuadër të institucioneve arsimore, shkencore, artistike dhe informative maqedonase, të cilat nuk kanë as sot e gjithë ditën tendencë të përshtatjes me realitetin shumëracinal, shumëkultiyor dhe shumë gjuhësor në Maqedoni, mund të jetë

vetëm shkurtpamësi me pasoja të ngulëtjes së statusit të pakicës kombëtare për popullin shqiptar në Maqedoni.”)⁷⁷

IV. Kontributi për themelimin e Universitetit të Tetovës

Profesor Masar Kodra është angazhuar që me paraqitjen publike të iniciativës për themelimin e Universitetit të Tetovës. Edhe pse ka qenë i lidhur drejtpërdrejtë me iniciativën për hapjen e Fakultetit Pedagogjik në Shkup, si anëtar i Komisionit Amë për hapjen e tij, njohja e tij me iniciativën gjatë dy takimeve të realizuara mes Komisionit Amë për hapjen e këtij fakulteti dhe përfaqësuesve të Bashkësisë Kulturore Shqiptare, sidomos pas shpalljes së komunikatës zyrtare për hapjen e këtij Universiteti dhe miratimin e Platformës për hapjen e Universitetit Shqiptar në Maqedoni,⁷⁸ profesor Masari deri në fund do t’i qëndrojë besnik këtij projekti kombëtar, duke sakrifikuar gjithçka nga vetja për jetësimin e tij.

Kështu, Kuvendi themelues i Universitetit të Tetovës, i mbajtur në Tetovë, më 4 qershor të vitit 1994, ia besoi detyrën e udhëheqjes së Komisionit për themelimin e Fakultetit Filozofik, ndërsa më vonë, me konstituimin e organeve të rregullta të Universitetit iu besua detyra e dekanit të parë të këtij fakulteti.

Më 8 janar të vitit 1995, Këshilli i Universitetit të Tetovës, në zyrat e Partisë Demokratike Popullore, e mbajti mbledhjen e nëntë të tij, në të cilën u zgjedhën organet e rregullta të universitetit dhe të

⁷⁷ Komunikata e Bashkësisë Kulturore Shqiptare, gazeta „Rilindja“, Tiranë, 2 mars 1994.

⁷⁸ Abdulla Mehmeti: „Si u lind Universiteti i Tetovës”(fejton), gazeta „Zhurnal”, Shkup, 9 janar 2014.

fakulteteve.)⁷⁹ Me këtë u pushoi mandati organeve të përkohshme të universitetit, të zgjedhura nga Kuvendi themelues i Universitetit të Tetovës, më 4 qershor 1994, ndërsa punën e mëtejme për udhëheqjen e këtij universiteti do ta kryejnë organet e reja drejtuese, të zgjedhura në mënyrë demokratike, transparente dhe me procedurë të rregullt, për aq sa u lejonin kushtet dhe mundësitë nën presionin e vazhdueshëm të organeve të pushtetit dhe të policisë.

Pas një diskutimi të gjerë, Këshilli i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 8 janar 1995, në bazë të nenit 8 të Aktit për themelimin e Universitetit, morri vendim për zgjedhjen e organeve të rregullta të Universitetit dhe të 6-të fakulteteve të tij. Rektor i parë i Universitetit të Tetovës u zgjodh prof. dr. Fadil Sulejmani, ndërsa prorektorë: prof. dr. Murtezan Ismaili dhe prof. dr. Agni Dika.)⁸⁰ Gjithashtu u zgjodhën edhe dekanët dhe prodekanët e parë, sipas fakulteteve. Dekan i parë të Fakulteti Filozofik u zgjodh prof. dr. Masar Kodra, kurse prodekanë, prof. dr. Ramiz Abdyli dhe mr. Vebi Xhemaili.)⁸¹

Më vonë, pas fillimit të punës së rregullt të universitetit, profesor Masar Kodra do të kryej shumë detyra me rëndësi në këtë universitet, në cilësi të dekanit, të anëtarit të Senatit dhe si një nga profesorët me përvojë të jashtëzakonshme të fituar në Universitetin e Prishtinës dhe në institucione të tjera shkencore.

⁷⁹ *Abdulla Mehmeti*: „Organet drejtuese dhe udhëheqësit e parë të Universitetit të Tetovës”, gazeta „Lajm”, *Shkup*, 29.06.2015, f. 7. *Shih edhe*: <http://www.pashtriku.org/?kat=60&shkrimi=4232>

⁸⁰ Në këtë mbledhje, Prorektor për Arsim u zgjodh dr. Sejfedin Haruni, i cili u detyrua të jep dorëheqje pas një kohe të shkurtë dhe kjo detyrë iu besua prof. dr. Agni Dikës, anëtar i mëparshëm e Kryesisë së përkohshme të universitetit.

⁸¹ Po aty

Përveç tjerash, u angazhua edhe për hapjen e studimeve të veçanta për Etnologji, në kuadër të këtij universiteti, për hapjen e studimeve pasuniversitare në fushën e historisë, hartimin e planeve dhe programeve moderne, të cilat edhe sollën rezultatet e tyre më vonë. Vlen të përmendet me këtë rast se, nga gjeneratat e para të studentëve të Katedrës së Historisë në Universitetin e Tetovës, kanë dalë disa doktorë dhe magjistra të shkencave, arsimtarë të dalluar të shkollave të mesme dhe fillore, si dhe dhjetëra punonjës shkencorë të dalluar me punën e tyre hulumtuese dhe kontributin e dhënë deri më sot në shkencat e historiografisë.

ZEQIRJA IDRIZI

Universiteti FON – Shkup

SHBA DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE

(Masar Kodra, Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane (1918–1945), Logos–A, Shkup, 1997)

Në vitin 1997, atëherë kur Shqipëria ishte katandisur si mos më keq dhe kur Kosova po hynte në luftën çlirimtare për liria a vdekje, në një hapësirë tjetër shqiptare, në Shkup, nga Shtëpia Botuese Logos–A, historiani e studiuesi i përkushtuar profesor Masar Kodra, nxori nga shtypi librin e veçantë dhe të munguar në bibliotekat shqiptare, me titull “*Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane (1918–1945)*”. Ky libër është një dëshmi se vlerat dalin në pah edhe në kohë e rrethana të jashtëzakonshme.

Nga titulli i librit shihet se autori trajton një çështje pak të trajtuar deri atëherë nga historiografia jonë: çështjen shqiptare në analet diplomatike amerikane në një periudhë delikate, më shumë të panjohura dhe shumë komplekse jo vetëm për shqiptarët dhe çështjen e tyre të pazgjidhur, por edhe për botën mes dy luftërave botërore. Çështjet e trajtuara në këtë libër rrokin një gamë të gjerë çështjes politike, ekonomike, diplomatike, ushtarake, kombëtare e ndër-kombëtare, të cilat autori i nxjerr në sipërfaqe nga burime të ndryshme. Disa prej çështjeve të trajtuara kanë qenë pak ose aspak të trajtuara para se të botohej ky libër. Kjo e bën këtë libër të kërkuar dhe të nevojshëm që ta kemi në raftet e bibliotekave tona.

Shikuar në rrafshin formal, katër janë “shtyllat” kryesore mbi të cilat është ngritur ky libër: *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar në opinionin publik dhe zyrtar të SHBA-ve, marrëdhëniet shqiptaro-amerikane në periudhën midis dy luftërave botërore (1929–1939), SHBA dhe Lufta Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar (1939–1943) dhe, dalja e LANÇ të Shqipërisë në suazat ndërkombëtare*. Parathënia (në shqip dhe anglisht), përfundimi, burimet dhe literatura, nënkapitujt dhe njësitë tjera e plotësojnë, i japin formën e duhur strukturës formale dhe përmbajtjesore të këtij libri.

Libri “*Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane*” nuk është thjesht një libër historie, një libër mbushur me ngjarje historike në një periudhë shumë komplekse jo vetëm për shqiptarët, por edhe për botën. Ky libër në fakt është një studim i mirëfillt shkencor për histori dhe ngjarje politike, diplomatike kombëtare dhe ndërkombëtare.

Autori, duke ju referuar burimeve diplomatike amerikane dhe opinionit publik, me anë të këtij libri sjell opinione, pikëpamje e vlerësime me vlerë për çështjen shqiptare në kontekst të rrethanave të kohës, në një kohë kur Ballkani e bota po zienin nga luftërat, në kohën kur mosmarrëveshjet politike, diplomatike, ideologjike, të sferave të ndryshme të interesit po nxirrnin në sipërfaqe çështje të vjetra të pazgjidhura, por edhe sfida gati të pakapërcyeshme mes popujve, shteteve, rajoneve e ideologjive të ndryshme. Në këtë vorbull ngjarjesh autori trajton çështje pak të njohura, siç janë raportet mes shqiptarëve dhe amerikanëve, pikërisht atëherë kur kishte aq shumë mospajtime mes lirisë dhe robërisë, mes dy botëve me ideologji, koncepte e histori krejtësisht të ndryshme, etj.

Ajo çka bie në sy gjatë leximit është se çështjet e trajtuara kanë një shtrirje më të gjerë kohore se ato që paralajmërohen në titull. Kjo është një nga të veçantat e librit. E veçanta e radhës është se këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me një pistë hulumtimi: siç është çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane. Përkundrazi, kemi të bëjmë edhe me pista tjera. E veçanta tjetër ka të bëjë me faktin se si u krijua më herët opinioni publik para atij diplomatik amerikan për çështjen shqiptare. Kjo do të thotë se çështja shqiptare fillimisht del në sipërfaqe nga opinioni publik amerikan (në gazeta e revista të kohës), pastaj gjen shtrirje, imponohet në analet e saj diplomatike. Opinioni publik brumoset, krijohet kryesisht përmes shtypit dhe gazetave (“The New York Times”, etj.), të cilat autori i përdor si burime, si referenca. Shtypi, të cilin autori i këtij libri e konsulton, e përdor si referencë gjatë përgatitjes së librit, përbën një burim të veçantë nga i cili mësojmë për çështje që në fakt janë me rëndësi historike. Dhe ato nuk janë të pakta. Mënyra se si u krijua e u formësua dhe cili ishte kontributi i mërgatës shqiptare në SHBA; se nga ishte shqiptari i parë që u vendos në SHBA më 1882, sa ishte numri i shqiptarëve të mërguar në ShBA në vitin 1912, me çfarë përkushtimi e sakrifice shqiptarët atje kishin hapur bizneset e tyre, kishin krijuar klube, shoqata e shoqëri kulturore (fillimisht “Malli i Mëmëdheut”, “Besa–Besë”, “Lidhja” e më pas “Vatra”, “Shqipëria e lirë” etj.), se si u angazhuan dhe kontribuuan ata në kohë e rrethana shumë të vështira për shqiptarët dhe çështjen e tyre të pazgjidhur, sidomos nga viti 1912 e tutje; se si do ta ngrenë lartë zërin, se si do të angazhohen në mbrojtje të çështjes shqiptare në periudhën të cilën autori e ka në fokus etj., përbëjnë disa nga shtyllat ndihmëse të katër shtyllave kryesore mbi të cilat është ndërtuar ky libër.

Siç flasin burimet e konsultuara nga autori, kontributi i mërgatës shqiptare ishte aq i madhe sa arriti gradualisht ta krijoj në njëfarë mënyre edhe opinionin publik amerikan, duke ndikuar kështu edhe te Qeveria e diplomacia amerikane që ta njohin nga afër çështjen shqiptare. Pra, të dhënat për mërgatën shqiptare dhe për mënyrën se si u krijua opinionin publik dhe diplomatik e bëjnë edhe më të plotë dhe më të veçantë para lexuesve dhe studiuesve këtë libër.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, vrasja e Mehmet Ali Pashës në Gjakovë, Kongresi i Berlinit (1878) dhe fillimi i copëtimit të tokave shqiptare, rënia nën sundimin sllav të Plavës, Gucisë, Hotit, Grudës, Ulqinit, me dakordim dhe insistim të Fuqive të Mëdha; përpjekjet dhe luftërat e popullit shqiptar për t'u dalë zot trojeve të tyre që, fatkeqësisht rezultuan pa sukses për një kohë etj., kishin zënë vend në shtypin dhe opinionin amerikan. Dhe ishte shtypi ai i pari që e kishte trasuar rrugën që edhe diplomacia amerikane më vonë të njihej nga afër me çështjen shqiptare. Librin e pasurojnë edhe të dhënat që sjell autori lidhur me kontributin, angazhimin dhe rolin e intelektualëve, si Faik Konica, Fan Noli, Kostë Çerkezi, Petro Nini Luarasi, Sotir Peci, Kristo Dako etj., për çështjen kombëtare. Krijimi i shoqatave, klubeve etj.; botimi i gazetave dhe revistave të kohës ("Kombi", "Dielli" etj.) do të ndikojnë në dobi të çështjes shqiptare dhe në luftë kundër propagandës sllavo-grek në copëtimin e trojeve shqiptare etj. Dhe ky fakt përbën një të veçantë shtesë për librin. Mirëpo, kjo nuk ishte e tëra, sepse libri vjen duke u pasuruar edhe me të dhëna që kanë të bëjnë me qëndrimin që merr SHBA në raport me Shqipërinë dhe çështjen shqiptare në një periudhë të deklaruar në titull. Siç mund të vërehet gjatë leximit të librit, SHBA deri vonë nuk kishte treguar ndonjë interesim të posaçëm, aq më tepër ndonjë mbështetje politike a diplomatike. Do të

kaloi kohë deri sa Qeveria e SHBA të shfaq interesimin për çështjen shqiptare. Interesimi shtohet, vjen duke u artikuluar, duke u qartësuar tek në mes të LDB. Pra, ai ishte një proces i gjatë që evoluoi shumë ngadalë. Faktet, raportet, dokumentet, referencat flasin se qëndrimi amerikan, sidomos në fazat fillestare, nuk ishte pozitiv. Se SHBA kishte qëndrim negativ po i referohemi vetëm Kongresit të Lushnjës, pas të cilit Shqipëria nis konsolidimin e vet si shtet. Dhe pikërisht atëherë kur Shqipëria kishte nevojë aq të madhe për përkrahje, me insistim të një senatori (senatori Loxh), që ishte kundërshtar i presidentit Uilson, aprovohet në Senat një Rezolutë, ku kërkohej që Korça dhe Gjirokastra t'i bashkoheshin Greqisë. Ky është një shembull, por jo i vetmi. Megjithatë, nuk vonoi (më 1922) edhe u arrit marrëveshje dy palësh për hulumtim dhe shfrytëzim të naftës, për çka amerikanët kërkojnë që të gëzojnë privilegjin e të qenit vendi i parë më i privilegjuar në këtë aspekt.

Mosmarrëveshjet pozitive—opozite, vrasja e Avni Rustemit e përgatitur me sa duket nga Ahmet Zogu, vrasja e dy turistëve amerikanë në afërsi të Mamurasit nga agjendë të Zogut, etj., ndikoi shumë në ftohjen e marrëdhënieve diplomatike mes dy vende, sa njeriu i parë i Legatës së SHBA në Tiranë deklaroi se kjo ngjarje e ka kthyer Shqipërinë “një mijë vjet pas në sytë e botës”. Madje ai edhe këshillonte Departamentin e Shtetit që të vendoste në një port detar të Shqipërisë një anije luftarake për të ruajtur lidhjet me Shqipërinë etj. (f. 50–51). Si rezultat i kësaj ideje, kësaj kërkesë, në qershor 1924, në portin detar u vendosën dy anije: “Balmers” dhe “Edsol”. Me ndryshimin e rrjedhës së ngjarjeve, me ç’rast Noli e rrëzoi Ahmet Zogun nga qeveria dhe qeverinë e mori ai, ndikoi që anijet të largohen. Ardha e Nolit në krye të qeverisë, fillimisht u prit mirë nga përfaqësuesit e diplomacisë së SHBA në Tiranë, mirëpo ata nuk

e njohën zyrtarisht qeverinë e tij përkundër kërkesave të Nolit. Këto i kanë rënë në sy, nuk i kanë shpëtuar autorit gjatë hulumtimit dhe përgatitjes së librit, të cilave u ka bërë vend në faqet e tij. Ndryshimi i rrjedhës së ngjarjeve dhe rrethanave politike ndodhi pas rrëzimit të Qeverisë Noli nga Ahmet Zogu me ndihmën e Beogradit. Kjo mbase ishte një ngjarje e papritur e radhës për diplomacinë amerikane. Në kohën kur edhe shpresohet të njihet qeveria e re, ajo nuk ndodhi. Njëra nga arsyet ishte se Zogu po bënte aq shumë koncesione me Italinë. Edhe pse nuk pati njohje të Qeverisë dhe regjimit të ri, megjithatë pati sado pak përmirësim të këtyre marrëdhënieve, sidomos pas momentit kur Zogu gjoja e bindi parlamentin që në vitin 1925 t'i jepeshin kompanisë amerikane: "Standard Oil" 45 mijë hektarë koncesione në veri të Vlorës. Ky fakt sikur ndikoi në relaksimin sado pak të këtyre marrëdhënieve, intensiteti i të cilave u shtua pasi që Faik Konica emërohet përfaqësues i Shqipërisë në SHBA nga Zogu dhe pasi që marrëdhëniet u ngritën nga rang konsullate në Legatë. Hapja e degës së Kryqit të Kuq, përmes saj edhe hapja e enteve shëndetësore, dispanserive, qendrave shëndetësore dhe spitaleve etj.; hapja e shkollës së mesme teknike dhe asaj bujqësore, flet për një shtim të interimit amerikan dhe një "relaksim" marrëdhëniesh. Mirëpo, kjo nuk zgjati shumë, sepse më 1933 këto shkolla u mbyllën pasi këtë e kishte kërkuar me ngulm Italia nga Zogu. Një fakt i tillë nxjerr në sipërfaqe një çështje tjetër, të cilën autori e ka evidentuar: shtimin e ndikimit të madh italian në Shqipëri dhe ftohja me atë amerikane etj. Përkundër këtyre, me kalimin e kohës, prania e SHBA në Shqipëri, nga rrafshi humanitar, arsimor, ekonomik etj., kalon në atë politik dhe diplomatik.

Duke iu referuar të dhënave që sjell ky libër, mund të themi pa hezitim se autori i trajton raportet shqiptaro-amerikane në disa aspekte: humanitare, arsimore, ekonomike, sociale, politike e diplomatike. Në ndonjë rast autori përmend disa nga faktorët që ndikuan në ngritjen e rënien e marrëdhënieve mes këtyre dy vendeve. Autori nuk len pa përmendur edhe faktin se si në kohë e rrethana të caktuara bie në sy njëfarë indiference e paarsyeshme, madje absurde e paradoksale amerikane në raport me Shqipërinë në momentet më kritike për Shtetin Shqiptar. Shembull konkret kemi pushtimin e Shqipërisë nga Italia, të cilën SHBA-të e shikuan me indiferencë të tillë, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. I ndryshëm nga qëndrimi indiferent diplomatik i SHBA ndaj agresionit të Italisë mbi Shqipërinë, ishte qëndrimi dhe opinionioni publik amerikan i shfaqur nëpërmjet shtypit. Pra, opinionioni publik e dënoi agresionin italian në Shqipëri. Edhe pse SHBA gjatë LDB ndoqën me vëmendje dhe interesim të veçantë çështjen shqiptare dhe luftën e tyre të armatosur kundër nazifashizmit, autori këtij libri vjen në një përfundim se: "...qarqet zyrtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e shihnin çështjen shqiptare si problem periferik" (f. 88).

Çështja e radhës që bie në sy këtu është sjellja shpesh (sidomos gjatë LDB) e pakoordinuar e mërgatës shqiptare në Amerikë. Veprimet e tyre nuk ishin shpesh në përputhje me rrethanat dhe kohën. Pra, autori, duke iu referuar dhjetëra letrave, kërkesave, deklaratave, memorandumeve të individëve, intelektualëve, grupeve, shoqatave e organizatave drejtuar në adresë të Qeverisë së SHBA për ta dënuar agresionin italian në Shqipëri dhe për ta vlerësuar luftën e popullit shqiptar, nxjerr në sipërfaqe edhe një të vërtetë: se vetë shqiptarët nuk ishin unik në qëndrimin e tyre. Për të qenë paradoksi më i madh, në njërën anë kërkonin përkrahja nga Qeveria

amerikane, në anën tjetër vet nuk po gjenin rrugë e mënyra veprimi të përbashkët dhe unik. Qëndrim hiç më të koordinuar nuk kishin as intelektualët: Noli, Konica, Zavalani etj. Megjithatë, deklarimi i SHBA (më 1942) se “nuk njohim asnjë pretendim të imperializmit italian në Shqipëri dhe se dëshirojmë të shohim riven-dosjen e pavarësisë së Shqipërisë” (f. 98), gjë që shkaktoi pakënaqësi dhe reagim të ashpër të Greqisë, konsideroj se është rezultat edhe i përpjekjeve të mërgatës.

Me anë të këtij libri autori jo vetëm që na sjell informacione me rëndësi për pikëpamjet e mërgatës, intelektualëve, qeverisë së SHBA, e shtypit dhe opinionit të saj kohe për gjendjen faktike dhe shumë komplekse nëpër të cilat kaloi Shqipëria dhe shqiptarët, por edhe mund të hap debat në të ardhmen në qarqet shkencore, akademike, politike dhe diplomatike, të historianëve dhe historiografisë. Autori, me anë të këtij libri, gjithnjë duke u bazuar në burime amerikane, ndër të tjera sjell të dhëna me rëndësi edhe për çështje arsimore, financiare, tregtare, industriale, minerale, të infrastrukturës rrugore të Shqipërisë nën pushtimin italian; sjell të dhëna me rëndësi edhe për prezencën ushtarake italiane, për faktin se kur, ku dhe në çfarë gjendje ishin forcat italiane; kazernat, numri i ushtarëve; kush me kë bashkëpunonte etj.

Libri sjell opinione, pikëpamje, vlerësime, analiza me rëndësi jo vetëm për raportet shqiptaro-amerikane, por edhe për çështje shumë më komplekse në botë në periudhën mes dy luftërave botërore.

Nuk mund të mohohet fakti se edhe gjatë LDB faktori shqiptar, si brenda dhe jashtë vendi, ishte i fragmentarizuar. Këtë fakt të pamohuar e gjejmë edhe në faqet e këtij libri. Se ishte kështu mjafton të përmendim shtypi e kohës. Krahu “nacionalist” dhe i bashkëpunëtorëve nazifashist kishte gazetën: “Mbrojtja kombëtare” dhe

“Atdheu”, kurse “Bashkimi” dhe “Zëri i popullit” ishin organe të Frontit Nacionalçlirimtar dhe Partisë Komuniste, ndryshe nga organet e Ballit Kombëtar dhe Legalitetit. Për të qenë më bindës, më argumentues për përçarjet dhe grupimet e shqiptarëve në kohë e rrethana shumë të vështira gjatë luftës antifashiste nacionalçlirimtare, autori i referohet një burimi interesant, një raporti të korrikut 1944, të një farë Merkahni. Sipas tij, populli shqiptar atë kohë ishte i ndarë në pesë grupe politike: partizanët, ballistët, zogistët e A. Kupa, kosovarët dhe qeveria kuislinge etj. (f.172). Se kush me kë bashkëpunoi, se kush ishte më pak apo më shumë faktorë, kush kishte më shumë a po më pak të drejtë, se kush ishte pozicionuar në anën e fituesve dhe kush të humbësve të luftës së Dytë Botërore, kjo nuk është një çështje aq e thjeshtë për t’u zbërthyer, megjithatë nuk mbetet mister. Autori, si studiues i rryer nuk merr anë, por sjell argumente, fakte të pamohueshme, citon burime të pakontestueshme, nga të cilat edhe mund të krijohet një bindje, një opinion më i qartë se kush kishte e kush nuk kishte të drejtë.

Gjatë leximit të këtij libri ka raste kur ndeshesh me disa të dhëna që të tronditin, që të duken të padrejta, madje edhe paradoksale sa i përket qëndrimit të SHBA ndaj Shqipërisë. E para, ka të bëjë me pushtimin e Shqipërisë nga Italia dhe qëndrimi indiferent i SHBA, Anglisë dhe disa vendeve të tjera në raporte me këtë pushtim dhe mungesa e përkrahjes ose së paku solidarizimit me Shqipërinë. E dyta, ka të bëjë me deklarimin sa absurd po aq edhe jo korrekt të një pjesë të anëtarëve të Bllokut antifashist lidhur me sukseset e LANÇ në Shqipëri gjatë luftës. Pra, absurdi qëndron në faktin se si: *“Sukseset e LANÇ në Shqipëri shqetësuan Komandën e Përgjithshme Anglo–Amerikane të Mesdheut. Prandaj, gjenerali Uilson kërkoi nga komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ,*

që njësitet partizane të ndërprisnin operacionet ushtarake në pjesën veriore të Shqipërisë...” (f. 179). Ky fakt, kjo e dhënë e shton edhe më shumë përmasën e absurdit e tragjikës me të cilën u ballafaquan popujt çlirimtarë, pra edhe shqiptarët, gjatë LDB dhe gjatë historisë. Pra, vlera e librit vetëm sa shumëfishohet, sepse nuk flet thjeshtë vetëm për marrëdhëniet shqiptaro-amerikane, por edhe për shumë padrejtësi, shumë paradokse, situata absurde që i përcjellin këto marrëdhënie, por edhe luftën e popujve për çlirim kundër nazi-fashizmit.

Një çështje kruciale që ka zënë vend në faqet e këtij libri janë edhe raportet e SHBA-ve dhe perëndimit me Qeverinë e Shqipërisë në krye me Enver Hoxhën. Me gjithë përpjekjet e Qeverisë shqiptare, me gjithë kontributin e mërgatës shqiptare në botë, sidomos asaj në SHBA, veçanërisht të personaliteteve si Noli, Zavalani etj., Shteti shqiptar as nuk do të njihet si shtet, as nuk do të vendosen marrëdhënie me SHBA, Anglinë dhe botën perëndimore. Arsyet kryesore ishin të natyrës ideologjike. Pra, kemi të bëjmë me një “shtrëngatë diplomatike” kundër Qeverisë së Enver Hoxhës dhe shtetit shqiptar, gjë që e brengosi shumë mërgatën shqiptare. Jo vetëm kaq, por “*qarqet diplomatike të SHBA dhe Anglisë, menjëherë pas çlirimit të Shqipërisë organizuan fushatë propaganduese kundër regjimit të ri në Shqipëri, me qëllim që Qeveria e Tiranës të mos siguronte njohje ndërkombëtare*” (f.209).

Konsideroj se ky libër do të jetë një burim shumë i rëndësishëm, një referencë e pa kaluar për të gjithë ata që do të merren me shqiptarët në Amerikë, me rolin e mërgatës atje, por edhe me ndriçimin e raporteve mes dy popujve, mes dy shteteve (Shqipërisë dhe SHBA-ve), duke filluar nga Rilindja Kombëtare Shqiptare.

MIXHAIT POLLOZHANI

Universiteti i Tetovës

MASAR KODRA, PUBLICIST DHE GAZETAR

Shumë intelektualë dhe studiues të shquar aktivitetin e tyre profesional e kanë filluar si gazetarë, si dhe duke e lëvruar edhe veprimtarinë publicistike, të cilën e kanë prezantuar nëpërmjet faqeve të shtypit të përditshëm si dhe të atij periodik. Këtë rrugë të ndërtimit të tij profesional e pat ndjek edhe prof. dr. Masar Kodra.

Dy janë arsytet pse unë e zgjedha këtë këndvështrim për të ndriçuar figurën e këtij personaliteti të rëndësishëm të historiografisë shqiptare. Arsyeja e parë ka të bëjë me faktin se me profesorin e ndjerë na lidh profesioni i gazetarit. Ndërsa, arsyeja e dytë, dhe njëherësh më vendimtarja lidhet me kontributin e Masar Kodrës që e ka dhënë në zhvillimin dhe konsolidimin e gazetarisë dhe publicistikës, si një shtyllë shumë e rëndësishme e shoqërisë shqiptare në Maqedoni dhe më gjerë. Me anë të veprimtarisë së tij publicistike dhe gazetareske ai njëkohësisht paralajmëroi edhe përcaktimin dhe angazhimin e tij vetëmohues në hulumtimin shkencorë në fushën e historisë. Dhe pa e harruar këtu edhe aktivitetin e tij si mësimdhënës le të shërbejë kjo kumtesë si një plotësim i mozaikut të portretit të profesorit të ndjerë.

Duke qenë e pamundur që të përfshihet e tërë veprimtaria e tij publicistike e publikuar në faqet e shtypit ditor dhe atij periodik të kohës në gjuhën shqipe, por jo vetëm, për arsye objektive, u përcaktuam që kryesisht të përqendrohemi te veprimtaria e tij pu-

blicistike në gazetën “Flaka e Vëllazërimit”, e cila për dekada me radhë ishte e vetmja që botohej në gjuhën shqipe në Maqedoni.

Shikuar nga ajo që mund të shfletohet nga faqet e shtypit, mund të theksohet se kontributi i Kodrës është zhvilluar në dy plane. Në planin gazetarisë, që nënkupton punën e tij si gazetar aktiv, duke qenë i punësuar në gazetën “Flaka”⁸², e cila asokohe quhej “Flaka e Vëllazërimit” që dille tri herë në javë. Në gazetën “Flaka”, Kodra ka punuar nga viti 1960 dhe ka vazhduar punën deri në vitin 1966, dhe se për një kohë aty ka ushtruar edhe detyrën e redaktorit. Gjatë punës si gazetarë ai paralelisht ka kultivuar edhe gazetarinë informative edhe atë hulumtuese. Materialet e shumta të publikuar nëpër faqet e “Flakës” dëshmojnë se, Kodra ka trajtuar tema nga fusha të ndryshme, ku veçanërisht bie në sy reportazhet e shumtë me tematikë të ndryshme.

Por edhe pasi lëshoi gazetën “Flaka” dhe pushoi të merret me gazetari aktive, për tu punësuar në Institutin Historisë Nacionale në Shkup⁸³, Masar Kodra, megjithatë, nuk e ndaloi veprimtarinë e tij publicistike. Gjatë dekadave në vazhdim, artikuj dhe fejtone të shumtë nëpër faqet e “Flakës” spikasin me informacione shumë të rëndësishme nga fusha e historisë kombëtare dhe të asaj ndër-kombëtare. Për të pasqyruar në mënyrë sa më adekuate veprimtarinë e pasur publicistike të tij, do të veçonim disa artikuj, kumtesa, dosje dhe fejtone, të cilët nxjerrin në pah qasjen dhe qëndrimin shkencor të këtij studiuesi ndaj historisë shqiptare përballë proceseve ndërkombëtare, të cilët u zhvilluan që nga fundi i shekullit XIX dhe gjatë tërë gjysmës së parë të shekullit XX.

⁸² Dervishi, Nebi, Prof. dr. Masar Kodra - historian, studiues, vizionar, themelues dhe kryetar i parë i Shoqatës së historianëve shqiptarë në Maqedoni, Kërkime historike. - Nr. 4, 2011, f. 329-332.

⁸³ Po aty.

Si rrjedhjë e meditimeve dhe hulumtimeve shkencore rezultuan më shumë publikime publicistike, sidomos kah fundi i viteve 60 – ta dhe gjatë viteve 70 – ta të shekullit të kaluar, ku duhet veçuar disa nga ato nëpërmjet të cilave Masar Kodra ka shprehur jo vetëm qëndrimet e tij shkencore, por edhe përcaktimet politike të cilat kanë qenë të përafërta me ideologjinë komuniste. Edhe pse vëllai i tij Xhaferr Kodra⁸⁴, një funksionar i Partisë Komuniste të Maqedonisë burgoset dhe shkatërrohet po nga kjo parti, Masari nuk pushoi ti ushqejë simpatitë të tij ndaj kësaj ideologjie.

Me anë të veprimtarisë publicistike të tij, Kodra e paralajmëroi interesisht shkencor të studimit të rrethanave në të cilat u gjetën dhe u zhvilluan proceset për avancimin e të drejtat dhe çlirimin kombëtar të shqiptarëve. Këto pikëpamje ishin ato që e motivuan Kodrën për t’iu përkushtuar më me zell sidomos studimit të organizimit dhe rolit të Partisë Komuniste në avancimin e të drejtave të popullit shqiptar në planin mbarëkombëtar, dhe sidomos me theks të veçantë të çështjes së shqiptarëve në Maqedoni. Tërë ato publikime publicistike janë rezultat i hulumtimeve të pareshtura të tij shkencore dedikuar një shtrese më të gjerë lexuesish, të cilët jo njëherë patën dëshmuar se ishin tejet të etur për të ditur më shumë për historinë e tyre kombëtare. Kodra këtë e bënte njafat mirë duke dëshmuar kështu edhe prirjet dhe talentin e tij në trajtimin e temave aq të rëndësishme, qoftë për domethënien e tyre shkencore, por edhe për ndjeshmërinë ideologjike që e impononte regjimi një

⁸⁴ Македонска енциклопедија, МАНУ, Скопје, 2009, стр. 707: Xhafer Kodra, si komesar politik i Brigadës së IV Maqedonase - Shqiptare, në vitin 1951 emërohet Ministër i Punës dhe më pastaj kalon në postin Ministër i Drejtësisë në Qeverinë e Republikës Socialiste të Maqedonisë. Pastaj, gjatë viteve në vijim vazhduan represaliet ndaj tij nga ana e Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Ashtu që fund të vitit 1951 pasi shpallet “informbyroist” Xhaferi dënohet me 16 vjet me burg të rëndë në Goli Otok, nga ku për shkak shëndetësorë lëshohet në vitin 1960.

partiak i cili dominonte asokohe në Federatën e Jugosllavisë komuniste.

Përpjekjet e vazhdueshme për çlirimin dhe afirmimin që kanë bërë breza të shumtë të popullit shqiptar, Masar Kodra i ka trajtuar si pjesë e pandarë e proceseve politike të komunizmit si ideologjia fitimtare përballë nazifashizmit. Këtë qëndrim shkencor, autori e shpreh në artikullin: “Revolucioni Socialist i Tetorit dhe Fan Noli”, ku njëherësh ai thekson edhe përcaktimet politike komuniste të njerit ndër figurat më të rëndësishme të popullit shqiptarë, Fan Stelian Noli⁸⁵. Përmbysja e Revolucionit Demokratik Borgjez të Qershorit në fund të vitit 1924 në Shqipëri nga ana e Ahmet Zogut, bëri që, për të shpëtuar kokën pjesëtarë të shumtë të forcave demokratike shqiptare e braktisën vendin dhe shkuan në mërgim ku edhe e vazhduan veprimtarinë dhe luftën e tyre. Ndërkaq, si një ndër veprimtarët më të dalluar, autori e ka veçuar figurën e Fan Nolit, i cili ka udhëhequr me organizatën KONARE (Komiteti Nacional – Revolucionar), e formuar në vitin 1925 në Vjenë të Austrisë. Kodra ka potencuar faktin se, kjo organizatë që pat marrë mbi supe përmbysjen e regjimit të monarkisë, ka bashkëpunuar edhe me Federatën Ballkanike, ku edhe afrohet me forcat tjera progresive të popujve tjerë ballkanik, bëhet pjesëtare aktive e Komitetit Ballanik, anëtare e së cilës ka qenë edhe organizata maqedonase VMRO (Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – E bashkuar). Veprimtaria e këtij komiteti konsiston edhe me shënimin e dhjetëvjetorit të Revolucionit Socialist të Tetorit dhe Kongresit të Miqve të Bashkimit Sovjetik që u mbajt në vitin 1927 në Moskë.

⁸⁵ Kodra, Masar, “Revolucioni Socialist i Tetorit dhe Fan Noli”, Flaka e Vëllazërimit, 12 tetor, 1967.

Komiteti ballkanik në këtë jubile dhe Kongres është përfaqësuar nga KONARE me përfaqësues: Fan Noli, Konstantin Boshnjaku dhe më vonë edhe Llazar Fundo, kurse nga Komiteti nacional i Kosovës përfaqësohej nga Bedri Pejani dhe Ibrahim Gjakova. Komiteti qendror i VMRO – së: Dimitar Vllahovi, Gjorgji Vankov dhe Pavel Shatev. Të gjithë këta veprimtarë kishin marrë pjesë krahë për krah në manifestimin qendror kushtuar përvjetorit jubilar të Revolucionit të Tetorit. Ndërkaq në Kongresin e miqve të BRSS-së kishte marrë fjalën edhe Fan Noli i cili ndër të tjera është shprehur: “... Bashkimi Sovjetik si shteti i parë i punëtorëve dhe i fshatarëve në botë është shpresa më e madhe e të gjithë atyre që luftojnë për çlirimin nacional e social...”.

Orientimet e tij komuniste, Kodra i ka shprehur pothuajse edhe në më shumë artikuj tjerë publicistik, dhe se këtë e bënë edhe tek artikulli: “Jehona ngjarjeve revolucionare dhe e vdekjes së Leninit te populli shqiptar”, i botuar në dy vazhdime, ku në qendër të vëmendjes ka vënë disa nga ndodhitë më të rëndësishme të asaj kohe. Por megjithatë, vëmendja e autorit është përqendruar te dy ngjarje, te revolucionin socialist dhe vdekja e liderit komunist sovjetik, Vlladimir Iliç – Lenin⁸⁶. Duke e shfrytëzuar shtypin në gjuhen shqipe, i cili asokohe botohej nëpër vende të ndryshme të Evropës, Amerikës, Azisë dhe Afrikës, Kodra, jep një pasqyrë të ndikimit që Revolucionin Socialist pati te populli shqiptarë. Informacionet mbi Revolucionin Socialist të Tetorit, shqiptarët i gjenin te gazeta e kohës “Posta e Shqipnies” e cila botohej në Shkodër. Ajo që po ndodhte në Rusinë Cariste, konstaton autori, jo vetëm që i trembnin shtetet e mëdha imperialiste dhe borgjezinë e tyre, por e tron-

⁸⁶ Kodra, Masar, “Jehona ngjarjeve revolucionare dhe e vdekjes së Leninit te populli shqiptar” I dhe II, Flaka e Vëllazërimit, 25 kallnor dhe 1 fror, 1968.

diti njëherësh edhe sistemin feudalo – borgjez shqiptar i cili e mbante në dorë tërë pushtetin dhe pasurinë e vendit. Populli shqiptar kishte kuptuar njaftë mirë gjendjen e mjeruar të tij, ndaj dhe i ndikuar nga revolucioni në fjalë kishte ndërmarrë formimin e një numri të konsiderueshëm organizatash dhe klubesh politike për organizimin e një lëvizje gjithëpërfshirëse demokratike. Për ti ndërlidhur ngjarjet e kohës së lëvizjes demokratike në Shqipëri, të cilat ishin të ndikuara drejtpërdrejtë nga Revolucioni Socialist, por që konsiston edhe me vdekjen e Leninit në vitin 1923, Masar Kodra ka cituar një artikull të gazetës “Politika”: “Jo për Leninin si politikan botëror e revolucionarin më të madh të shekujve, por për Leninin, politika e së cilit i përket Shqiptarisë, i përket popullit tonë të vogël e të lodhur nga luftërat e tij prej shekujsh”.

Në mënyrë akoma më të argumentuar pikëpamjet e tij rreth ideologjisë komuniste ndaj çështjes shqiptare, i shpreh sidomos në fejonin prej 17 vazhdimesh të botuar në viti 1996 në të përditshme “Flaka” me titull: “Lufta Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar (1939 – 1943)”⁸⁷. Fejtoni në fjalë i cili është një version shumë më i shkurtër i librit: “Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane (1918 – 1945)”⁸⁸ i cili përmbante dokumente të panjohura deri atëherë për lexuesin shqiptarë. Në fejonin e tij autori i interpreton disa nga informacionet që i përmbajnë dokumentet amerikane mbi Partinë Komuniste Jugosllave. Një pjesë të këtyre të dhënave i sjellë dr. Heket, anëtari i Fondacionit të Rokfelerit, në raportin e tij të hartuar për ambasadën të SHBA-ve gjatë një vizite disaditëshe në Shqipëri. Në këtë raport vihet në pah sidomos qëndrimi i adminis-

⁸⁷ Kodra, Masar, “Lufta Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar (1939 – 1943)”, “Flaka e Vëllazërimit”, 16 shkurt – 1 mars, 1998.

⁸⁸ Kodra, Masar, “Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane (1918 – 1945)”, Shkup, 1997.

tratës amerikane ndaj gjendjes së shqiptarëve. Në lidhje me këtë publikim, duhet përkujtuar se studiuesi Kodra, një hapësirë të duhur u ka kushtuar edhe përpjekjeve kundërthënëse të mërgatës shqiptare në SHBA nga njëra anë, dhe, të shkrimtarëve dhe veprimtarëve të shquar të çështjes kombëtare, përfshirë këtu dy emrat tejet të rëndësishëm kombëtare, Faik Konica dhe Fan Noli, nga an tjetër, për fatin e Shqipërisë dhe kombit shqiptar.

Gjithashtu duhet përmendur edhe kontribute tjera shkencore kështu historisë më të re të shqiptarëve në Maqedoni. Si rrjedhojë, me rastin e 25 vjetorit të formimit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Maqedonisë, Kodra ka botuar një artikull të titulluar: “Njëzetepesë vjet nga formimi i KQ të PK të Maqedonisë” ku ka pasqyruar rrethanat e krijimit të organit më të lartë të kësaj partie⁸⁹. Një vend të posaçëm aty zë letra qarkore e komunistit serb, Svetozar Vukmanoviç-Tempo, drejtuar komunistëve dhe organizatave partiake të Maqedonisë. Nëpërmjet kësaj letre, Tempo, në emër të KQ të PKJ-së, u bënë thirrje komunisteve maqedonas që të tubohen rreth udhëheqjes së re të KQ të PKM-së. Autori gjithashtu ka numëruar një varg ngjarjesh tjera të rëndësishme që kanë ndikuar në formimin e KQ të PKJ-së. Ka vënë në pah se KQ i PKM – së nuk është formuar në prill por në muajin shkurt, kurse në 19 mars është mbajtur një mbledhje konsultative e tij në Tetovë, ku është trajtuar gjendja partiake në terren.

Spektrit të gjerë publicistik të Masar Kodrës nuk i kanë munguar as edhe temat që kanë të bëjnë me periudhat dhe proceset tjera të lëvizjes kombëtare shqiptare. Në një mënyrë gjithëpërfshirëse i është qasur edhe fazës së fundit të sundimit të Perandorisë Osmane

⁸⁹ Kodra, Masar, “Njëzetepesë vjet nga formimi i KQ të PK të Maqedonisë”, Flaka, 15 fror, 1968.

në vendet ballkanike, dhe sidomos në trojet shqiptare⁹⁰, në artikullin: “Revolucioni i Xhonturqve dhe pjesëmarrja e shqiptarëve në te”. Duke e ndërlidhur daljen në sipërfaqe të elementit të ri të borgjezisë nacionale turke, e cila formoi shoqërinë “Osmanlinjtë e Rinj” në vitin 1865 në Stamboll, erdhën në konfrontim me forcat feudale të absolutizmit të sulltanit, gjë që në vitin 1867 e detyruan regjimin perandorak për ta pranuar rendin kushtetues parlamentar. Edhe pse ky regjim mbijetoi vetëm një vit, pasi që Sulltan Hamidi II e shtypi me gjak lëvizjen reformatore, megjithatë idetë liberale nuk pushuan që ti ushqejnë xhonturqit. Kjo lëvizje në vitin 1892 themeloi Shoqërinë “İtihat ve Terakati” (Bashkim dhe Përparim), nga e cila më vonë rezultoi edhe themelimi i partisë me të njëjtin emër “Bashkim – Përparim”: Njëri nga dy themeluesit e saj ka qenë edhe Ibrahim Temo. Në këtë artikull, Kodra ka vënë në pah karakterin shumëkombësh të asaj lëvizjeje ku kanë marrë pjesë: shqiptarët, armenët, maqedonasit dhe arabët. Ndër aktivistët e shquar ka qenë edhe Ismail Qemali, i cili në Kongresin e asaj partie ka kërkuar që përfaqësuesit e kombësive të pranohen si grupe kombëtare. Fryma liberale dhe karakteri shumetnik i asaj lëvizjeje ka joshur shqiptarët që të bëhen pjesë aktive e atij procesi duke e themeluar në vitin 1908 klubet nëpër shumë rajone të trojeve shqiptare. Fryma e lëvizjes së xhonturqve çoi deri tek kryengritja e Garnizonit ushtarak të Resnjës i udhëhequr nga komandanti shqiptar i Garnizonit ushtarak, Nijazi Ahmet Beu, duke e refuzuar praninë e pushtetit suprem të sulltanit. Kjo kryengritje dhe shumë aktivitete tjera revolucionare çuan më 23 korrik të vitit 1908 deri te shpallja e

⁹⁰ Kodra, Masar, “Revolucioni i Xhonturqve dhe pjesëmarrja e shqiptarëve në te”, I dhe II, Flaka e Vëllazërimit, 13 dhe 20 korrik, 1967. 10 Kodra, Masar, “28 Nëntorit – Dita e Pavarësisë së Popullit Shqiptarë” (marrë nga artikulli në dorëshkrim me të njëjtin titull).

Hyrijetit në Selanik dhe Manastir. Një ditë më vonë këtë kushtetutë e njohu edhe vetë Sulltani. Pra, Kodra, si përfundim ka konsultuar se shqiptarët kanë luajtur rol të madh në revolucionin xhon-turk, duke marrë pjesë në organet drejtuese të revolucionit dhe në njësitë ushtarake që e organizuan kryengritjen.

Me rastin e shënimit të 58 vjetorit të festës së 28 Nëntorit, në me titull “28 Nëntorit – Dita e Pavarësisë së Popullit Shqiptarë”, Masar Kodra në mënyrë kronologjike ka pasqyruar disa nga ngjarjet më të rëndësishme që çuan deri te shpallja e Pavarësisë së Shtetit Shqiptar. Duke u ndalur te Kongresi i Manastirit i cili u mbajt në vitin 1908 në po të njëjtin qytet, i njohur ndryshe edhe si Kongresi i Alfabetit; ai gjithashtu, ka potencuar rolin e shtypit të emigracionit shqiptar që botohej nëpër qendra të ndryshme evropiane si dhe ndikimin e zhvillimeve të proceseve të udhëhequra nga lëvizja e “osmanlinjve të rinj” për të dalë te rrethanat, gjatë dhe pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Një qasje kritike autori mban sidomos ndaj shteteve fqinjëve dhe atyre që u deklaruan si aleat të shqiptarëve.

Me siguri që ka edhe shumë materiale tjera të rëndësishme të publistikës së këtij studiuesi të devotshëm. Në pamundësi që nëpërmjet kësaj kumtese të përfshihet tërë kontributi i tij, si përfundim mund të konstatohet se veprimtaria e gjerë gazetareske dhe publistike i shërbeu prof. dr. Masar Kodrës, për afirmimin e çështjes kombëtare shqiptare, kurse lexuesit të gjerë shqiptar për t’u njohur me një pjesë të historisë së kombit të tij.

BANUSH MORINA

Instituti Albanologjik i Prishtinës

KONTRIBUTI I PROF. DR. MASAR KODRA NË PERIODIKUN SHKENCOR TË KOSOVËS

Në vargun e sukseseve të arritura në fushën e shkencave albanologjike, një vend të rëndësishëm zë edhe zhvillimi i shkencës së historiografisë.

Në këtë 85-vjetor të lindjes së prof. dr Masar Kodrës, historiografia shqiptare në të dy anët e territorit shqiptarë, e mbështetur në rezultatet e pakontestueshme të dijes, shquhet si shkencë e organizuar dhe e përparuar, me specialistë të të gjitha periudhave historike, me institucione shkencore në nivel kombëtar, që në pesë deceniet e fundit me kompetencë kanë thënë fjalën e tyre për problemet e nduarnduarta të historisë së popullit shqiptarë në përgjithësi, e që shpesh binte ndesh me historitë zyrtare të popujve fqinjë të Ballkanit, në veçanti.

Pa mëdyshje mund të thuhet se shkenca e historiografisë shqiptare për Luftën e Dytë Botërore në territoret shqiptare në Kosovë, lindi si shkencë serioze vetëm pas hapjes së *Universitetit të Prishtinës* dhe u zhvillua në kuptimin e plotë të fjalës me rritjen e *Institutit të Historisë së Kosovës, Fakultetit Filozofik–Departamentit të Historisë së UP–së, Institutit Albanologjik të Prishtinës–Dega e Historisë, Muzeut të Kosovës, Arkivit Shtetëror të Kosovës, ASHAK, etj.*

Zhvillimi i mëtejshëm në zgjerimin e veprimtarisë shkencore në fushën e problemeve historike, masovizimi i shkencës dhe rritja e veprimtarisë botuese, diktoi domosdonë e ngritjes së revistave

shkencore, siç ishin: **“Kosova”** – organ i Institutit të Historisë të Kosovës, **“Gjurmime albanologjike”** – Seria e Shkencave Historike – organ i Institutit Albanologjik të Prishtinës, **“Vjetari i Arkivit të Kosovës”** – Organ i Arkivit Shtetëror të Kosovës, **“Buletini i Muzeut të Kosovës”** – Organ i Muzeut të Kosovës, **“Studime”** e ASSHA të Kosovës, **“Horizontet e Historisë”** – Lidhja e Shoqatave të Historianëve të Kosovës, **“Përparimi”**, etj.

Të gjitha këto revista shkencore, prestigjioze për kohën, ishin tribunalet më të kualifikuara të mendimit shkencor në fushën e historiografisë shqiptare. Gjatë këtyre 60-viteve të jetës së tyre, u bënë tryezë me rëndësi e mendimit shkencor të historiografisë në trojet shqiptare dhe në botën e jashtme. Ato fituan një emër të mirë edhe në botën shkencore jashtë Kosovës. Në to u botua një gamë e gjerë studimesh, artikujsh e materialesh nga studiues të vendit dhe në botimet shkencore ndërkombëtare janë bërë herë pas here recensionet pozitive për këto revista shkencore, ndërsa studimet e tyre janë cituar në mjaft punime të autorëve të huaj.

Në përgjithësi, mund të thuhet se problematika e historisë së viteve 1939–1945, pra Lufta Antifashiste, zë vendin kryesor në këto revista. Studimet e kësaj fushe kanë mbështetjen në burime faktografike dhe bibliografi kryesisht të huaj dhe më pak vendës.

Pikërisht, Lufta Antifashiste (1945–1945) dhe personalitete me peshë historike të shqiptarëve në këtë luftë, ishte interesimi për studime të thelluara të *prof.dr. Masar Kodrës*. Angazhimi i *prof.dr. Masar Kodra* në këtë rrafsh, kishte peshë në dijen e historisë së popullit shqiptar, dhe ishte me rëndësi të veçantë në kuadër të ndërkommunikimeve të historiografisë shqiptare me historinë e popujve fqinjë dhe atë të huaj në këtë luftë, ndaj në kohën kur *prof.dr. Masar Kodra*, shtronte këto studime, veçohen: ***“Acarimi i***

marrëdhënieve diplomatike midis Italisë dhe Bullgarisë rreth çështjes kufitare në Maqedoni dhe në Kosovë më 1941–1943”, “Pjesëmarrja e kombësisë shqiptare në njësitet partizane të Maqedonisë më 1941–1943”, etj.

Në këto punime studimore në mënyrë analitike shkencore, prof.dr Masar Kodra shpjegon se gjatë Luftës së Dytë Botërore populli shqiptar e rreshtoi veten me luftën e tij, në radhët e atyre vendeve që luftuan kundër fashizmit e nazizmit, si armiq më të rrezikshëm të njerëzimit. Si e tillë kjo luftë ishte një objekt i studimeve të shumta të prof.dr Masar Kodrës për të pasqyruar në gjithanshmërinë e sajë të vërtetën historike, me të cilën populli shqiptarë, me të drejtë, krenohet në familjen evropiane. Por, duhet vënë në dukje, se në vitet e diktaturës komuniste historia e kësaj lufte mbeti e cunguar, në shumë raste u shtrembërua realiteti i asaj kohe, si rezultat i ideologjizimit dhe të politizimit të tejskajshëm të historisë. Profesori Masar Kodra theksonte se organizimi dhe zgjerimi i luftës pati një ngritje të dukshme si në zonat e krahinat ku vepronin komunistët ashtu edhe në ato zona ku drejtonin nacionalistët me bindjen të caktuara politike. Dhe masat shqiptare që u shkonin pasi kishin bindjen e luftës për çlirim kombëtar, kundër një armiku të përbashkët. Profesori theksonte: *“Po të ndodhte ashtu siç thoshte Rezolucioni i Konferencës së Pezës, po të ishte ashtu ajo konferencë do të ishte hapi i parë i bashkimit, ku janë hedhur e do të hidhen bazat e vërteta të bashkimit kombëtar”*.

Këto studime sjellin edhe mjaft elemente të reja dokumentare, të pabotuara deri në atë kohë, që ndriçojnë disa anë të panjohura për lexuesin serioz.

Gjatë analizës së studimeve historike serioze të prof.dr Masar Kodrës, të botuara në revistat: *“Vjetari i Arkivit të Kosovës”*,

“Gjurmime albanologjike” (Seria e shkencave historike), **“Hori-zontet e Historisë”**, **“Buletin e Muzeut të Kosovës”**, **“Buletin e Fakultetit Filozofik”**, **“Përparimi”**, **“Fjala”**, për shqiptarët në Luftën Antifashiste, me të drejt mund të konstatojmë se, i tërë ky angazhim është përqendruar, në fillim, në formimin e vetëdijes shkencore të studiuesit e kësaj fushe, e cila më vonë, do të mbartë me vete vlerat e mirëfillta të të arriturave të dijes së historiografisë përparimtare për këtë luftë të përbotshme për shqiptarët, duke i hedhur poshtë qëndrimet dhe përfundimet e historianëve tendencioze, pseudoshkencor dhe atyre shovene, me orientime antishqiptare, të cilët për burime historike, gjenin mbështetjen në dokumentacionin e falsifikuar dhe të paqëndrueshëm.

Tabloja e zymtë e gjendjes së krijuar në shkencën historike, për pjesëmarrjen e shqiptarëve në Luftën Çlirimtare Antifashiste, e cila deri në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar ishte përkulëse dhe përbuzej nga pseudoshkenca, ishte ajo e studiuesve për studimet e personaliteteve me peshë kombëtare në këtë luftë.

Kjo ndërmarrje, **“lidhur me fenomenin e personaliteteve me peshë kombëtare të nacionalistëve progresiv në Luftën e Dytë Botërore, është një nga problemet madhore të studiuesit e historisë shqiptare, thoshte profesor Masar Kodra. Historianët shqiptarë kanë nevojë të mendojnë shumë për këtë, sepse kjo historiografi njohu komunizmin më të egër, më çnjerëzor, të zhytur në veset e këqija që bënë shtrembërimin e së vërtetës historike në pasqyrimin e ngjarjeve dhe fenomeneve lidhur me Shqiptarët në Luftën Çlirimtare Antifashiste”**.

Të gjitha këto vlera të studimeve të profesor Masar Kodrës, i japin këtyre revistave një peshë dhe një vlerë të madhe shkencore, duke shënuar kështu një sukses të rëndësishëm të historiografisë së

përparuar shqiptare. Kjo vlerë shfaqet edhe nëpërmjet kundërgoditjeve të argumentuara ndaj shumë shtrembërimeve dhe falsifikimeve, që i janë bërë nga historiografia me përcaktime pseudoshkencore dhe ndikimeve ideologjike e partiake për shqiptarët në Luftën Çlirimtare Antifashiste.

HAMDI MEDIU–DUSHI

Tetovë

PROFESORI I MIQËSISË SË PAFUNDME DHE VEPRAVE TË MËDHA

Kujtimet zakonisht shfaqin dhe ndriçojnë momente, situata dhe fragmente nga e kaluara. Kur këto kujtime ndërlidhen me një personalitet, ato bartin në vete raporte, emocione, copëza përjetimesh miqësore që mbushin një kohë dhe që i japin kuptim pikërisht asaj kohe. Kujtimet janë një shirit kohe, në të cilin ne shohim fragmente të jetës sonë. Dhe, pikërisht në këtë shirit kohe unë shoh momente sublime miqësie me profesorin e nderuar Masar Kodra.

Ishte një ditë e vjeshtës së vonshme e vitit 1995 dhe pasi i kreu do obligime, u futa në “Kafenën e madhe”, ashtu siç e quanin një kafene në Reçicë të Vogël. Aty në hapësirat e saj, në njërën nga tavolinat ishin ulur profesor Masar Kodra, profesor Qamil Gexha, profesor Vebi Xhemaili, akademik Pajazit Nushi dhe dekani i Fakultetit të Arteve, profesor Ismail Hoxha. Profesor Vebi Xhemaili më ftoi të ulem edhe unë me ata në të njëjtën tavolinë, ashtu që për herë të parë unë u njoftova me profesor Masar Kodrën.

Në kafene ndejtëm gati një pasdite, dhe e gjithë biseda zhvillohej në drejtim të punës së Universitetit të Tetovës. Mua më lanë një përshtypje të jashtëzakonshme bisedat e prof. Masar Kodrës. Ai ishte një njeri elegant, i matur në bisedë dhe tepër i kujdesshëm në sjelljen e tij. Me stilin e tij të veshjes dhe sjelljes ai reflektonte kulturë dhe ide modeste të një intelektualit të rangut më të lartë.

Të nesërmen përsëri u takuam në këtë kafene. Aty gravitonin të gjithë profesorët, sepse mësimet mbaheshin nëpër shtëpitë e banorëve të lagjes Reçicë e Vogël. Fakultetet ishin të ndara nëpër objektet e banimit në çdo hapësirë ku mund të zhvilloheshin ligjëratat.

Nga ky moment unë fillova të shoqërohem me profesor Masar Kodrën dhe gati se çdo ditë ishim bashkë (kur kishte ligjërata). Ishte bashkëbisedues dhe këshillëdhënës i këndshëm, me një natyrë të hapur, i shoqërueshëm dhe shumë i kujdesshëm në bisedime, me një maturi të paparë, ishte i fjalës dhe i veprës. Në shumë ndeja dhe takime në vendbanimet e ndryshme shqiptare, kudo që të ishim në Prishtinë apo Tiranë, Strugë apo Kumanovë, ishte shumë i dashur dhe i mirëpritur nga bashkëpunëtorët e miqtë që ai i kishte. Kam pasur fatin që të jem pranë tij në shumë ndeja dhe takime pune, në gjithë hapësirën shqiptare. Kam mësuar shumë nga elokuenca e tij, nga raportet që vendoste me njerëzit si dhe nga modestia me të cilën iu qaste problemeve, të cilat diskutoheshin.

Kam shumë kujtime të bukura nga profesori i nderuar Masara Kodra. Janë me qindra, por unë do të veçoja disa që më kanë mbetur të pashlyera në kujtesën time, si ngjarje që më pas më kanë frymëzuar dhe më kanë bërë që të reflektojë në jetën time.

Në qershor të vitit 1998, profesor Nebi Dervishi së bashku me Zenulla Qyrën dhe disa intelektualë të Strugës, na pritën në restorant “Konaku 2”, pranë lumit Drin, ku kishin shtruar një sofër shumë të pasur me ushqime. Në orët e mbrëmjes arriti një delegacion nga Kosova, në krye me profesor Femi Aganin. Ishte një ndejë e jashtëzakonshme me shumë biseda sublime mbi fatin e shqiptarëve dhe mbi gjithë ato tema që preokuponin shqiptarët përgjithësisht. Deri në mëngjes biseda nuk u ndal, sepse bashkëbiseduesit kishin se

çfarë të thonin mbi sfidat e kohës, mbi gjithë ato barriera që po shfaqeshin në atë kohë dhe që kërkonin mendje të pjekura dhe të urta për t'i kuvenduar dhe për t'iu dhënë zgjidhje.

Unë tashmë kisha një miqësi të jashtëzakonshme me profesorin, e cila do të zgjaste deri në ditët e fundit të jetës së tij.

Profesor Masar Kodra u lind në Dibër më 15 maj të vitit 1932, në një familje me tradita të larta patriotike. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme (normalen) e kreu në Tetovë në vitin 1951. Po në këtë vit u regjistrua si student i rregullt në Fakultetin Filozofik të Shkupit në degën e Historisë ku edhe diplomoi në vitin 1955. Pas diplomimit ai punësohet në një shkollë fillore, si profesor i lëndës së historisë. Në vitin 1962 angazhohet si gazetar dhe reporter i lirë në gazetën javore “Flaka”–Shkup. Në vitin 1967 ai punësohet në Institutin e Historisë–Shkup, si hulumtues shkencor.

Në vitin 1972 në fakultetin Filozofik të Zagrebit, mbron tezën e disertacionit “Shqiptarët e Maqedonisë në Luftën e dytë Botërore 1939–44”, ku merr gradën shkencore “Doktor i shkencave të historisë”. Në vitin 1974, fillon me punë në Fakultetin Filozofik pranë Universitetit të Prishtinës, si pedagog në katedrën e Historisë. Në vitin 1994, ishte njëri nga themeluesit e Universitetit të Tetovës, dekan i Fakultetit Filozofik, si dhe drejtor i studimeve pasuniversitare. Ishte një njeri që nuk lodhej kurrë, pedagog me dinjitet të lartë. Gjithmonë ishte në krye të aktiviteteve të shumta, duke organizuar simpoziume, konferenca shkencore, tribuna të shumta shkencore që ishin në shërbim të shënimeve dhe të ndriçimit të shumë ngjarjeve si dhe personaliteteve tona historike.

Ndodhi një ditë dimri që profesor Masari të jetë mysafiri im. Bashkëshortja ime kishte shtruar një tryezë të pasur. Pasi u ulëm pranë tryezës për të ngrënë së bashku, profesor Masari, që i pëlqente aq shumë ushqimet e fshatrave iu drejtua shoqes time duke e pyetur se mos i gjendet specia me gjizë, specialitet që e preferonte shumë.

Profesor Masari ligjëronte edhe në Universitetin e Prishtinës, në fakultetin Filozofik, në studime pasuniversitare.

Një ditë, ishte shumë ftohtë dhe në hapësirat ku ishte katedra e Historisë në Reçicë të Vogël, aty ku mbaheshin ligjëratat nuk kishte ngrohje. Profesor Masari nuk ndjehej mirë me shëndet dhe u deshtë ta dërgoja deri te mjeku për një kontroll. Pasi e kontrollloi mjeku konstatoi se ishte rëndë i ftohur. Për herë të parë unë e çova të banesa e tij në Shkup. Aty në hyrje të ndërtesës na priste zonja e profesor Masarit, Hakile Kodra, një zonjë shumë bujare dhe shumë mikpritëse, si dhe dy djemtë e tij. Ishte një familje e përkryer, më mirëpritën me një ngrohtësi dhe me një zemërgjerësi të madhe.

Një ditë, pasi mbaroi me ligjëratat në Universitetin e Prishtinës, u ulëm në një kafene afër mensës së studentëve. Aty në tavolinën tonë u bashkëngjitën edhe shumë profesor të tjerë dhe muhabeti u zgjat deri në orët e mbrëmjes. Kur u nisën për në Shkup na zuri nata. Pasi mbërritëm te postblloku i policisë te udhëkryqi i Vitisë, aty na ndaloi policia serbe dhe na nxori jashtë makinës. Pasi e kontrolluan makinën edhe neve na bastisën dhe na urdhëruan që t'i heqim rrobat. Na lanë vetëm me veshjet e brendshme! Profesor Masari që në dalje të Prishtinës ma tërhoqi vëmendjen dhe më përgatiti se si duhet të veprojmë nëse na ndalon policia. Më tha që unë mos të them se ne njihemi, por se kinse ai më ka ndalur rastësisht për të udhëtuar me mua deri në Shkup. E gjithë kjo ndodhi sepse të

gjitha gazetat serbe kishin shkruar për profesor Masarin si një nacionalist i përбетuar shqiptar. Kështu, unë u detyrova që policëve t’iu them se nuk njihemi me profesor Masarin dhe se rastësisht në dalje të qytetit të Prishtinës më stopoi dhe unë e mora me veti për në Shkup. Kur më pyetën pse isha në Prishtinë, unë ua ktheva se kinse e kam bashkëshorten prishtinase dhe aktualisht gjendet e shtrirë në spital, kurse fëmijët i kam në Maqedoni te prindërit e mi. Fatmirësisht një nga policët që ishte në anën e kundërt të rrugës na u afrua dhe ai e njohu profesor Masarin, dhe iu drejtua me këto fjalë në gjuhën e tij serbe: “*Profesor unë ju njoh, ju jeni profesori i motrës time*”! Ky polic u largua dhe shkoi te grupi i policëve që na kontrollonin dhe kur u thye tek ne na dorëzoi dokumentet dhe na tha që mund të largohemi. Ky rast ishte një nga të shumtat e rasteve që patëm gjatë asaj kohe, por e veçanta e këtij rasti ishte se qëlloi koha e ftohtë dhe ne mbërdhezëm ashtu të zhveshur gati se lakuriq, e sidomos profesor Masari, sepse ai ishte në moshë, dhe me shëndet të dobët.

Në vitin 1998—të, Katedra e Historisë në krye me profesor Masarin dhe stafin e tij, morën një iniciativë për shënimin jubilar të 90—vjetorin e Kongresit të Manastirit (alfabetit). Për mbajtjen e këtij evenimenti duheshin mjete, kështu që unë dhe profesor Masari u drejtuan në komunat shqiptare për të siguruar mjete. Ne i vizituam të gjitha komunat. Fillimisht ndër të parët komuna që iu drejtuan për ndihmës ishte komuna e Bogovinës, ku kryetar ishte prof. Vebi Xhemaili, prej të cilit patëm përkrahje të madhe (ishte edhe ligjërues në UT). Më kujtohet që kryetari i Komunës së Dibrës na priti mirë dhe na nxori për drek në një restorant afër liqenit. Pasi na shtruan drekën, profesori iu drejtua kryetarit me këto fjalë: “*Më mirë këto harxhime të na i lëshojë në xhirollogarinë e hotelit ku do*

të mbahet konferenca shkencore, sepse keni nevojë për mjete". Kryetari mbeti i shtanguar, dhe u përgjigj se do të na ndihmojë për mbajtjen e konferencës kushtuar Ditës së Alfabetit. Konferenca u mbajt në hotel "Petrol" në Gostivar, e cila zgjati dy ditë. Në këtë ngjarje morën pjesë shumë studiues nga vendi, Kosova dhe Shqipëria, dhe në mbylljen e saj organizuam një mbrëmje solemne në hapësirat e hotelit. Na nderoi me prezencën e saj edhe këngëtarja e njohur Miranda Hashani me orkestrën e saj.

Më kujtohet një rast, ishim në Prishtinë dhe përderisa ktheheshim për në Shkup u ndaluan në Kaçanik te disa studentë të profesor Masarit. Ata na pritën njëft mirë, ashtu që ngelëm deri në orët e vona, se na morën e shkuam në një fshat afër Kaçanikut (Nikë) dhe aty na shtruan darkë. Në këtë mbrëmje u mbledhën shumë fshatarë, të cilët hapën tema të ndryshme në mes tjerave edhe çështja e formimit të UÇK-së, dhe mbrojtja e popullatës shqiptare nga hordhitë serbo-çetnike. Pas një diskutimit tim, profesor Masari më sinjalizoi që mos të futëm në kësi lloj diskutimesh. Gjatë rrugëtimit në drejtim të kufirit Kosovë-Maqedoni, aty na bastisën dhe na morën në pyetje në hapësirat e objekteve kufitare, por për fat të mirë nuk na gjetën gjë (sepse s'kishim ndonjë material me vete), por na parashtruan shumë pyetje të natyrave të ndryshme. Pasi kaluam kufirin profesor Masari ma tërhoqi vëmendjen se nuk duhet të flisja për kësi çështjesh, sepse nuk i njihnim shumicën e atyre njerëzve që ishin prezent.

Nipi i profesor Masarit, Naim Fetahu nga Dibra kishte për të mbrojtur disertacionin e doktoratës në Institutin e Arkeologjisë në Tiranë. Unë dhe profesor Masari shkuam në Tiranë për të qenë prezent në këtë mbrojtje. Aty takuam shumë figura të larta të shkencës së arkeologjisë dhe të historisë, ndër të tjerë u takuam

edhe me profesoreshën Valentina Duka. Profesor Masari i kishte miq të vjetër gati se të gjithë ata që takuam në institut, por në takim e parë profesoresha Duka e përqafoi profesor Masarin dhe në këmishën e profesor Masarit ngeli i kuqi i buzëve të saja. Më vonë, në orët e pasdites na ra hise të takojmë profesor Ferit Dukën, i shoqi i Valentinës, dhe atij i ra në sy këmisha e profesorit që ishte me buzëkuq të femrës! Ai e pyeti profesorin se kush ta paska bërë këtë, profesori iu përgjigj: *“Pyete të shoqen tënde, ajo të tregon se kush ma ka bërë”!*

Në fillim të vitin akademik 1998/99, nisi iniciativa për hapjen e shkallës së III-të të studimeve pasuniversitare, e inicuar nga profesor Masar Kodra dhe rektori i asaj kohe profesor Fadil Sulejmani. Një ditë më thotë profesor Masari se duhet të mblidhen te shtëpia ime për të hartuar rregulloren dhe statutin e studimeve pasuniversitare. Në atë mbrëmje prezent ishin profesor Zejnulla Gruda, Masar Kodra dhe Pajazit Nushi. Profesor Pajaziti e kishte me vete një kopje të rregullores së Universitetit të Prishtinës si dhe kishin edhe rregulloren e Universitet të Zagrebit. Mua më ra hise të shkruaj në kompjuterin që kisha në shtëpi, pasi që ata më diktonin. Pasi e printuam, profesor Zenulla Gruda e mori me vete dhe më vonë u njoftova se ishte formua një ekip e profesorëve të stafit akademik të universitetit, dhe kishin bërë ndryshime dhe plotësime të rregullores dhe statutit, e kishin moderua me ato të universiteteve evropiane.

Në pasditen e 7 korrikut të vitit 2003, unë kthehesha nga Prishtina dhe pasi kalova kufirin dhe u futa në territorin e Maqedonisë e aktivizova telefonin. Në atë moment më erdhën aq shumë mesazhe nga njerëzit që më kishin kërkuar. Së pari u paraqita në familjen time, të cilët më njoftuan se kishte ndërruar jetë profesor Masari. Në atë moment u ndala në mes të rrugës dhe iu paraqita zonjës

Hakile, bashkëshortes së profesor Masarit. Pasi ma konfirmoi rastin unë u nisa në drejtim të Shkupit. Si pasojë e një sëmundje të rëndë e të pashërueshme më datë 7 korrik, diku në ora 10:30 para dite, kishte ikur nga kjo botë profesor Masar Kodra. Gjatë tërë kohës unë kisha njohuri se profesori nuk ishte me shëndet të mirë, sepse mua më lajmëronte mjeku që mbikëqyrte profesorin në spitalin shtetëror të Shkupit, në repartin e Hematologjisë, ku ai gjendej disa ditë në mjekim. Gjatë udhëtimit tim për në Shkup më kujtohet që e lajmërova profesor Zeqirja Idrizin, i cili më tha se edhe ai ishte nisur për në Shkup. Atë natë qëndruam në Shkup, së bashku me Zeqirjaun në banesën e Nagip Toskës, ku ishin edhe shumë miq e fqij të profesor Masarit. Të nesërmen më 8 korrik, diku ka ora 11 para dite në prani të shumë familjarëve si dhe miqve e sollëm ku-fomën te xhamia e Jahja Pashës. Pas faljes së namazit të drekës, u varros në varrezat e Butelit.

Një kortezh i madh po e përcillte profesorin për në banesën e fundit. Ai s'ishte më ndër ne, por diçka e tija mbetej te ne miqtë e tij, që kishim kaluar shumë sfida bashkë. Mbetej shëmbëlltyra e tij, e njeriut të përkushtuar, mikut të mirë, studiuesit të jashtëzakonshëm dhe veprintarit të palodhur për gjithçka që ishte shqiptare. Në atë moment unë e kuptova se jo gjithçka vdes bashkë me njeriun. Janë gjurmët që lë ai pas që vdekja nuk i merr me vete, sepse ato mbeten përjetësisht në shpirtin tonë, në horizontin që dija dhe përkushtimi i tij kishte hapur për ne miqtë dhe për gjithë gjeneratat që vijnë pas.

SADRI REXHEPI

Prishtinë

PROF.DR. MASAR KODRA DHE KONTRIBUTI I TIJ SHKENCOR DHE KOMBËTAR

U bënë 14 vite që kur u nda fizikisht profesori ynë i veprës dhe idealit të lirisë kombëtare. Këto 14 vite të mungesës fizike të Profesor Masar Kodrës nuk kanë arritur ta zbehin personalitetin e tij në zemrat e mendjet tona. Përkundrazi, me kalimin e kohës, malli e dashuria, respekti e admirimi për të shtohen gjithnjë e më tepër. Prandaj, ne gjithnjë e më tepër jetojmë me veprat e kujtimet e profesorit tonë të dashur e të nderuar Masar Kodra.

Personaliteti i tij, synimet dhe qëllimet e tij, të cilat sot u bënë realitet i pjesërishëm, na kujtojnë vijimisht punën e tij si mësimdhënës në shkollat e Shkupit, punën prej gazetari në gazetat shqipe që botoheshin aso kohe në Shkup, punën si ligjërues në Universitetin e Prishtinës dhe aktivitetin e palodhshëm pas vitit 1981, në dobi të çështjes kombëtare me gjithë porositë e tij.

Në vitin 1982 pati një infarkt, por arriti ta përballojë me sukses, sepse nuk dëshironte të vdiste pa e parë Kosovën të çliruar nga pushtuesi serbosllav. Ai angazhohej për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni për të qenë të barabartë me maqedonasit në atë republikë dhe të avancohen të drejtat e shqiptarëve në Kosovën Lindore dhe në Mal të Zi. Ishte bashkëpunëtor i ngushtë i Fadil Sulejmanit për themelimin e Universitetit të Tetovës.

E sot, kur Kosova frymon lirshëm pas nëntë vitesh pavarësie nga robëria shekullore serbe dhe në Maqedoni në çdo hap po valon lirshëm Flamuri Kombëtar Shqiptar, po marshon lirshëm rinia shkollore shqiptare drejt arsimimit dhe emancipimit kombëtar, po flitet e po shkruhet lirshëm për luftën heroike të UÇK-së në Maqedoni, po ngjeshën radhët e policisë vendore me policë shqiptarë në shërbim e në mbrojtje të popullit e atdheut të tyre drejt idealeve dhe synimeve e qëllimeve të përhershme të prof. Masar Kodrës. Të gjitha këto na detyrojnë ta çmojmë, ta nderojmë e ta përkujtojmë me pietet të lartë këtë profesor e veprimtar të palodhshëm, punëtor e luftëtar të denjë të çështjes e të çlirimit kombëtar.

Me profesor Masar Kodrën më lidhin shumë momente, por unë do t'i përmend vetëm tri sosh e ato janë: Momenti i parë është kur përfaqësuesit e Komitetit Krahinor dhe Komitetit Komunal të Prishtinës kishin caktuar mbledhjen për diferencimin e profesorëve në Fakultetin Filozofik, dhe meqenëse Muhamet Tërnavë pak ditë para se të mbahej kjo mbledhje ishte burgosur, Fakulteti Filozofik e caktoi profesor Masar Kodrën për ta udhëhequr atë mbledhje, të cilën e ka udhëhequr jashtëzakonisht mirë. Dhe pas diskutimeve të profesorëve akademikë Ali Hadri, Fehmi Agani, Skender Rizaj, Shukri Rrahimi, etj., fjalën e morën tre studentë të asaj kohe Sadri Rexhepi, Sejdi Bytyqi dhe Sylejman Hani, të cilët e kundërshtuan haptazi e në mënyrë shumë rigoroze termin 'kontrarevolucion', 'separatizëm', 'irredentizëm' e gjithfarë termash absolutisht të pavërteta dhe të pasakta, të cilat ua vishnin studentëve të cilët protestonin në mënyrë paqësore për Republikën e Kosovës. Të gjitha këto etiketime dhe njollosje bëheshin me qëllim nga pushtuesi serbosllav për t'i shtypur demonstratat studentore të vitit 1981.

Momenti i dytë ka qenë në kohën kur Komiteti Krahinor kishte angazhuar aktivistët e vet për diferencimin e prof. dr. Skender Rizajt. Në mbledhjen diferencuese shkua me bashku me prof. dr. Masar Kodrën, ku pas shumë orvatjeve të aktivistëve komunistë, dhe pas etiketimeve të shumta nga ana e tyre dhe hedhjes së gurëve e drurëve për prof. Rizajn, ngritët Sadri Rexhepi dhe e mbron profesorin me fakte shumë të qëndrueshme dhe e nxjerr atë si njërin ndër shkencëtarët më të mirë të kohës. Për diskutimin tim në mbrojtje të prof. dr. Skender Rizajt më përgëzoi shumë prof. dr. Masar Kodra, i cili më tha “të lumtë, se vetëm kështu mbrohen profesorët”.

Ndërkaq, momenti i tretë është në vitin 1995 kur shkua në Gjermani dhe u takua me disa punëtorë nga Tetova, Shkupi dhe nga viset e ndryshme të Maqedonisë, në qytetin e Kerefelldit, me ç’rast kërkoi ndihmë materiale nga bashkëvendësit e vet, duke ju thënë se ju jeni ata që mund të na ndihmoni që ta mbajmë gjallë Universitetin e Tetovës. Ai me lot në sy u tha bashkatdhetarëve se në rrugën e hapjes së Universitetit të Tetovës janë duke na penguar përveç pushtuesve sllavomaqedonas, edhe shumë intelektualë shqiptarë, nga viset e Maqedonisë të cilët janë shkolluar më herët në Universitetin e Prishtinës!

Tash, kur sot jemi të lirë, nga njëra anë, e kur e dimë se sa mund, punë e sakrifica ka bërë, edhe pse i dërmuar nga shantazhet e robëruesve serbo—maqedono—sllavë, prof. Masar Kodra u angazhua për këtë ditë, për këtë çështje. Nga ana tjetër, aq më tepër na shtohet dashuria e na djeg malli për mungesën e tij, aq më tepër vepra e tij na ofron e na bashkon, siç na ka bashkuar sot në këtë simpozium që do t’i kushtohet angazhimeve të tij shkencore e patriotike, ku

jemi tubuar këtu të bashkuar dhe të afruar, për ta nderuar e përkujtuar përherë profesorin e lirisë.

Ndonëse, prof.dr.Masar Kodra, sot mungon fizikisht në mesin tonë, ai shpirtërisht është me ne, fryma e tij e kujtimi i tij jeton në ne. Ne sot e shohim, e parafytyrojmë atë të qeshur e të gëzuar në mesin tonë, për Kosovën e çliruar dhe avancimin e të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni, sepse idealet, synimet e qëllimi i tij u realizuan dhe janë në realizim e sipër. Prandaj, trupi dhe eshtrat e tij lë të prehen të qetë në ish kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës në Shkupin e lirë. Vëllezërit e fëmijët e tij, ne ish studentët e tij, shokët e rinia shqiptare, ballëlartë e me krenari do të ecim rrugës së tij shkencore e patriotike, duke qenë përherë në shërbim të popullit e të atdheut.

Lavdi i qoftë prof. dr. Masar Kodrës për të gjitha veprat shkencore dhe veprimtarinë patriotike që bëri në shërbim të popullit dhe Atdhut tonë të dashur.

BESNIK EMINI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

SHKRIMET E MASAR KODRËS TË BOTUARA NË REVISTËN “JEHONA” – SHKUP

Historiani Masar Kodra një pjesë të konsiderueshme të shkrimeve të tij i ka botuar edhe në revistën për çështje shkencore, artistike e kulturore “Jehona”, e cila botohej në Shkup. Ai në këtë revistë i botoi këto tituj:

–Bashkimi i popullit shqiptar dhe maqedonas gjatë Luftës Nacional-çlirimtare (1941–1944), Jehona, Viti IX, Shkup, 3–1971, f. 85–97;

–Gjurmëve të një dokumenti të panjohur, Jehona, Viti XI, Shkup, 7–1972, f. 107–113 (Në bashkautorësi me Ismet Dërmakun);

–30 vjet nga formimi i teritoreve të lira, Jehona, Viti XI, 8–1973, Shkup, f. 89–99;

–30 vjet nga formimi i teritoreve të lira II, Jehona, Viti XI, 9–1973, Shkup, f. 107–119;

–Tridhjetë vjet nga formimi i Partisë Komuniste të Maqedonisë, Jehona, Viti XI, Shkup, 2–1973, f. 109–118;

–Pozita ekonomike, shoqërore dhe politike e kombësisë shqiptare të Maqedonisë midis dy luftëtareve botërore II, Jehona, Viti XI, Shkup, 2–1973, f. 95–111.

Shkrimin e parë të cilin e ka botuar në këtë revistë e mban titullin "Bashkimi i popullit shqiptar dhe maqedonas gjatë Luftës Nacional-çlirimtare (1941–1944)", i botuar në nr. 3–1971, f. 85–97.⁹¹ Shkrimi mban nëntitullin: "Me rastin e kremtimit të tridhjetëvjeterit të Revolucionit të popujve dhe kombësive të Jugosllavisë. Autori në të përmend që bashkëpunimi i popullit shqiptar dhe maqedonas është zhvilluar që nga Kongresi i Berlinit deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Autori thekson se me formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë më 8 nëntor të vitit 1941, anëtarët e saj vendosën që rezistencën e popullit shqiptar kundër fashizmit ta lidhin me atë të popujve ballkanikë, e cila ndërlidhet me rezolutën e aprovuar më 8 nëntor 1941, ku edhe citohet edhe një fragment i kësaj rezolute: "Të zhvillojmë dashuri dhe bashkëpunim luftarak me të gjithë popujt e Ballkanit, sidomos me atë serb, grek, malazez dhe maqedonas, të cilët luftojnë heroikisht për pavarësinë e vet kombëtare". Gjithashtu më poshtë citohet edhe një pjesë e proklamatsës me të cilën Partia Komuniste e Shqipërisë e njofton popullin shqiptar në lidhje me luftën kundër fashizmit që e zhvillonin popujt e Ballkanit: "Të gjithë popujt e robëruar të Evropës si dhe popujt e Ballkanit po bëjnë një luftë heroike të përgjithshme për çlirimin e tyre, malazezët, serbët, kroatët, maqedonasit, grekët, vendet e të cilëve janë robëruar nga fashizmi gjermano-italian po bëjnë një luftë të përgjithshme për çlirimin e tyre kombëtar".

Autori thekson se fokusi kryesor i tekstit në fjalë janë momentet që kanë të bëjnë me bashkëpunimin e popullit shqiptar dhe maqedonas gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare, me faktin se mungojnë të dhënat për vitet 1941–1942 janë tejet të pakta nëpër arkiva. Këtë autori e

⁹¹ Masar Kodra – Bashkimi i popullit shqiptar dhe maqedonas gjatë Luftës Nacional-çlirimtare (1941–1944), Jehona, Viti IX, Shkup, 3-1971, f. 85-97

sqaron me faktin se aktivitetet e asaj kohe bëheshin në konspiracion dhe shumë letra komunikuese zhdukeshin. Janë zhvilluar kontakte të drejtpërdrejta mes komunistëve nga Shqipëria dhe Maqedonia. Autori thekson se një rol të rëndësishëm në lidhje me bashkëpunimin mes komunistëve të Shqipërisë dhe atyre të Maqedonisë ka dhënë kombësia shqiptare e pjesës perëndimore të Maqedonisë, e cila ka shërbyer si urë kaluese në këtë drejtim, sidomos ajo e vendeve kufitare si Dibra, Prespa, Ohri dhe Struga. Këtë gjë autori e mbështet edhe me kërkesën e Strasho Pinxhurit i cili në emër të anëtarësisë së Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Maqedoni gjatë vitit 1942, duke kërkuar që të ndërtohet një platformë e veçantë e luftës kundër fashizmit për banorët e Maqedonisë perëndimore në bashkëpunim sa më të ngushtë me Partinë Komuniste të Shqipërisë.

Një bashkëpunim tjetër është edhe kalimi i batalionit të partizanëve të Manastirit në territorin e Shqipërisë gjatë vitit 1943 për të ruajtur homogjenitetin e vet dhe kushtet më të mira të veprimit. Me formimin e brigadës së parë Partizane në Shqipëri janë krijuar para kushte edhe më të thella për bashkëpunim të ndërsjellë mes njësive partizane të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Sipas autorit, bisedimet në lidhje me këtë bashkëpunim luftarak kanë filluar qysh në pranverë të vitit 1943, me ç'rast citohet letra e Shtabit të Përgjithshëm të njësive partizane të Maqedonisë, e cila me anë të një letre iu është drejtuar njësive partizane shqiptare, letër të cilës i përgjigjet Haxhi Lleshi, komandant i batalionit partizan në rrethinën e Dibrës, i cili mes tjerash shkruan: "...Shokë, kemi kuptuar çdo gjë për atë që na keni shkruar dhe në përgjithësi dakordohena me ju. Ne shpesh herë kemi insistuar të bëjmë dhe të vemë kontakt me shtabin tuaj për marrëveshje të tjera, për një bashkëpunim tonin sa më të ngushtë,

për qëllimet e luftës kundër armikut të përbashkët... Ju kumtojmë se jemi të gatshëm që të miremi vesh me Ju... Për ndihmë reciproke nga të dy anët, për luftë kundër okupatorit fashist...”.

Në këtë tekst gjithashtu përmendet edhe rasti i varjes së gjashtë komunistëve maqedonas në rrugët e Tiranës: Dushko Popoviqin, Ilija Antevskin, Rade Ugrinovskin, Kërste Xhakalievskin, Trifun Andonovskin dhe Dragan Todorovskin.

Në sajë të bashkëpunimit të ndërsjellë është arritur marrëveshje që një çetë partizane shqiptare e udhëhequr nga Haxhi Lleshi të kalojë në territorin e Maqedonisë Perëndimore dhe të veprojë së bashku me repartet partizane të Maqedonisë në këtë territor, gjë e cila më vonë u realizua, me ç’rast një çetë partizane shqiptare e udhëhequr nga Haxhi Lleshi kaloi në territorin e Maqedonisë dhe veproi në rrethin e Kërçovës.

Me kapitullimin e Italisë në shtator të vitit 1943 është formuar zona e lirë e cila shtrihej prej Kërçovës deri në Peshkopi, e mbrojtur nga njësitë partizane shqiptare dhe maqedonase. Në këtë punim përmendet edhe bashkëpunimi partizanëve shqiptarë dhe maqedonas në zonën e Ohrit, Strugës, Elbasanit, Pogradecit dhe Dibrës. Autori thekson se bashkëpunimi i popullit shqiptar dhe maqedonas gjatë Luftës së Dytë Botërore kulminacionin e arrin në fillim të muajit gusht të vitit 1944, kur Divizioni i Parë i Ushtrisë Nacionale-Çlirimtare të Shqipërisë kalon lumin Drin, sulmon Peshkopinë dhe luftëtarët e kësaj brigade koncentrohen në malin e Korabit e më pas kjo brigadë kalon në terrenin e Maqedonisë dhe arrin në Karaorman, ku në atë kohë ishte e koncentruar Brigada e Parë Kosovare dhe Brigada e Parë Maqedonase, duke bërë plan ta sulmojnë qytetin e Dibrës.

Shkrimi i radhës i Masar Kodrës në revistën “Jehona” është botuar në bashkautorësi me Ismet Dërmakun dhe mban titullin “Gjurmave të një dokumenti të panjohur”.⁹² Ky tekst ka të bëjë me një dokument i cili në fillim shoqërohet me tekstin sqarues të autorëve, respektivisht me faktin që dokumenti është gjetur në arkivin e Serbisë dhe se është pa datë dhe pa vend ku është shkruar. Autorët supozojnë që dokumenti të jetë i viteve 1906 dhe 1907. Titulli i dokumentit i cili jepet i plotë në vazhdim të tekstit është “Udhërefenjes i trimave”, ndërsa nëntitulli “Komiteti i Shqipërisë”. Përmbajtja e dokumentit është udhëzues për anëtarët e Komitetit të Shqipërisë për aktivitetet e tyre, respektivisht rregullore për organizimin e çetave të armatosura dhe detyrat e tyre.

Shkrimi i radhës i autorit në revistën “Jehona” mban titullin: “30 vjet nga formimi i territoreve të lira”.⁹³ Kjo është pjesa e parë e këtij teksti, pasi pjesa e dytë është botuar në numrin vijues të revistës “Jehona”. Në këtë tekst autori bën fjalë për periudhën pas kapitullimit të Italisë fashiste me ç’rast u krijuan territoret e lira. Më 8 shtator të vitit 1943 në një pjesë të Maqedonisë Perëndimore zgjerohet Zona e Lirë e cila zgjatet deri në jug të Gostivarit dhe përfshin rajonin Mavrovë–Kërçovë–Dibër deri te ngushtica e Botunit. Në fillim të tekstit autori kryesisht përqendrohet në rrethanat që ishin në Dibër dhe Kërçovë pas largimit të forcave italiane. Këtu përmendet edhe krijimi i organeve të para të pushtetit popullor në rrethin e Dibrës. Sipas autorit, në kuadër të anëtarëve të Këshillit të ri Nacionalçlirimtar, kapiteni anglez Hands, përfaqësues i misionit anglez pranë shtabit partizan të Dibrës kishte kërkuar që në këshillin

⁹² Ismet Dërmaku – Masar Kodra – Gjurmëve të një dokumenti të panjohur, Jehona, Viti XI, Shkup, 7-1972, f. 107-113

⁹³ Masar Kodra - 30-vjet nga formimi i territoreve të lira, Jehona, Viti XI, 8-1973, Shkup, f. 89-99

Nacionalçlirimtar të Dibrës të futen edhe disa nacionalistë si: Abdi Golja, Qazim Lusha, Andrea Botka, kapiten i xhandarmërisë dhe Jusif Xhinali, ish agjent i kuesturës së Dibrës. Mirëpo këto sugjerime nuk ishin pranuar. Sipas të dhënave të autorit, Partia Komuniste e Maqedonisë nuk ka qenë e kënaqur me situatën në Dibër, për çka si dëshmi jepet letra e Dobrivoje Radosavleviqit e datës 26 shtator të vitit 1943: “Dibra është çliruar, mirëpo ne nuk mbajmë në duart tona pushtetin në tërësi, pasi pushtetin e ndajmë me disa nacionalistë, të cilët nuk janë në vijën tonë... Nëse arrijmë marrëveshje me partizanët shqiptarë... kjo situatë do të rregullohet dhe atëherë do të kemi pushtet të atillë, i cili do të mund të garantojë liri, vëllazërim dhe barabarësi të shqiptarëve dhe të maqedonasve”.

Përveç situatës në Dibër, në vazhdim të punimit përshkruhet situata në Kërçovë por edhe formimi i njësisë partizanë në Livadhi të Strugës. Pjesa e dytë e tekstit “30 vjet nga formimi i teritoreve të lira (II)” është botuar në numrin 9 të vitit 1973.⁹⁴ Në fillim të tekstit në fokus janë sërish zhvillimet në Dibër, respektivisht formimi i Batalionit Partizan të Rinisë së Dibrës më 6 tetor 1943 të cilin e përbënin rreth 150 luftëtarë, e i cili u pagëzua me ermin “Nazmi Rrushiti”. Vëmendje të veçantë në këtë pjesë të shkrimit i kushtohet situatës së konfrontimit të forcave partizane me forcat gjermane dhe forcave shqiptare lokale që i mbështesnin ato.

Shkrimi i radhës i autorit Masar Kodra i botuar në revistën “Jehona” mban titullin: “Tridhjetë vjet nga formimi i Partisë Komuniste

⁹⁴ Masar Kodra - 30-vjet nga formimi i teritoreve të lira II, Jehona, Viti XI, 9-1973, Shkup, f. 107-119

të Maqedonisë”⁹⁵. Autori në fillim të tekstit thekson se njëri ndër problemet e pazgjidhura në Mbretërinë Jugosllave deri në fund të vitit 1941 ishte çështja e pazgjidhur nacionale. Autori në këtë shkrim i kushton vëmendje të posaçme inkuadrimit të shqiptarëve të Maqedonisë Perëndimore në organizatat përkatëse të qyteteve të Strugës, Kërçovës, Dibrës, Gostivarit dhe Tetovës. Në lidhje me formimin e Partisë Komuniste të Maqedonisë autori e thekson rolin e Partisë Komuniste të Jugosllavisë në këtë gjë, duke e dërguar anëtarin e vet Svetozar Vukmanoviq – Tempo. Pas përgatitjeve të duhura më 9 mars të vitit 1943 në Tetovë formohet Partia Komuniste e Maqedonisë. Autori thekson që pas formimit të Partisë Komuniste të Maqedonisë, Komiteti Qendror i kësaj partie më 4 dhe 5 maj të vitit 1943 ka mbajtur mbledhje të zgjeruar në Llopushnik në të vilën mes tjerash është aprovuar vendimi që nga ana e përfaqësuesve të kombësisë shqiptare të Maqedonisë të formohet një aradhe e veçantë partizane, gjegjësisht batalioni i tretë shqiptar. Në fund të tekstit autori e parashtron pyetjen: Pse Partia Komuniste e Maqedonisë nuk është formuar më parë dhe formimi i saj u realizua në territorin e Maqedonisë Perëndimore? Në këtë pyetje autori përgjigjet se nuk kishte kushte objektive që më herët të formohet Partia Komuniste e Maqedonisë. Ndërsa në lidhje me pjesën e dytë të pyetjes autori thekson se në territorin e Maqedonisë Perëndimore ishin kushtet më të favorshme për një gjë të këtillë, ku “njerëzit pa dallim kombësie, maqedonas, shqiptarë dhe turq, ishin të gatshëm të marrin pjesë dhe të masivizojnë edhe më tutje radhët e Luftës nacionalçlirimtare”.

⁹⁵ Masar Kodra – Tridhjetë vjet nga formimi i Partisë Komuniste të Maqedonisë, Jehona, Viti XI, Shkup, 2-1973, f. 109-118

Shkrimi i fundit i botuar në revistën “Jehona” mban titullin: “Pozita ekonomike, shoqërore dhe politike e kombësisë shqiptare të Maqedonisë midis dy luftëtareve botërore”, dhe është botuar në dy pjesë, në numrin 1 dhe 2 të vitit 1973.⁹⁶

Në këtë shkrim autori e trajton pozitën e shqiptarëve në një periudhë të rëndësishme, atë mes dy luftërave botërore, atë të Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, më vonë të quajtur Mbretëria Jugosllave, duke vënë theksin mbi rolin e partive politike ndaj shqiptarëve. Autori e trajton edhe çështjen e partisë “Xhemijeti”, rolin e të cilës e vlerëson se ka qenë në shërbim të kryeministrit dhe udhëheqësit të partisë radikale Nikolla Pashiq. Autori jep të dhëna edhe për zgjedhjet që u zhvilluan në Mbretërinë SKS dhe deputetët shqiptarë që u zgjodhën në kuadër të partisë “Xhemijeti” por edhe të Partisë Radikale. Në këtë shkrim përveç rrethanave politike autori i trajton edhe rrethanat kulturore–arsimore të kombësisë shqiptare. Në lidhje me çështjen e arsimit autori thekson se numri i shkollave ku jetonin shqiptarët ka qenë mjaft i kufizuar edhe atë vetëm në gjuhën serbokroate. Sipas autorit në territorin e Maqedonisë ku jetonin shqiptarët dhe turqit ka pasur vetëm 105 shkolla që punonin në gjuhën serbokroatishte. Në shkollat fillore të Jugosllavisë, gjatë vitit shkollor 1927–1928 ishin regjistruar vetëm 7565 nxënës shqiptarë, nga mbarë numri i kombësisë shqiptare të Jugosllavisë. Autori me këtë rast bën edhe një krahasim si vijon: “Ky numër paraqitet edhe më konsekuent nëse përmendim se në këto shkolla janë regjistruar 12.760 nxënës të kombësisë turke, e cila sipas shënimeve statistikore të atëhershme,

⁹⁶ Masar Kodra – Pozita ekonomike, shoqërore dhe politike e kombësisë shqiptare të Maqedonisë midis dy luftëtareve botërore II, Jehona, Viti XI, Shkup, 2-1973, f. 95-111

ka numëruar gjithsejtë 80 mijë frymë.” Autori thekson se nxënësit shqiptarë i ndiqnin kryesisht shkollat me karakter fetar.

Në pjesën e fundit të tekstit autori thekson masat që i ndërmerre pushteti për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi.

ARDIAN LIMANI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

VEPRIMTARIA HULUMTUESE – SHKENCORE E MASAR KODRËS NË INSTITUTIN E HISTORISË NACIONALE NË SHKUP

Masar Kodra, përpara se të punësohet si kuadër shkencor në Institutin e Historisë Nationale në Shkup, nga viti 1955–1956 ishte arsimtar në shkollën fillore “Liria”, kurse nga viti 1957 deri në vitin 1960 ishte drejtor i shkollës fillore “Mosha Piade” në Shkup. Gjatë vitit 1960 ishte redaktor i gazetës “Flaka e Vllazërimit”.

Masar Kodra është pranuar në Institutin e Historisë Nationale në Shkup, më 1 janar 1967, në sektorin: Historia Bashkëkohore, ku është zgjedhur në thirrjen: asistent. Me formimin e sektorit të Ballkanologjisë, më 1 janar të vitit 1969, Masar Kodra është transferuar me punë në këtë sektor.

Në raportin e komisionit recensues për rizgjedhjen e Masar Kodrës asistent në Institutin e Historisë Nationale në Shkup, të datës 23.3.1970, në përbërje: Todor Simovski dhe dr. Orde Ivanoski, zgjedhur nga Këshilli i Institutit të Historisë Nationale në mbledhjen e 28 janarit 1970, në bazë të nenit 55 nga Statuti i IHN dhe lutjes së kandidatit Masar Kodra për rizgjedhje në thirrje: asistent në sektorin e Ballkanistikës të IHN, thuhet:

- Me ardhjen në punë në Institutin e Historisë Nationale në Shkup, sipas konkursit të publikuar në bazë të cilit ishte pranuar

Masar Kodra, ai ishte orientuar në veçanti për studimin e historisë së nacionaliteteve të cilët jetojnë në territorin e Maqedonisë. Për periudhën raportuese, preokupimi i tij kryesor ishte drejtuar kah studimi i historisë së marrëdhënieve shqiptaro-maqedonase në të kaluarën, si dhe historia e lëvizjes nacionalçlirimtare shqiptare.

Pasi merrej me literaturë profesionale si dhe me problematikat e metodologjisë së historisë, ai filloi të botojë punime shkencore në revista shkencore. Përveç kësaj, Masar Kodra mori pjesë në disa tubime shkencore me referate dhe diskutime. Me shkrime të tija, rregullisht bashkëpunonte me shtypin dhe radio-televizionin.

Masar Kodra ka mbajtur disa ligjërata përpara mësuesve dhe profesorëve të historisë në organizim të Entit për Shkollë të Republikës Socialiste të Maqedonisë. Ai ishte anëtar i Këshillit Qendror të Bashkimit të Sindikatave të Maqedonisë, si dhe anëtar i Këshillit të Akademisë Pedagogjike në Shkup.

Në këtë raport është paraqitur e gjithë puna e tij kërkimore-shkencore që nga punësimi në Institutin e Historisë Nacionale më 1 janar 1969, e deri datën e dorëzimit të raportit të komisionit recensues për rizgjedhje të datës 23.3.1970. Këto janë të dhënat e punimeve të botuara:

1. “Luftimet për Dibrën gjatë vitit 1944 sipas burimeve shqiptare”, Glasnik IHN Shkup, viti X, nr. 1, 1966.
2. “Revolucioni xhonturk dhe Lëvizja Çlirimtare Shqiptare”, Glasnik IHN Shkup, viti XII, nr. 1, 1968.
3. “Revolucioni borgjez-demokratik në Shqipëri në vitin 1924”, Glasnik IHN Shkup, viti XII, nr. 3, 1968.

4. “Kongreset në Dibër, Elbasan dhe Manastir dhe Lëvizja Çlirimtare Shqiptare”, Glasnik IHN Shkup, viti XIII, nr. 1–2, 1969.

5. “Qëndresa dibrane kundër turqve në kohën e Skenderbeut”, Simpozium për Skënderbeun, Prishtinë, 1969, f.135–144.

6. “Lidhjet dhe bashkëpunimi i lëvizjeve çlirimtare të popullit shqiptar dhe atij maqedonas gjatë Ilindenit”, revista “Përparimi” Prishtinë, nr. 3–4, 1968.

Në këtë raport janë paraqitur edhe punimet të cilat kanë qenë në shtyp:

1. “Kongreset në Dibër dhe Elbasan, fitore të reja lëvizjes çlirimtare shqiptare.” Ky punim do të botohet në fund të vitit 1969 në “Kërkime Albanologjike”.

2. “Bashkëpunimi i popullit maqedonas dhe atij shqiptar në përiudhën e kryengritjes së Ilindenit” Ky punim është lexuar në simpoziumin kushtuar 65–vjetorit të kryengritje së Ilindenit, mbajtur më 27–29 maj 1968 në Ohër.

3. “Zef Lush Marku – revolucionar e komunist i dalluar dhe përfaqësues i lëvizjes së punëtorëve nga Kosova dhe Maqedonia.” Ky punim është lexuar në simpoziumin kushtuar “Lëvizjes së punëtorëve në Maqedoni” mbajtur në maj 1969 në Veles.

4. “Bashkëpunimi shqiptaro–maqedonas në gjysmën e dytë të shekullit XIX – kontribut për afirmimin e tyre nacional”. Ky punim është lexuar në kongresin e V-të të historianëve të Jugosllavisë, mbajtur në Ohër më 5–7 shtator 1969. Punimi është për botim në revistën JIÇ, Beograd.

5. “Bashkëpunimi i popullit shqiptar dhe atij maqedonas gjatë LNÇ–së”. Me këtë punim Masar Kodra është paraqitur në simpo–

ziumin ndërkombëtar kushtuar Qëndresës në Evropë gjatë Luftës së Dytë Botërore, i cili është mbajtur në Ohër më 4–5 shtator 1969.

6. “Qasja e historiografisë shqiptare mbi çështjen maqedonase”. Ky punim do të publikohet në revistë të veçantë në Moskë më vitin 1970.

7. “Lidhjet dhe bashkëpunimi i popullit maqedonas dhe atij shqiptar nga fillimi i shekullit XIX deri në fund të Luftës së Parë Botërore”. Ky punim do të publikohet në revistë të veçantë në Moskë.

8. “Partia Komuniste e Jugosllavisë dhe nacionalitetet në Maqedoni në periudhën e ilegales 1919–1920”. Punimi është paraqitur në takimin shkencor me rastin e 50–vjetorit të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, mbajtur në Split më 21–30 tetor 1969. Ky punim është në bashkautorësi me dr. Gligor Todorovskin.

Në vazhdim paraqiten publikimet tjera:

1. “Revolucioni i tetorit dhe Fan Noli”, “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 12.X.1967.

2. “Vrasja politike e Esad pash Toptanit”, “Zëri i rinisë” Prishtinë, maj 1967.

3. “25–vjetori i formimit të Partisë Komuniste të Maqedonisë”, “Bezbednost” nr.1, Shkup, 1968.

4. “Jehona e vdekjes së V.I. Leninit te populli shqiptar”, “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 25.I.1968.

5. “ASNOM dhe kombësitë”, “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 31.VII.1968.

6. “Si u formua Partia Komuniste e Maqedonisë”, “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, mars 1969.

7. “Qëndresa e maqedonasve dhe shqiptarëve në kohën e Skënder-beut”. Punimi është botuar në buletin e Entit Republikan të Shkollave të RS të Maqedonisë, nr.1, 1969.

Siç shihet më lartë me numërimin e titujve të punimeve të publikuara, veprimtaria hulumtuese-shkencore e profesor Masar Kodrës në këtë periudhë ka qenë e drejtuar, së pari drejtë për studimin e lidhjeve dhe bashkëpunimin e lëvizjeve çlirimtare kombëtare të shqiptarëve dhe maqedonasve si dhe me problemet nga historia e Shqipërisë.

Publikimet në revistën “Glasnik”

Temat e trajtuara janë punuar në bazë të burimeve të papublikuara arkivore si dhe literaturës profesionale dhe janë të publikuara në revistën shkencore të Institutit të Historisë Nacionale në Shkup, “Glasnik”. Bëhet fjalë për këto punime: *“Luftimet për Dibrën gjatë vitit 1944 sipas burimeve shqiptare”*, Glasnik IHN Shkup, viti X, nr. 1, 1966; *“Revolucioni borgjez-demokratik në Shqipëri në vitin 1924”* Glasnik IHN Shkup, viti XII, nr. 3, 196; *“Kongreset në Dibër, Elbasan dhe Manastir dhe lëvizja çlirimtare shqiptare”* Glasnik IHN Shkup, viti XIII, nr. 1–2, 1969; *“Partia Komuniste e Jugosllavisë dhe nacionalitetet në Maqedoni në periudhën e ilegales 1919–1920”* botuar në “Glasnik” IHN Shkup, viti XV, nr. 2, 1971.

1. **“Борбите за Дебар во 1944 година според албанските извори”** (“Luftimet për Dibrën gjatë vitit 1944 sipas burimeve shqiptare”), botuar në “Glasnik” IHN Shkup, viti X, nr. 1, 1966. f. 209–214.

– Në këtë punim me titull: “Luftimet për Dibrën gjatë vitit 1944 sipas burimeve shqiptare”, i pari i publikuar në revistën shkencore të Institutit të Historisë Nacionale në Shkup, profesor Masar Kodra i shkruan recension librit me titull: “Brigada e parë sulmuese e UNÇ të Shqipërisë”, botuar në vitin 1963 në Tiranë nga Instituti i Historisë së Partisë pranë Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, me rastin e 20-vjetorit të Brigadës së Parë Sulmuese Shqiptare.

Profesor Masar Kodra, paraqet përmbajtjen e këtij libri, të ndarë në punime, dokumente e kujtime. Për realizimin e këtij libri, aty përmenden edhe luftëtarët me emra, të cilët kanë marrë pjesë aktive në radhët e Brigadës së Parë sulmuese shqiptare. Redaktor i këtij botimi paraqitet Nderci Plasari. Në vazhdim autori paraqet historinë e kësaj brigade.

Në pjesën e dytë të shkrimit të paraqitur me titull: “Sulmi në Dibër (1 gusht 1944)”, përshkruhet sulmi në Dibër, sipas të dhënave që i jep Ferit Radovicka, me gradë kolonel, ku paraqitet në detaje ky aksion ushtarak i brigadës së Parë Sulmuese Shqiptare. Aty përshkruhet organizimi i brigadës si dhe strukturat e saj. Në vazhdim shkruhet mbi vijat e frontit Strugë – Gostivar – Dibër dhe aksionet sulmuese. Autori thekson se ky sulm i njësiteve partizane shqiptare, për herë të parë këtu kanë aplikuar taktikat frontale.

Shkrimi përfundon me tekstin ku përmendet ndihma e brigadës së V dhe të III–të partizane shqiptare për çlirimin Prizrenit, Gjakovës, Prishtinës, Pejës dhe tërë territorin e Kosovës, me tej theksohet se divizioni i V dhe i VII shqiptar, kanë çliruar shumë qytete të Jugosllavisë, ku luftuan mbi 20.000 mijë luftëtarë shqiptar, ku ranë më shumë se 350 dëshmorë.

2. “Буржоаско–демократска револуција во Албанија во 1924 година” “(Revolucioni borgjez–demokratik në Shqipëri në vitin 1924)” botuar në “Glasnik” IHN Shkup, viti XII, nr. 3, 1968. f. 73–100.

Shkrimin me titull: “Revolucioni borgjez–demokratik në Shqipëri në vitin 1924”, i publikuar në revistën shkencore të Institutit të Historisë Nacionale në Shkup, profesor Masar Kodra e paraqet me disa kapituj:

– Gjendja e përgjithshme në Shqipëri pas Luftës së Parë Botërore, ku shkruhet për situatën politike dhe ekonomike në Shqipërinë e asaj periudhe;

– Kongresi i Durrësit dhe formimi i qeverisë së përkohshme shqiptare, ku paraqiten informacione rreth organizimit politik dhe përgatitjeve për mbrojtjen e interesave të Shqipërisë përpara Konferencës së Paqes në Paris. Gjithashtu edhe zgjedhjen e Turhan Pash Përmetit, kryeministër i vendit, si dhe politikat e fqinjësisë me Italinë dhe me mbretërinë SKS–në;

– Aksione të forcave progresive të popullit shqiptar, shkruhet, për gjendjen në Shqipëri pas Konferencës së Paqes në Paris, si dhe për organizimin dhe mbajtjen e Kongresit të Lushnjës 21 janar 1920. Zgjedhjen e qeverisë së re në krye të cilës u zgjodh Sulejman Delvina, si dhe u mor vendimi që për kryeqytet të vendit të shpallej Tirana;

– Humbja e ushtrive italiane në Vlorë, autori e përshkruan në detaje luftën e Vlorës ku ushtria italiane pësoi disfatë, si dhe në pjesën e fundit të këtij kapitulli paraqitet situata në kufirin veri–lindor dhe lufta me ushtrinë serbe e Elez Isufit;

– Aktivitetet e mëdha të forcave demokratike. Autori shkruan mbi zgjedhjet parlamentare të prillit 1921 dhe krizat e njëpasnjëshme politike të qeverive shqiptare të kësaj periudhe, deri në ardhjen e Ahmet Zogut në pushtet.

– Rrjedhat e revolucionit të qershorit. Këtu paraqitet veprimtaria politike dhe luftarake e përkrahësve të forcave demokratike të udhëhequra nga Fan Noli, i cili erdhi në pushtet më vitin 1924. Në punim janë paraqitur të gjitha veprimet e të dyja palëve, deri në kthimin e Ahmet Zogut, pra dështimit të revolucionit të qershorit. Ky shkrim përfundon me përmbledhje rreth idesë së revolucionit demokratik të qershorit, si dhe arsytet e dështimit të tij. Më pas pasqyron një rezymë në gjuhën frënge.

3. “Конгресите во Дебар, Елбасан и Битола – на албанското ослободително движење”, “(Kongreset në Dibër, Elbasan dhe Manastir dhe lëvizja çlirimtare shqiptare)” botuar në “Glasnik” IHN Shkup, viti XIII, nr. 1–2, 1969, f. 105–117.

– Shkrimi me titull: “Kongreset në Dibër, Elbasan dhe Manastir dhe lëvizja çlirimtare shqiptare”, i publikuar në revistën shkencore të Institutit të Historisë Nacionale në Shkup, shtjellon rëndësinë historike të kongreseve të organizuara nga klubet shqiptare të asaj periudhe. Shkrimi fillon me përshkrimin e revolucionit xhonturk, dhe bashkëpunimi i shqiptarëve me xhonturqit, premtimet e tyre dhe rrjedhën e revolucionit. Paraqitet programi i shoqërisë “Bashkim e Përparim”. Më tej shkrimi vazhdon rreth, Kongresit të Dibrës, organizimin dhe vendimet e tij, autori jep të dhëna për ndikimin e xhonturqve dhe klerit mysliman në këtë Kongres i organizuar për ta zbutur vendimin e Kongresit të Manastirit ku u mor vendimi për zgjedhjen e alfabetit latin si alfabet i gjuhës shqipe, për të cilin vendim nuk ishin të kënaqur xhonturqit e as mbështetësit e

tij, në radhë të parë kleri fetar. Në Kongresin e Elbasanit, vëmendje të veçantë iu dha vendimit për themelimin e Normales së Elbasanit, ku do të dalin kuadro për të realizuar të drejtën e shkollimit në gjuhën shqipe, të shkollës shqipe. Në këtë shkollë do të kalonin shumë nxënës të dërguar nga klubet shqiptare, për t'u pajisur me dijen e nevojshme e cila duhej të përhapet në shkollat e qyteteve e fshatrave të banuara me shqiptare. Autori në këtë punim shkruan për rëndësinë e vendimeve të Kongresit të Manastirit, ku theks të veçantë i kushton vendimit të njësimit të alfabetit të gjuhës shqipe, botimit të librave dhe gazetave në gjuhën shqipe me alfabetin e Manastirit. Vëmendje i kushtohet kongreseve për unifikimin e shqiptarëve në sferën e kulturës e arsimit, me qëllim të bashkimit të tij sipas idesë së rilindësve. Punimi ka një përfundim ku paraqiten aktivitetet e rilindësve shqiptarë për realizimin e ideve të tyre për ngritjen arsimore e kulturore të shqiptarëve si e vetnija mënyrë për ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe realizimit të qëllimit final, bashkimin e kombit shqiptar.

4. “КПЈ и народностите во Македонија во легалниот период од 1919 до 1920 година”, “(PKJ dhe nacionalitetet në Maqedoni në periudhën e legale 1919–1920)” botuar në “Glasnik” IHN Shkup, viti XV, nr. 2, 1971, f. 155–161.

– Në shkrimin me titull: “PKJ dhe nacionalitetet në Maqedoni në periudhën e legale 1919–1920”, i publikuar në revistën shkencore të Institutit të Historisë Nacionale në Shkup, i profesor Masar Kodra në bashkautorësi me dr. Gligor Todorovski, paraqitet roli i Partisë Komuniste Jugosllave në njohjen dhe respektimin e të drejtave të nacionaliteteve në Jugosllavi. Aty paraqitet situata në Jugosllavinë e pas Luftës së Parë Botërore, ku përveç serbëve, kroatëve dhe sllovenëve nuk njiheshin kombësitë që jetonin në territorin e Jugoslla-

visë e në veçanti në pjesën e Maqedonisë së Vardarit. Me formimin e Partisë Socialiste punëtore (Komuniste) në prill 1919. PKJ njihje prezencën e këtyre nacionaliteteve, dhe angazhohej të përfitojë mbështetjen e të gjithë jugosllavëve, duke u premtuar barazi sociale. Në Kongresin e dytë të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, mbajtur në Vukovar, qershor 1920 në programin akcional thuhej: “PKJ do të jetë mbështetëse e idesë së bashkimit nacional si dhe barabarësia e të gjitha nacionaliteteve në vend. PKJ—ja do të përkushtohet që të pamundësoj shkeljen e të drejtave politike dhe qytetare të nacionaliteteve të cilët janë pjesë përbërëse e shtetit jugosllavë”. Në këtë punim autori paraqet edhe veprimtarinë politike të Xhemijetit si parti e myslimanëve shqiptar dhe turq.

Temat të cilat i trajton profesor Masar Kodra, mund të ndahen në këto periudha:

Mesjetë, ku trajtohet figura dhe betejat e Skënderbeut; Rilindja, veçanërisht periudha pas revolucionit xhonturk 1908; Periudha e Revolucionit të qershorit 1924, Fan Nolin, të cilit më pas i kushton një monografi. Pasion i tij ishte Periudha e LDB—së. Në qendër të fokusit të tij është Dibra, si vendlindje e tij.

Bëhet fjalë për një autor i cili nuk është ndalur vetëm në një periudhë të vetme historike, që dëshmon spektrin e gjerë të interesimit dhe njohurive të tija.

ÇLIRIM DER VISHI*Strugë***SHËNIME BIBLIOGRAFIKE TË LIBRAVE,
MONOGRAFIVE DHE PUNIMEVE TË
PROF.DR.MASAR KODRA*****I. Studime monografike:***

1. "Fan S. Noli në jetën politike të shoqërisë shqiptare (1905–1945)", Prishtinë, 1997.
2. "Shqiptarët e Maqedonisë në Luftën e Dytë Botërore (1939–1944)", Kumanovë, 1996.
3. "Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane (1918–1945)", Shkup, 1997.

II. Tekste shkollore:

1. "Historia" për klasën e V-të të shkollave fillore të Kosovës (Bashkautor: Dr.Masar Kodra, Dr.Fehmi Pushkolli), Prishtinë, 1977.
2. "Historia" për klasën e I-rë të edukimit dhe arsimit të mesëm të orientuar (Bashkautor: Dr. Masar Kodra, Mr. Jetulla Krasniqi), Prishtinë, 1984, (botim i tretë).
3. "Historia" për klasën e VI-të të shkollave fillore të Kosovës (Bashkautor: Dr. Masar Kodra, Dr.Qamil Gexha), Prishtinë 1987.
4. "Historia" për klasën e I-rë të shkollave të mesme të Kosovës dhe për klasën e I-rë të edukimit dhe të arsimimit të mesëm për të

gjitha degët, përveç degëve kulturologjike–gjuhësore, juridiko–biroteknike, arsimore dhe të dramës. (Bashkautor: Dr. Masar Kodra, Dr. Jetulla Krasniqi), Prishtinë, 1988.

5. “Historia” për shkolla fillore në gjuhën turke në Kosovë, Prishtinë, 1986.

III. Artikuj, fejtone, punime shkencore të botuara në revista shkencore, gazeta dhe në përmbledhje të materialeve nga konferencat e simpoziumet shkencore, si dhe punime të pabotuara:

1. “Revolucioni i xhonturqve dhe pjesëmarrja e shqiptarëve në të”, botuar në gazetën “Flaka e Vëllazërimit”, në dy vazhdime, dt. 13 dhe 20 korrik 1967.

2. “Revolucioni socialist i tetorit dhe Fan Noli”, botuar në “Flaka e Vëllazërimit”, dt.12 tetor 1967;

3. “Njëzet e pesë vjet nga formimi i KQ të PK të Maqedonisë”, botuar në gazetën “Flaka e Vëllazërimit”, nr. 870, dt. 15.02.1968;

4. “Jehona e ngjarjeve revolucionare dhe e vdekjes së Leninit te populli shqiptar”, botuar në gazetën “Flaka e Vëllazërimit” (fejton në dy vazhdime), dt. 25 kallnor (janar) dhe 01 Fror (Shkurt) 1968;

5. “Rezistenca e dibranëve kundër turqve gjatë aksioneve luftarake të Skënderbeut”, botuar në revistën “Gjurmime Albanologjike”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1969, faqe 135–144 (separatë nga simpoziumi për Skënderbeun (09–12.V.1968), Prishtinë, 1969;

6. “Kongresite vo Debar, Elbasan i Bitola na albanskotot osloboditelno dvizenje”, botuar në revistën “Glasnik” të Institutit të Historisë Nacionale (INI), Skopje, 1969, G. XIII, br. 1–2, str 105–107;

7. “Mladoturskata revolucionara i Albanskoto Osloboditelno dvizenje”, botuar në revistën “Glasnik” të INI, G. CII, Skopje, 1968, str.117–148;
- 8.”Albansko – Makedonska Sardanja u drugoj polovini XIX veka – doprinos nacionalnoj afirmaciji” (Posebni otisok), IZ. 3 – 4 / 1970, str. 43 – 50, botuar në revistën “Jugoslavenskog Istorijski Časopisa”;
9. “Zef Lush Marku – Istaknat revolucioner i prestavnik na rabotničkoto dvizenje vo makedonija i vo Kosovo”, (Oddelen otpeçatok), Skopje, 1971, str. 175 – 183, publikuar në librin “Materiali za Rabotnickoto dvizenje vo Makedonija do 1929 godina”, Skopje, 1971;
10. “Burzoasko – demokratska revolucija vo albaniya vo 1924 god.”, botuar në revistën “Glasnik” të INI – t, G. XII, Skopje, 1968, b.3;
11. “Vrskite i sorabotkata na osloboditelnite dvizenje na albanskiot i makedoskiot narod vo periodot na ilindenskoto vostanije”, e botuar në përmbledhjen e materialeve “Ilinden 1903”, ku janë përfshi materialet e simpoziumit shkencor, kushtuar 65 vjetorit të Kryengritjes së Ilindenit, mbajtur në Ohër, dt. 27 – 28. V. 1968, botuar në Shkup, 1970, faqe 255 – 267;
12. “Tridhjetë vjet nga formimi i territoreve të lira”, Pjesa e I, botuar në revistën “Jehona”, nr. 9 Shkup, 1973, faqe 89–99;
13. “Tridhjetë vjet nga formimi i territoreve të lira”, pjesa II, botuar në revistën “Jehona”, nr. 9, Shkup, 1973, faqe 107–119’
14. “Bashkëpunimi i popullit shqiptar dhe maqedonas gjatë LNÇ-së (1941–1944)”, botuar në revistën “Jehona”, nr.3, Shkup 1971,

faqe 85–9; Punimi me disa ndërhyrje është botuar në revistën “11 Oktomvri” në gjuhën maqedonase, Shkup, 1972, faqe 76–82;

15. “Pozita ekonomike, shoqërore dhe politike e kombësisë shqiptare në Maqedoni midis dy luftërave botërore” (Pjesa e parë), botuar në revistën “Jehona”, V.XI, Shkup, 1973, nr.4;

16. “Pozita ekonomike, shoqërore dhe politike e kombësisë shqiptare të Maqedonisë midis dy luftërave botërore (Pjesa e dytë), botuar në revistën “Jehona”, nr. 5, V.XI, Shkup, 1973, faqe 95 – 112;

17. “Tridhjetë vjet nga formimi i PKM–së”, botuar në revistën “Jehona”, nr. 2, V. XI, Shkup, 1972, faqe 109 – 118;

19. “Në gjurmë të një dokumenti – udhërrëfënjes i trimave”, (Bashkautorësi: Masar Kodra – Ismet Dermaku), botuar në revistën “Jehona”, nr. 7. V. XI, 1972;

20. “Acarimi i marrëdhënieve diplomatike midis Italisë dhe Bullgarisë rreth çështjes kufitare në Maqedoni dhe në Kosovë (1941 – 1943)”, botuar në revistën “Vjetari i Arkivit të Kosovës”, nr. VI – VII (1970 – 1971), Prishtinë, 1974, faqe 41–59;

21. “Lidhjet dhe bashkëpunimi i Lëvizjes Kombëtare të popullit shqiptar dhe maqedonas gjatë periudhës së Kryengritjes së Ilindënit”, botuar në revistën “Përparimi”, nr. 3 – 4, Prishtinë, 1968, faqe 387 – 400;

22. “Lidhja Shqiptare e Prizrenit shikuar nga spektri i disa dokumenteve britanike në vitet 1879–1881”, botuar në revistën “Kosova”, nr. 3, Prishtinë 1974, faqe 45–70;

23. “KPJ i Narodnostite vo Makedonija vo ilegalniot period”, (bashk – autori: Dr. Gligor Todoroski – Masar Kodra), botuar në

revistën “Glasnik” të INI, God. XV, br. 2, Skopje 1971, str. 155–165;

24. “Sorabotkata na Makedonskiot i albanskiot narod vo prвите godini na XX vek”, botuar në “Zbornik za Koskva”, Skopje, 1970, str. 103–113;

25. “Albansko – makedonska saradnja u drugoj pollovini XIX veka – doprinos nacionalne afirmacije”, (punimi është botuar në revistën “JIÇ” (Jugosllovenski Istoriski Časopis), br. 3–4, Beograd 1970, str 43–50;

26. “Stavovi na albanskata istoriografija kon makedonskoto prasanja”, (punimi është botuar në “Zbarnik za Moskva”, në gjuhën angleze, Shkup, 1970, str. 103–110;

27. ”Formimi dhe aktiviteti i batalioneve kosovare në Maqedoni më 1943”, (bashkautorësi: Vlado Ivanovski, Masar Kodra), Kumtesë në simpoziumin shkencor “Njësit e Armatosura të LANÇ-it në Kosovë (1941–1945)”, mbajtur në Prishtinë, dt.14–15.XII.1974.

28. ”Dibra me rrethinë në kohën e Lidhjes së Prizrenit”, botuar në gazetën “Dituria”, nr.1–2, 1978, faqe 15–35.

29. ”Komunisti shqiptar Zef Lush Marku – viktimi e parë e terrorit borgjez”, botuar në revistën “Përparimi”, nr.6.1977, faqe 735–745.

30. ”Pjesëmarrja e kombësisë shqiptare në njësitë partizane të Maqedonisë (1941–1943)”, botuar në revistën “Kosova”, nr.16, 1987, faqe 219–241.

31. “Veprimtaria e Lidhjes së Prizrenit në territorin e sotëm të Maqedonisë”, botuar në “Materialet e konferencës shkencore, kushtuar 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, vëllimi I, Prishtinë, 1981, faqe 157–170.

32. "Çështja e alfabetit të shqipes në gazetat "Vest", "Vardar" dhe "Rodina", botuar në revistën "Gjurmime Albanologjike", seria historike, nr.17, Prishtinë, 1987, faqe 231–248.
33. "Albanskata narodnost u organizaciama KPM i organima NOP-a (1941–1943)", botuar në revistën "Vjetari i Arkivit të Kosovës", nr. XXI–XXII, Prishtinë, 1986, faqe 189–226.
34. "Shtypi shqiptar në Amerikë midis dy luftërave botërore", botuar në revistën "Vjetari i Arkivit të Kosovës", nr.XII–XIII (1976–1977), Prishtinë, 1981, faqe 77–116.
35. "Bashkëpunimi politiko–ushtarak gjatë LANÇ–së midis popullit shqiptar dhe maqedonas (1941–1942)", botuar në revistën "Vjetari i Arkivit të Kosovës", nr.XXIII, Prishtinë, 1987, faqe 15–32.
36. "Pozita ekonomike –shoqërore e popullit shqiptar të Maqedonisë në fillim të Luftës së Dytë Botërore", botuar në materialet e simpoziumit shkencor mbajtur në Kondovë, dt.17–22 dhjetor 1991, "Shqiptarët e Maqedonisë", Shkup, 1994.
37. "Dibra me rrethinë në kohën e Lidhjes së Prizrenit", botuar në materialet e simpoziumit "Dibra dhe etnokultura e saj", vëllimi I, Dibër, 1995, faqe 187–198.
38. "SHBA dhe LNÇ e popullit shqiptar (1939–1943)", botuar në gazetën "Flaka" në vazhdimë dt.16.02–01.03.1998.
39. "Universiteti shqip – obligim i të gjithëve", botuar në gazetën "Flaka", dt.11.02.1995, faqe 8.
40. "Tempulli madhështor i Dritës", botuar në gazetën "Flaka", dt.16.XII.1995, faqe 8 (në njëvjetorin e themelimit të Universitetit të Tetovës).

IV. Punime të pabotuara:

1. "Struga me rrethinë në prag të Kryengritjes së Shtatorit 1913", 6 faqe (kumesë e mbajtur në simpoziumin shkencor në Strugë (tetor 1998);
2. "Në ditët e një jubileu: 50 – vjet të formimit të Brigadës së IV (VII) Shqiptare", referat mbajtur në Akademinë solemne në Strugë, dt. 10.09.1994, me rastin e 50 vjetorit të formimit të Brigadës, (17 faqe).
3. "Aspekti historiko – gjeografik dhe demografik i popullit shqip-tar në Maqedoni" (e pabotuar, 1991, (3 faqe);
4. "Manastiri i Shën Jovan Bigorskit", (në gjuhën maqedonase), (6 faqe);
5. "Acarimi i marrëdhënieve diplomatike midis Italisë e Bullgarisë rreth çështjes kufitare në Maqedoni dhe në Kosovë" (1941 – 1943)", (30 faqe);
6. "Drustveno – ekonomski promeni vo Debar i Debarsko (1944 – 1970)", (një punim prej 8 faqesh, i përgatitur nga prof. Masar Kodra, e cila është pjesë e monografisë "Debar i Debarsko", në dorëshkrim;
7. "Mendimi politik shqiptar në gjysmën e dytë të shek. XX dhe në vitet e para të shek. XX, si dhe kontributi i tij në aspektin kombëtar dhe atë fetar", në dorëshkrim dhe i pabotuar e daktilografuar.
8. "Gjendja e arsimit në prefekturën e Dibrës gjatë (1941 – 1944)", (trajtesë në konferencën shkencore "55 Vjetori i shkollave të para shqipe (1941 – 1996), në Prefekturën e Dibrës", mbajtur në Strugë, 19.XI.1996;

9. “Aspekte shtetërore diplomatike të shtetit mesjetar të Skënderbeut”, (trajtesë në konferencën shkencore, mbajtur në Strugë, në 540 – vjetorin e Betejës së Livadhisë (1462 – 2002);
10. “Çështja shqiptare në analet e diplomacisë amerikane (1918–1945)”, (në dorëshkrim);
11. “Masakra e Ladorishtit – 28 Tetor 1944”, (referat, mbajtur në Strugë, në tribunën shkencore kushtuar 55 vjetorit të Masakrës së Ladorishtit, Strugë, 28 Tetor 1999;
12. “Historia e diplomacisë shqiptare”, (në dorëshkrim, 92 faqe dhe padiktografuar);

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE
TË SHQIPTARËVE – SHKUP &
SHOQATA E HISTORIANËVE SHQIPTARË NË MAQEDONI
SCUPI, vëllimi 19 – 2018

Kryeredaktor: Dr. Nebi Dervishi
Redaktor gjuhësor: Dr. Sevdail Demiri
Redaktor teknik: Naser Fera

Shtypi: Focus Print – Shkup
Tirazhi: 500 copë

Ky libër botohet me vendimin e Këshillit të ITSHKSH-së
nr. 0201–44/4, të datës 12.02.2018, Shkup

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

930.1(=18)(062)

MASAR Kodra : (1932-2003) : figurë e shquar e historiografisë shqiptare :
(konferencë shkencore mbajtur më 15.9.2017, me rastin e 85 - vjetorit të lindjes) /
[kryeredaktor Nebi Dervishi]. - Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e
kulturore të shqiptarëve, 2018. - 174 стр. : илустр. ; 21 см. - (Biblioteka Scupi)

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4653-51-6

а) Историографија - Албанци - Собири
COBISS.MK-ID 106401546